



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 198

**Tiranë – E premte, 20 nëntor 2015**

## PËRMBAJTJA

|                                                                      | Faqe                                                                                                                                                                                 |
|----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 912, datë 11.11.2015         | Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të<br>ndikimit në mjedis..... 13007                                                                                |
| Urdhër i ministrit të Punëve të<br>Brendshme nr. 577, datë 4.11.2015 | Për miratimin e rregullores për pranimin në detyrë të nëpunësit të<br>zyrës së gjendjes civile në bashki..... 13060                                                                  |
| Vendim i Entit Rregulator të<br>Energjisë nr. 129, datë 31.10.2015   | Mbi disa ndryshime në rregullat për certifikimin e operatorit të sistemit<br>të transmetimit të gazit natyror..... 13062                                                             |
| Vendim i Entit Rregulator të<br>Energjisë nr. 131, datë 31.10.2015   | Për miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të<br>ankandeve për Evropën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.2..... 13063                                              |
| Vendim i Entit Rregulator të<br>Energjisë nr. 132, datë 31.10.2015   | Për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të<br>ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore<br>(SEE CAO), versioni 1.3..... 13064 |
| Vendim i Entit Rregulator të<br>Energjisë nr. 133, datë 31.10.2015   | Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2015 për të<br>licencuarit në sektorin e energjisë elektrike..... 13064                                                          |
|                                                                      | Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Fran Zefi..... 13069                                                                                                                   |

**VENDIM****Nr. 912, datë 11.11.2015****PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË  
KOMBËTARE TË PROCESIT TË  
VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 7, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, ku përcaktohen metodikat dhe kërkesat për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 shtator 2016.

**KRYEMINISTRI  
EDI RAMA**

**METODOLOGJIA KOMBËTARE E  
PROCESIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT  
NË MJEDIS****1. QËLLIMI DHE PËRDORIMI I  
METODOLOGJISË**

Qëllimi i metodologjisë është të sigurojë një mjet menaxhimi për procesin e vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) në Shqipëri dhe të lehtësojë realizimin e një procesi eficient të VNM-së për çdo projekt të paraqitur për miratim.

Qëllimi final është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projektpropozimet, para dhënies së lejes së zhvillimit, të garantojë një proces të hapur vendimmarrjeje, përshkrimin e vlerësimit e ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara.

Stadet e procesit të aplikimit për VNM-në paraprake dhe stadet e procesit të aplikimit për VNM-në e Thelluar janë përshkruar me detaje, hap pas hapi, të mbështetura nga tabela dhe lista kontrolli nga fillimi në fund.

Përdorimi i metodologjisë do të lejojë zyrtarët dhe menaxherët në sistemin e VNM-së që të vlerësojnë me shpejtësi progresin dhe të menaxhojnë me efektivitet afatet e shumëfishta komplekse, informacionin dhe konsultimin e kërkuar për të menaxhuar aplikimet e VNM-së gjatë të gjitha stadeve në proces.

Metodologjia është pjesë e përpjekjeve për të përmirësuar procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të siguruar që procesi i vlerësimit mjedisor është gjithëpërfshirës dhe bëhet në mënyrën më eficiente.

Përdorimi i metodologjisë:

Metodologjia ofron tabela me hapa të njëpasnjëshëm dhe lista kontrolli që tregojnë, ekzaktësisht, çfarë kërkohet nga secila palë përgjegjëse për administrimin e procesit paraprak dhe të thelluar të VNM-së. Kjo është bërë nëpërmjet përcaktimit të qartë të roleve, përgjegjësisë dhe mënyrave se si, secila palë, mund të përmbushë detyrimet e saj dhe të respektojë afatet strikte, të vendosura në legjislacion, nga fillimi deri në përfundim të procesit.

Shtojcat plotësojnë tekstin kryesor të metodologjisë.

**2. VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS**

VNM-ja është vlerësimi mjedisor në një proces vlerësimesh (të mjedisit, planifikimit hapësinor, ndërtimit etj.) që, eventualisht, mund të finalizohet me lejen e zhvillimit.

Qëllimi i një VNM-je është të sigurojë informacion për vendimmarrësit dhe publikun, në lidhje me pasojat mjedisore të një aktiviteti të propozuar zhvillimi.

**2.1 Çfarë është VNM-ja**

Vlerësimi i ndikimit, i përgjigjet, në thelb, këtyre pyetjeve kyç:

A. Si do të ishte mjedisi pa projektin (p.sh., studimet bazë)? Kjo do të identifikojë dhe përshkruajë gjendjen aktuale të burimeve e karakteristikave ekzistuese të mjedisit që mund të ndikohet nga projekti dhe se si do të zhvillohen ato në mungesë të tij.

B. Çfarë do të ndodhë në mjedisit si pasojë e projektit (p.sh., parashikimi)? Kjo do të përshkruajë mjedisin siç është, pa projektin, dhe se si do të ndryshojë ai si pasojë e projektit, në aspektin e burimeve mjedisore apo njerëzore (receptorët), në natyrë dhe shkallën e ndryshimit, shtrirjen e tij gjeografike dhe kohore.



C. A përbën kjo një shqetësim (p.sh., vlerësimi)? Parashikimi i ndikimit nuk është i mjaftueshëm. Shumica e vendimmarrësve (dhe, sigurisht, shumica e stafit të autoritetit kompetent dhe e palëve të jashtme të interesuara) nuk kanë ekspertizën për të kuptuar se çfarë duan të thonë në të vërtetë gjetjet teknike të parashikimeve të ndikimit. Ata, gjithashtu, kanë nevojë për informacionin që i lejon të gjykojnë se sa i rëndësishëm (domethënës) është ndikimi, në mënyrë që të mund ta llogaritin atë, përkundrejt kostove dhe përfitimeve të tjera të projektit, në marrjen e një vendimi, nëse ai duhet të lejohet të zhvillohet.

Ç. Nëse është i rëndësishëm, a mund të bëjmë ndonjë gjë në lidhje me të (p.sh., zbutja)? Së fundi, është e rëndësishme të kuptohet se, në qoftë se ndikimi është i rëndësishëm, mund të bëhet diçka për të shmangur, për të reduktuar, për të korrigjuar apo për të kompensuar atë. Zhvilluesi i projektit mund t'i përfshijë këto masa zbutëse në propozimet e projektit dhe autoriteti kompetent mund t'i përfshijë kërkesat përkatëse në kushtet e lejes së dhënë.

D. Në mënyrë që autoritetet kompetente dhe palët e jashtme të interesuara të vendosin nëse projekti duhet të vazhdojë, është thelbësore që informacioni mjedisor, i dhënë nga zhvilluesi në raportin e VNM-së, t'u përgjigjet në mënyrë të qartë pyetjeve të mësipërme. Qëllimi i studimeve të VNM-së është që të gjenerojë dhe të paraqesë këtë informacion në mënyrë të qartë, koherente dhe të saktë.

## 2.2 Qëllimi i VNM-së

Ideja e VNM-së është të sigurojë informacion për vendimmarrësit dhe për publikun mbi pasojat mjedisore të zhvillimeve të reja të propozuara. Për më tepër, ideja është që të promovohet zhvillimi që respekton mjedisin, përmes identifikimit të masave të duhura forcuese dhe zbutëse.

Objekti kryesor i VNM-së është të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore të projekteve të reja të zhvillimit apo ndryshimeve të aktiviteteve ekzistuese. Brenda këtij qëllimi, procesi i VNM-së kërkon:

- të konsiderohen alternativat për vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqëruese;
- të përmirësohet plani mjedisor i propozimit;
- të sigurohet që burimet janë përdorur si duhet dhe në mënyrë eficiente;

- të identifikohen masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit;
- të vendosen kushtet për ndërtimin;
- të ndihmohet vendimmarrja dhe informimi i publikut.

## 2.3 Procedura e VNM-së dhe dokumentet

Një dallim i rëndësishëm është bërë ndërmjet:

a) procedurës legislative të VNM-së. Ky është rregulli i veprimeve që duhet të ndërmerren nga zhvilluesit, autoritetet kompetente dhe të konsultuarit për të përmbushur kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e VNM-së;

b) raportit të VNM-së. Raporti i VNM-së është dokumenti, i cili duhet të paraqitet nga zhvilluesi bashkë me aplikimin për leje zhvillimi dhe që përshkruan projektin, ndikimet e tij mjedisore dhe masat zbutëse që duhet të zbatohen, me qëllim minimizimin e ndikimeve;

c) studimeve të VNM-së. Këto janë sondazhet, kërkimet dhe analizat e kryera nga ana e zhvilluesit për të përgatitur informacionin që duhet të përfshihet në raportin e VNM-së. Studimet e VNM-së do të përfshijnë studimet bazë, parashikimin dhe vlerësimin e ndikimeve dhe zhvillimin e masave zbutëse.

## 2.4 Marrja e vendimit për VNM-në

Ajencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) shqyrton kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe, në fund të secilës procedurë, paraprahe apo të thelluar, të VNM-së, merr vendimin për VNM-në paraprahe, ndërsa për VNM-në e thelluar përgatit deklaratën mjedisore, me rekomandimet përkatëse, dhe ia dërgon ministritë.

Në përfundim, vendimmarrja konsiston në:

- Vendim - lëshuar nga AKM-ja në përfundim të procedurës paraprahe të VNM-së;
- Deklaratë mjedisore - lëshuar nga ministri, në përfundim të procedurës së thelluar të VNM-së.

Vendimi

Vendimi i AKM-së, në fund të procedurës paraprahe të VNM-së, përcakton nëse një projekt i listuar në shtojcën II, të ligjit "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", në fuqi, duhet apo jo t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së. Nëse AKM-ja vendos se projekti nuk duhet t'i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, në vendimin e saj përcakton arsyet dhe konsideratat kryesore ku është mbështetur mendimi, mendimin e institucioneve të konsultuara, përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të



shmangur, për të reduktuar dhe, nëse është e mundur, për të korrigjuar ndikimet negative të mundshme në mjedis.

#### Deklarata mjedisore

Rezultati përfundimtar i procedurës së thelluar të VNM-së është deklarata mjedisore, e cila mund të përmbajë refuzimin ose miratimin me rekomandime për autoritetin e planifikimit, për të vazhduar procesin, në bazë të kushteve të specifikuar mjedisore.

Deklarata mjedisore shërben si dokument orientues për autoritetin e planifikimit dhe/ose çdo autoritet përgjegjës në procesin e vendimmarrjes, për një leje zhvillimi apo për një leje të caktuar, për miratimin e një projekti të listuar në shtojcat 1 e 2, të ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në fuqi.

#### 3. KËRKESAT LIGJORE

Objekt i ligjit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative mjedisore të projekteve të propozuara, private ose publike.

Sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, vlerësimi i ndikimit në mjedis i një projekti të propozuar zhvillimi është vlerësimi i ndikimeve të rëndësishme, të mundshme, të asaj veprimtarie në mjedis.

Gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi, në mënyrën e duhur, i ndikimit në mjedis të një veprimtarie, duke përcaktuar efektet e mundshme, të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujën, detin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale e trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, nëpërmjet harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjesë e përgatitjeve për planifikimin e një projekti zhvillimi, dhe para kërimit të lejeve përkatëse të zhvillimit.

Ligji në fuqi për VNM-në dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij, të përafëruara plotësisht me paketën legjislative të Bashkimit Evropian për

vlerësimin e ndikimit në mjedis, ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis nga projekte të propozuara, para miratimit të tyre, për zhvillim dhe garantimin e një procesi të hapur vendimmarrjeje gjatë identifikimit, përshkrimit e vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Ky ligj zbatohet për projektet e propozuara, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendndodhjes së tyre.

Kërkesa të përgjithshme për vlerësimin e ndikimit në mjedis të një projekti.

- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme, të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejta mjedisore, të zbatimit apo moszbatimit të projektit.

- Ndikimet mjedisore të projektit vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e prekur në kohën e paraqitjes së raportit përkatës (por, në raste të mjedisve specifike, konsideron edhe përdorimin historik të territorit në fjalë) për vlerësimin e ndikimit në mjedis të projektit.

- Vlerësimi i ndikimit në mjedis përfshin përgatitjen, zbatimin, funksionimin e mbylljen e tij dhe, sipas rastit, edhe pasojat e mbylljes së veprimtarisë dhe dekontaminimin/pastrimin apo rikthimin e zonës në gjendjen e mëparshme, nëse një detyrim i tillë parashikohet me ligj. Vlerësimi përfshin, sipas rastit, si funksionimin normal, ashtu edhe mundësinë për aksidente.

- Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Projektet që i nënshtrohen VNM-së janë të listuar në shtojcat 1 e 2, të ligjit në fuqi për VNM-në. Përcaktimi se subjekt i cilës shtojcë është varet nga natyra e projektit të propozuar, shkalla e tij, vendndodhja dhe nëse ai mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative në mjedis. Në këtë drejtim ndihmojnë kriteret e vendosura për të asistuar në



marrjen e vendimit, nëse kërkohet VNM-ja dhe në qoftë se po, cilës shtojcë i përket. Ndërsa autoritetet përkatëse, si ato mjedisore apo ministritë e linjës dhe institucionet e konsultuara gjatë procesit, vendosin mbi rëndësinë e ndikimeve mjedisore.

#### 4. PROCESI I VNM-së

Projektet private apo publike, të listuar në shtojcat 1 e 2, të ligjit për VNM-në në fuqi i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës, për zhvillimin ose jo të projektit.

Procedura e VNM-së përfshin:

- Procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Dokumenti bazë, ku mbështetet procesi i VNM-së është raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, i cili, në varësi të ndikimeve të mundshme të projektit, mund të jetë:

- a) raport paraprak i VNM-së për projektet e shtojcës 2 të ligjit për VNM-në, në fuqi;
- b) raport i thelluar i VNM-së, për projektet e shtojcës 1 të ligjit për VNM-në, në fuqi.

Aspektet më të rëndësishme të procesit paraprak të VNM-së janë identifikimi i ndikimeve që mund të shkaktojë projekti i propozuar, konsultimet me palët e tjera të interesuara/të ndikuara dhe vendimi, nëse kërkohet një VNM e thelluar për projektin e propozuar.

Duke pasur si qëllim kryesor vendimmarrje më të mira, për të vendosur për nevojën e VNM-së (paraprake ose të thelluar), për informacionin e nevojshëm që duhet të përfshihet në raportin e VNM-së, si dhe raporte VNM-je të cilësisë së lartë, është e nevojshme të kalohet, së pari, nëpërmjet Listës së Kontrollit të Klasifikimit (Shoshitje - *Screening Checklist*).

Lista e kontrollit të klasifikimit duhet të përdoret për të vendosur nëse kërkohet VNM, bazuar në karakteristikat e projektit, ndjeshmërinë mjedisore të vendndodhjes dhe karakteristikat e ndikimit të mundshëm, ndërsa udhëzuesi për vlerësimin e ndikimeve indirekte dhe kumulative, si dhe ndërveprimet e ndikimit duhet të përdoren kur përcaktohet dhe vendoset në lidhje me ndikimet kumulative dhe ndërveprimet e ndikimit. Në stadin

përfundimtar të procesit paraprak të VNM-së, vendoset nga AKM-ja, e cila konsultohet edhe me institucionet e tjera, nëse ka nevojë për një procedurë të thelluar të VNM-së.

Në rast se ka nevojë për një procedurë të thelluar të VNM-së, nga ana e zhvilluesit dërgohet një njoftim mbi qëllimin për të paraqitur një VNM të thelluar. Një aspekt shumë i rëndësishëm është, përsëri, konsultimi i AKM-së me institucionet e tjera, publikun dhe OJF-të, në lidhje me çështjet që ata dëshirojnë të adresohen në raportin e VNM-së së thelluar. Ndërkohë që të gjitha çështjet e mësipërme janë trajtuar në këtë metodologji, çështjet teknike, që rrjedhin nga kërkesa për të shqyrtuar dhe për të marrë vendime mbi aplikimet e VNM-së, janë konsideruar në shtojcat e saj.

Qëllimi është që të krijohet një pikënisje për zhvillimin e një grupi të plotë udhëzimesh teknike mbi VNM-në që ka nevojë të zhvillohet. Shtojcat 1, 2, 3, 4 e 5 përmbajnë aspektet teknike të mëposhtme të VNM-së:

- Trajtimi i alternativave dhe i vendimeve shumëkriterëshe (shtojca 1);
- Aplikimi i analizave kosto-përfitim (shtojca 2);
- Konsiderimi i masave zbutëse dhe teknikave më të mira të disponueshme (TMD) (shtojca 3);
- Trajtimi i rreziqeve dhe i ngjarjeve të tjera të pazakonshme në VNM (shtojca 4);
- Menaxhimi i pasigurive në VNM (shtojca 5).

Përpara se të diskutohen alternativat, analizat kosto-përfitim, teknikat më të mira të disponueshme (TMD) etj., të cilat janë të rëndësishme për sigurimin e një konteksti për këto aspekte teknike, më poshtë janë dhënë disa parime të rëndësishme, që mbështesin procesin e VNM-së.

Studimet bazë. Qëllimi i studimeve bazë është që të identifikojnë dhe përshkruajnë aspektet e mjedisit që mund të ndikohet nga projekti. Sapo këto aspekte të identifikohen, duhet të grumbullohet nga burimet ekzistuese sa më shumë informacion që të jetë e mundur. Këto mund të përfshijnë organet qeveritare, institutet kërkimore, OJF-të, kompanitë private dhe publikun e gjerë. Është, gjithashtu, e rëndësishme që në karakterizimin e mjedisit bazë të mendohet se si do të ndryshojë ai në mungesë të projektit. Mjedisi do të ndryshojë si pasojë e tendencave të përgjithshme dhe zhvillimeve të tjera - bazë në lëvizje - dhe kjo duhet të merret parasysh në vlerësim. Kjo mund të kërkojë parashikime (shih më poshtë) që duhen



bërë detyrimisht, duke e konsideruar situatën pa projektin, domethënë ndryshimet që mund të ndodhnin në kohë, në rast se projekti nuk do të zhvillohej në këtë zonë.

Parashikimi i shkallës së ndikimeve. Parashikimi është aktiviteti i përcaktimit të natyrës dhe madhësisë së ndikimeve të projektit në mjedis (zakonisht e referuar si magnitudë/shkallë e ndikimit që nënkupton efektin e ndikimit në njësinë e kohës apo magnitudë X ecuri në kohë - kumulativitet). Ndikimi i projektit është diferenca ndërmjet situatave me dhe pa projekt, e cila ka nevojë të përshkruhet.

Metoda të ndryshme mund të përdoren për të parashikuar këto karakteristika të shkallës së ndikimeve, duke përfshirë vëzhgimet e thjeshta, p.sh., numërimi, modelimi, dhe duke përdorur metoda të thjeshta dhe komplekse matematikore, ilustrime fizike etj. Në përgjithësi, parashikimet duhet të sigurojnë informacion sasior sa më shumë të jetë e mundur, por, në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të sigurojnë edhe përshkrim cilësor të asaj që do të ndodhë, pasi numrat sigurojnë vetëm një pjesë të informacionit të nevojshëm.

Së fundi, parashikimet duhet të shoqërohen, gjithashtu, edhe nga një vlerësim i paqartësive/dyshimeve që i bashkëngjiten atyre, në mënyrë që lexuesi të mund të gjykojë se sa të besueshme mund të jenë ato në lidhje me atë se çfarë do të ndodhë.

Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve. Parashikimi siguron informacion faktik, në lidhje me atë që do të ndodhë në mjedis. Vlerësimi është aktiviteti i vendosjes së atyre efekteve në kontekst, duke shpjeguar rëndësinë ose domethënien e tyre për vendimmarrjen. Një ndikim mund të identifikohet si i rëndësishëm, në qoftë se, në këndvështrimin e atyre që ndërmarrin vlerësimin, është mjaftueshëm i rëndësishëm për t'u marrë në konsideratë në vendimin e lejes së zhvillimit, përfshirë këtu edhe identifikimin e kushteve që duhet t'i bashkëngjiten lejes. Një ndikim, ndonëse jo i madh dhe, përgjithësisht i parëndësishëm, në një mjedis me vlera të veçanta, merr rëndësi të madhe, si p.sh., prerja e vetëm 10 pemëve adulte apo shkatërrimi/betonizimi i një sipërfaqeje jo më të madhe se 300 m<sup>2</sup>, në një zonë të zhveshur turistike (plazh), ku ky oaz përbën të vetmin habitat për shpendët dekorativë e këngëtarë.

Pesha që mbart ky ndikim në marrjen e një vendimi do të varet nga shkalla e rëndësisë së ndikimit. Një ndikim i shkallës së lartë, për shkak të gjendjes së receptorëve mjedisorë, mund të jetë edhe i një rëndësie të mesme apo të vogël.

Vlerësimi i bërë nga zhvilluesi/eksperti i VNM-së për rëndësinë e ndikimeve shqyrtohet nga AKM-ja, ministria dhe institucionet që konsultohen në këtë proces. Ndërsa zhvilluesi/eksperti i VNM-së vendos nëse efekti është i rëndësishëm dhe sa i rëndësishëm është ai, duhet, në të njëjtën kohë, të shpjegohet edhe baza e këtij vlerësimi. Rëndësia e efekteve mund të vlerësohet duke iu referuar kriterëve të pranuar, të tilla si standardet ligjore, udhëzimet për politikën ose praktikën e mira. Pikëpamjet e ministrisë, AKM-së, ARM-ve, ministrive të linjës dhe strukturave të tyre, institucioneve dhe publikut do të jenë, gjithashtu, të rëndësishme për vlerësimin e rëndësisë.

Kur nuk ka kriterë të pranuar, është e rëndësishme që të sigurohet një kontekst për të gjykuar rëndësinë e një ndikimi dhe kjo mund të bëhet duke ndërthurur referencat e rëndësisë ose vlerave të receptorëve të ndikuar me shkallën e ndryshimit të pritshëm, si rezultat i zhvillimit.

Është e rëndësishme që bazat për përcaktimin e shkallës së ndikimit dhe rëndësisë së receptorit të jenë të shpjeguara qartë në raportin e VNM-së. Shkalla e ndryshimit përftohet nga parashikimet.

Zbutja e ndikimeve. Menjëherë sapo ndikimi të jetë identifikuar si i rëndësishëm, zhvilluesi/eksperti i VNM-së duhet të konsiderojë nëse ka mënyra për zbutjen e ndikimit, që do ta bënin projektin më të pranueshëm për publikun, vendimmarrësit dhe palët e interesuara.

Kjo do të përfshijë marrjen në konsideratë të fizibilitetit e të kostos së masave të ndryshme dhe vendosjen nëse ato janë praktike, në kontekstin e propozimit specifik. Kjo nuk do të thotë që të gjitha ndikimet e rëndësishme mund të zbuten, por, kur ndikimet vazhdojnë të mbeten prezente, ato duhet të analizohen e vlerësohen në këndvështrimin e kostove dhe përfitimeve të tjera të projektit, për të vendosur nëse duhet dhënë miratimi/leja apo jo.

Informacioni që duhet të sigurohet nga zhvilluesi në përshkrimin e projektit të propozuar përfshin informacionin në lidhje me alternativat e marra në konsideratë përsa i përket vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret.



Shtojca 1, bashkëlidhur kësaj metodologjie, diskuton llojet e alternativave që mund të jenë relevante në kontekstin e VNM-së dhe përcakton një kuadër për vlerësim paraprak, krahasim dhe zgjedhje mes alternativave, duke përdorur teknikat e analizave shumëkriterëshe (ASHK). Shtojca 1 siguron një diskutim të mëtejshëm të një pjese të veçantë të metodave të ASHK-së, të cilat përdorin analizat ekonomike për të krahasuar alternativat.

Gjatë konsultimeve me institucionet e tjera për çështjet që duhet të adresohen në VNM-në e thelluar, AKM-ja duhet të sigurojë një proces konsultimi efektiv. AKM-ja duhet të identifikojë me kujdes palët dhe publikun që duhet të konsultohet, të kërkojë mendimet e tyre, të konsultohet me institucionet dhe të identifikojë ndonjë organ tjetër të rëndësishëm për ndonjë projekt specifik, opinioni i të cilit mund të jetë me rëndësi të madhe në këtë fazë. Konsultim efektiv do të thotë identifikimi i duhur i organeve, të cilat me të vërtetë mund të ndikojnë në vendimin përfundimtar, informacioni/opinion i të cilave mund të jetë i nevojshëm dhe i rëndësishëm, institucione të tjera, përveç atyre të detyrueshme,

për t'u konsultuar (ministritë etj.). Këto institucione sigurojnë informacionin e nevojshëm mjedisor, ekspertizën e kërkuar, opinionet, komentet etj., duke ndihmuar AKM-në në procesin e vendimmarrjes. I rëndësishëm është edhe konsultimi me institucione që mund të japin mendime mbi përputhshmërinë e projektit të propozuar me ndonjë plan ose program të miratuar në atë zonë. Dialogu i hapur përmirëson të kuptuarit e projektit, siguron informacion të nevojshëm që në fazat fillestare të procesit të VNM-së, marrjen në konsideratë të çështjeve të duhura mjedisore, rritjen e efektivitetit të procesit të VNM-së dhe vendimmarrje më të mirë.

#### 4.1 PROCESI PARAPRAK I VNM-së

VNM-ja paraprake është faza e parë e procesit të VNM-së. Procesi paraprak i VNM-së përjashton nga procesi ato propozime (shumicën) që nuk kanë ose kanë pak ndikime të rëndësishme, ndikime lehtësisht të kontrollueshme dhe për të cilat VNM-ja e thelluar është e panevojshme. Në vijim, tabelat dhe listat e kontrollit do të ndihmojnë në procesin që vendos nëse kërkohet VNM-ja e thelluar për një projekt të veçantë ose tip projekti.

##### 4.1.1 LISTA E KONTROLLIT

| Faza 1                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Lista e kontrollit |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|----|
| Lista e kontrollit - Informacioni për t'u siguruar për VNM-në paraprake                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                    |    |
| Përshkrimi i projektit të propozuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                    |    |
| a) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Po                 | Jo |
| b) Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës, që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo të funksionimit të veprimtarisë së projektit | Po                 | Jo |
| c) Informacion për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe me të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna), që administron territorin ku propozohet projekti                                                                                        | Po                 | Jo |
| ç. Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Po                 | Jo |
| d) Përshkrim i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit                                                                                                                                                                                                  | Po                 | Jo |
| dh) Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja                                                                                                                          | Po                 | Jo |
| e) Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit                                                                       | Po                 | Jo |
| ë) Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Po                 | Jo |
| f) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)                                                                                                                                                                                                                                               | Po                 | Jo |
| g) Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Po                 | Jo |



|                                                                                                                                                                                                                                                                           |    |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| përreth/pranë zonës së projektit                                                                                                                                                                                                                                          |    |    |
| gj) Informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret                                                                                                                       | Po | Jo |
| h) Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre                                                                                                     | Po | Jo |
| i) Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo i rezidencave etj.                                                                                                                                           | Po | Jo |
| j) Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit                                                                         | Po | Jo |
| <b>Raporti paraprak i VNM-së ku përfshihen</b>                                                                                                                                                                                                                            | Po | Jo |
| a) Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, i shoqëruar dhe me imazhe                                                                                                                                                 | Po | Jo |
| b) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj                                                                                                                                                                     | Po | Jo |
| c) Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë, ajër dhe shëndet                                                                                                                              | Po | Jo |
| ç) Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimi i mbetjeve                                                                                                                       | Po | Jo |
| d) Informacion për peshën, evoluimin në kohë, kumulativitetin dhe kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara                                                                                                                                          | Po | Jo |
| dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të                                                                                       | Po | Jo |
| e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar, të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe token bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin                                          | Po | Jo |
| ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis                                                                                                                                                                                              | Po | Jo |
| f) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)                                                                                                                                                                                         | Po | Jo |
| g) Program monitorimi për masat zbutëse, të cituara në pikën “i” të kësaj table                                                                                                                                                                                           |    |    |
| gj) Informacion mbi ndikimet pozitive që mund të sjellë zhvillimi i projektit të propozuar                                                                                                                                                                                |    |    |
| h) Raporti paraprak i VNM-së duhet të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar nga QKL-ja,                                                                                                                                                                 |    |    |
| i) Raporti paraprak i VNM-së duhet të jetë i shoqëruar me licencën e personit fizik/juridik të lëshuar nga QKL-ja, dhe certifikatën/certifikatat e ekspertit/ëve të certifikuar nga ministri i Mjedisit, me anë të të cilave është pajisur me licencën lëshuar nga QKL-ja |    |    |

#### 4.2 PROCESI I THELLUAR I VNM-së

Procesi i thelluar i VNM-së siguron që VNM-ja është kryer për projekte që mund të kenë ndikime të rëndësishme në mjedis. Qëllimi është që zhvillimet të mos lejohet të ndodhin para se të jetë kryer një analizë e detajuar teknike për shtrirjen e këtyre zhvillimeve, natyrën dhe karakteristikat e tyre. Vendimi për leje zhvillimi mund të jepet duke përfshirë kushtet për të minimizuar efektet negative dhe duke marrë parasysh ndonjë pasojë të mbetur.

Sipas ligjit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të VNM-së, janë:

- projektet e listuara në shtojcën I;

- projektet e listuara në shtojcën II, për të cilat vendimi i AKM-së parashikon nevojën e zbatimit të procedurës së thelluar të VNM-së.

Zhvilluesi, pavarësisht nëse projekti është i listuar apo jo në shtojcat e ligjit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis mund të kërkojë mendim paraprak nga ministria apo AKM-ja, nëse projekti që synon të zhvillojë është subjekt i ligjit të VNM-së.

Dokumenti kryesor gjatë procesit të thelluar të VNM-së është raporti i thelluar i VNM-së. Raporti i thelluar i VNM-së hartohet nga personi fizik/juridik i licencuar nga QKL-ja, duke krijuar një grup me specialistë të kualifikuar, sipas fushave përkatëse që trajton raporti i VNM-së, bazuar në





kërkesat e shtojcës 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave, në fuqi, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore”, dhe në njoftimin e AKM-së për çështjet që duhet të trajtojnë në raportin e thelluar të VNM-së.

#### 4.2.1 FAZAT

Pesë janë fazat/stadet e zhvillimit të procedurës së thelluar të VNM-së:

Faza 1, njoftimi nga zhvilluesi për synimin për të nisur procedurat për një VNM të thelluar;

#### 4.2.2 LISTAT E KONTROLLIT

Faza 2, konsultimi i AKM-së me ministrinë, institucionet e tjera, publikun dhe OJF-të për çështjet që ato kërkojnë të adresohen në raportin e thelluar të VNM-së;

Faza 3, komunikimi i AKM-së me zhvilluesin për çështjet që ajo dhe palët e konsultuara kërkojnë të adresohen në raportin e thelluar të VNM-së;

Faza 4, hartimi i raportit të thelluar të VNM-së nga zhvilluesi dhe dëgjesat me publikun;

Faza 5, aplikimi për deklaratën mjedisore, hartimi dhe firmosja e deklaratës mjedisore.

| Lista e kontrollit 1.1 Informacioni për t'u siguruar për VNM-në e thelluar                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Lista e kontrollit |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|----|
| <b>Përshkrimi i projektit të propozuar</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                    |    |
| a) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Po                 | Jo |
| b) Planimetria e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës, që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo të funksionimit të veprimtarisë së projektit | Po                 | Jo |
| c) Informacion për qendrat e banuara në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe me të dhëna për distancën nga vendi ku propozohet projekti e për njësinë e qeverisjes vendore (bashkia/komuna), që administron territorin ku propozohet projekti                                                                                        | Po                 | Jo |
| ç) Skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Po                 | Jo |
| d) Përshkrim i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit                                                                                                                                                                                                  | Po                 | Jo |
| dh) Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja                                                                                                                          | Po                 | Jo |
| e) Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit                                                                       | Po                 | Jo |
| ë) Mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit                                                                                                                                                                                                                                                                                      | Po                 | Jo |
| f) Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)                                                                                                                                                                                                                                               | Po                 | Jo |
| g) Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit                                                                                                                                                                                                                                                  | Po                 | Jo |
| gj) Informacion për alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret                                                                                                                                                                                                                  | Po                 | Jo |
| h) Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe për mënyrën e sigurimit të tyre                                                                                                                                                                                                | Po                 | Jo |
| i) Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.                                                                                                                                                                                                                                        | Po                 | Jo |
| j) Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/licencimin e projektit                                                                                                                                                                    | Po                 | Jo |



| Informacion për ndërveprimin me mjedisin të projektit<br>(si shtojcë të pikës 1.1 më sipër)                                                                                                                                      | Po | Jo |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| a) Një përshkrim i shkurtër i mbulesës bimore të sipërfaqes, ku propozohet të zbatohet projekti, i shoqëruar dhe me imazhe                                                                                                       | Po | Jo |
| b) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj                                                                                                                            | Po | Jo |
| c) Një identifikim i ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit, përfshirë ndikime në biodiversitet, ujë, tokë, ajër, shëndet, ekonomi dhe mjedisin social                                                            | Po | Jo |
| ç) Një përshkrim i shkurtër për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurmë, si dhe prodhimi i mbetjeve                                                                              | Po | Jo |
| d) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuara, evoluimin në kohë dhe kumulativitetin                                                                                                         | Po | Jo |
| dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të                                              | Po | Jo |
| e) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar, të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, përfshi edhe tokën bujqësore, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin | Po | Jo |
| ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis                                                                                                                                                     | Po | Jo |
| f) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)                                                                                                                                                | Po | Jo |
| g) Informacion mbi ndikimet pozitive që mund të sjellë zhvillimi i projektit të propozuar                                                                                                                                        | Po | Jo |
| gj) Programi i monitorimit për masat zbutëse të cituara në pikën “h” të kësaj table.                                                                                                                                             | Po | Jo |

| Çështje që duhet të adresohen në VNM-në e thelluar                                                                                                                                                                     | Lista e kontrollit |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|----|
| a) Kërkesat, institucionet, publiku dhe OJF-së të cilat duhet të konsiderohen dhe të adresohen në raportin e thelluar të VNM-së                                                                                        | Po                 | Jo |
| b) Një shpjegim i përmblodhur për kërkesat e procedurës së thelluar të VNM-së, deri në paraqitjen e aplikimit në ministri dhe dhënien e deklaratës mjedisore                                                           | Po                 | Jo |
| c) Detyrimi për informimin, konsultimin dhe dëgjuesin me publikun dhe OJF-të të raportit të thelluar të VNM-së dhe konsiderimin e mendimeve të dhëna në raport                                                         | Po                 | Jo |
| ç) Analizimin e alternativave të mundshme për zbatimin e projektit                                                                                                                                                     | Po                 | Jo |
| d) Udhëzime për studimet dhe metodat për sigurimin e informacionit mjedisor dhe parashikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së                                                    | Po                 | Jo |
| dh) Udhëzime për masat për mbrojtjen e mjedisit që duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së                                                                                     | Po                 | Jo |
| e) Struktura dhe renditja e informacionit në raportin e thelluar të VNM-së, në përputhje me shtojcën II, të VKM-së, në fuqi për miratimin e rregullave, përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së VNM-së | Po                 | Jo |
| ë) Fakti që projekti është subjekt i procedurës ndërkufitare të VNM-së, duke dhënë edhe udhëzimet përkatëse për këtë rast                                                                                              | Po                 | Jo |

| Dokumentet që duhet të paraqiten për VNM-në e thelluar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Lista e kontrollit |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|----|
| a) Raporti i thelluar i VNM-së, i cili duhet të jetë në përputhje me kërkesat e shtojcës II, të VKM-së në fuqi, “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësi e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” dhe i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar nga QKL-ja, sipas legjislacionit në fuqi dhe specialistët e përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së, për çdo kapitull të tij | Po                 | Jo |
| b) Përmblledhje joteknike e raportit të VNM-së                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Po                 | Jo |
| c) Projekti teknik                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Po                 | Jo |
| ç) Informacion për informimin dhe konsultimin me publikun dhe palët e tjera, realizuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Po                 | Jo |



|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |    |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së                                                                                                                                                                                                                                                                      |    |    |
| d) Një kopje e faturës së pagesës së tarifës së shërbimit sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës                                                                                                                                                                                                               | Po | Jo |
| dh) Akti i regjistrimit të subjektit sipas legjislacionit në fuqi                                                                                                                                                                                                                                                     | Po | Jo |
| e) Licencën e personit fizik/juridik të lëshuar nga QKL-ja, certifikatën/certifikatat e ekspertit/ëve të certifikuar nga ministri i Mjedisit me anë të të cilave është pajisur me licencën lëshuar nga QKL-ja, si dhe diplomat e specialistëve të përfshirë në hartimin e raportit të VNM-së, për çdo kapitull të tij | Po | Jo |

|                                                                                                                                                                                          |    |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| <b>Kritere për të vlerësuar plotësimin e raportit të VNM-së dhe sa i përshtatshëm është ai për vendimmarrjen</b>                                                                         |    |    |
| <b>Informacioni duhet të përfshijë:</b>                                                                                                                                                  |    |    |
| · Nevojën për projektin dhe objektivat e projektit                                                                                                                                       | Po | Jo |
| · Programin për zbatimin (datat e fillimit dhe të mbarimit të ndërtimit, të operimit)                                                                                                    | Po | Jo |
| · Të gjithë komponentët kryesorë të projektit                                                                                                                                            | Po | Jo |
| · Vendndodhjen e secilit komponent duke përdorur harta, plane dhe diagrame                                                                                                               | Po | Jo |
| · Planimetrinë e sipërfaqes (sipërfaqeve) së zënë                                                                                                                                        | Po | Jo |
| · Aktivitetet e përfshira në ndërtim                                                                                                                                                     | Po | Jo |
| · Aktivitetet e përfshira në operim                                                                                                                                                      | Po | Jo |
| · Aktivitetet e përfshira në mbylljen e projektit (mbylljen, prishjen, restaurimin e zonës etj.)                                                                                         | Po | Jo |
| · Ndonjë shërbim shtesë të kërkuar (p.sh., akses, ujë, kanalizime, depozitim të mbetjeve, energji elektrike, telefoni)                                                                   | Po | Jo |
| Ndonjë zhvillim shoqëruar (p.sh., rrugë, porte, linja të energjisë, tubacione)                                                                                                           | Po | Jo |
| Ndonjë zhvillim si pasojë e projektit (p.sh., banesa të reja, rrugë)                                                                                                                     | Po | Jo |
| Ndonjë aktivitet ekzistues që mund të ndryshojë ose të mbyllet si pasojë e projektit                                                                                                     | Po | Jo |
| Ndonjë zhvillim tjetër ekzistues ose i planifikuar me mundësi për efekte kumulative                                                                                                      | Po | Jo |
| <b>Kontroll, nëse madhësia e projektit është përshkruar plotësisht</b>                                                                                                                   |    |    |
| <b>Në informacion duhet të përfshihet:</b>                                                                                                                                               |    |    |
| Sipërfaqja e tokës që do të zihet në mënyrë të përhershme (e treguar në një hartë me shkallë)                                                                                            | Po | Jo |
| Sipërfaqja e tokës së kërkuar përkohësisht për ndërtim (e treguar në një hartë me shkallë)                                                                                               | Po | Jo |
| Përdorimi i mëposhtëm i tokës së përdorur (p.sh., toka e përdorur për miniera ose karriera)                                                                                              | Po | Jo |
| Madhësia e strukturave (p.sh., sipërfaqja e katit dhe lartësia e ndërtesave, rrjedha ose thellësia e ujit)                                                                               | Po | Jo |
| Forma dhe pamja e strukturave (p.sh., projekti arkitektonik, llojet e vegjetacionit, sipërfaqet tokësore etj.)                                                                           | Po | Jo |
| Numrat dhe karakteristikat e tjera të komuniteteve të reja (për zhvillime urbane ose të ngjashme)                                                                                        | Po | Jo |
| Numrat dhe karakteristikat e tjera të njerëzve apo bizneseve të zhvendosur                                                                                                               | Po | Jo |
| Tipi, vëllimi dhe shpërndarja e trafikut të ri, të krijuar ose të devijuar                                                                                                               | Po | Jo |
| <b>Kontroll që proceset e prodhimit dhe burimet përdorura nga projekti gjatë fazave të ndërtimit, operimit dhe mbylljes janë përshkruar plotësisht. Informacioni duhet të përfshijë:</b> |    |    |
| Të gjitha proceset e prodhimit, inxhinierike, të prodhimit të materialeve, të proceseve të nxjerrjes                                                                                     | Po | Jo |
| Llojet dhe sasi të produkteve (produkte primare ose mallrat e prodhuara, të mira materiale, shërbime)                                                                                    | Po | Jo |
| Llojet dhe sasi të lëndëve të para dhe energjia e nevojshme                                                                                                                              | Po | Jo |
| Implikimet mjedisore të burimit të lëndëve të para                                                                                                                                       | Po | Jo |
| Trajtim për eficiencën në përdorimin e energjisë dhe lëndëve të para                                                                                                                     | Po | Jo |
| Ndonjë material të rrezikshëm të përdorur, magazinuar, transportuar ose prodhuar                                                                                                         | Po | Jo |
| Transporti i lëndëve të para (duke përfshirë transportin rrugor, hekurudhor ose detar)                                                                                                   | Po | Jo |
| Rregullime për aksesin e punëtorëve dhe të vizitorëve                                                                                                                                    | Po | Jo |
| Trajtim për punësimin e krijuar ose të humbur                                                                                                                                            | Po | Jo |
| <b>Kontrolli nëse llojet dhe sasi të mbetjeve dhe shkarkimeve të projektit gjatë fazave të ndërtimit, operimit</b>                                                                       |    |    |



|                                                                                                                                              |    |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| <b>dhe mbylles janë përshkruar plotësisht. Informacioni duhet të përfshijë:</b>                                                              |    |    |
| Diskutim për metodat e përdorura për gjenerimin e informacionit të mëposhtëm                                                                 | Po | Jo |
| Llojet dhe sasitë e mbetjeve të ngurta të gjeneruara                                                                                         | Po | Jo |
| Diskutim për përbërjen dhe toksicitetin ose rreziqe të tjera të mbetjeve të ngurta                                                           | Po | Jo |
| Përshkrim i metodave për grumbullimin, magazinimin/ruajtjen, trajtimin dhe transportin e mbetjeve të ngurta                                  | Po | Jo |
| Diskutim i vendndodhjeve për depozitimin përfundimtar të të gjitha mbetjeve të ngurta                                                        | Po | Jo |
| Llojet dhe sasitë e gjeneruara të shkarkimeve të lëngëta (duke përfshirë drenazhimin e zonës dhe ujërat e zeza)                              | Po | Jo |
| Diskutim për përbërjen dhe toksicitetin ose rrezikshmëri të tjera të të gjitha shkarkimeve të lëngëta                                        | Po | Jo |
| Metodat për grumbullimin, ruajtjen, trajtimin, transportin dhe depozitimin e shkarkimeve të lëngëta                                          | Po | Jo |
| Llojet dhe sasitë e shkarkimeve të gazta dhe grimcave                                                                                        | Po | Jo |
| Diskutim për përbërjen dhe toksicitetin ose rrezikshmëri të tjera të të gjitha shkarkimeve të gazta në ajër                                  | Po | Jo |
| Metodat për grumbullimin, trajtimin dhe shkarkimin e emetimeve në ajër                                                                       | Po | Jo |
| Vendndodhja për shkarkimin e të gjitha emetimeve në ajër                                                                                     | Po | Jo |
| Karakteristikat e shkarkimeve të emetimeve në ajër (p.sh., lartësia, shpejtësia, temperatura)                                                | Po | Jo |
| Një diskutim i mundësisë për rikuperim të burimit nga mbetjet                                                                                | Po | Jo |
| Identifikimi dhe vlerësimi sasior i burimeve të zhurmës, ose energjisë (makineri, trafik, ndriçim etj.)                                      | Po | Jo |
| Rreziqe nga trajtimi i materialeve të rrezikshme                                                                                             | Po | Jo |
| Rreziqe nga rrjedhjet, zjarri, eksplozioni                                                                                                   | Po | Jo |
| Rreziqe nga aksidentet e trafikut                                                                                                            | Po | Jo |
| Rreziqe nga avaritë ose dështimi i proceseve ose faciliteteve                                                                                | Po | Jo |
| Rreziqe nga ekspozimi i projektit ndaj katastrofave natyrore (tërmete, përmbytje, rrëshqitje toke etj.)                                      | Po | Jo |
| Masa për të parandaluar dhe për të përballuar aksidentet                                                                                     | Po | Jo |
| <b>Kontroll nëse është bërë konsiderimi i duhur i alternativave. Informacioni duhet të përfshijë:</b>                                        |    |    |
| Një përshkrim të situacionit bazë në një situatë (pa projekt)                                                                                | Po | Jo |
| Një diskutim të konsideratave mbi bazën e të cilave është bërë zgjedhja e karakteristikave kryesore të projektit (vendit, teknologjisë etj.) | Po | Jo |
| Një përshkrim të alternativave kryesore në dispozicion të zhvilluesit                                                                        | Po | Jo |
| Një shpjegim të arsyeve kryesore mjedisore për zgjedhjen e variantit të propozuar                                                            | Po | Jo |
| <b>Kontroll nëse është përshkruar plotësisht mjedisi që mund të ndikohet nga projekti. Informacioni duhet të përfshijë:</b>                  |    |    |
| Ndonjë tipar të rëndësishëm të topografisë, gjeologjisë dhe tokave të zonës/zonave dhe hapësira rreth tyre                                   | Po | Jo |
| Përdorimet ekzistuese të tokës të zonës/zonave dhe hapësira rreth tyre                                                                       | Po | Jo |
| Banorët/zotëruesit dhe përdoruesit e tokës (duke përfshirë ndërtesat, strukturat ose pronat e tjera)                                         | Po | Jo |
| Kushtet dhe përdorimi i tokave (duke përfshirë cilësinë e tokës, qëndrueshmërinë dhe erozionin)                                              | Po | Jo |
| Fauna dhe flora dhe habitatet e zonës/zonave dhe në hapësirën rreth tyre                                                                     | Po | Jo |
| Popullimet e specieve dhe karakteristikat e habitateve që mund të ndikohen                                                                   | Po | Jo |
| Një përshkrim i ndonjë zone ose specie të mbrojtur ose të projektuar si të tillë                                                             | Po | Jo |
| Një përshkrim i mjedisit ujor (p.sh., sipërfaqësor, nëntokësor, bregdetar, detar)                                                            | Po | Jo |
| Karakteristikat dhe përdorimi i burimeve ujore që mund të ndikohen                                                                           | Po | Jo |
| Kushtet klimatike dhe meteorologjike lokale dhe cilësia ekzistuese e ajrit                                                                   | Po | Jo |
| Gjendja ekzistuese e shkarkimeve të zhurmës                                                                                                  | Po | Jo |
| Situata ekzistuese në lidhje me ndriçimin, ngrohjen dhe rrezatimin elektromanjetik                                                           | Po | Jo |
| Ndonjë aset material në zonë (duke përfshirë ndërtesat, strukturat, burimet minerare dhe                                                     | Po | Jo |



|                                                                                                                                           |    |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| ujore)                                                                                                                                    |    |    |
| Ndonjë karakteristikë të rëndësishme arkeologjike, arkitekturore ose kulturore (duke përfshirë të mbrojtur ose të projektuar si të tillë) | Po | Jo |
| Peizazhi ose panorama e qytetit, duke përfshirë zona të përcaktuara peizazhistike ose panoramike                                          | Po | Jo |
| Kushtet demografike, sociale dhe socio-ekonomike (p.sh., punësimi) në zonë                                                                | Po | Jo |
| Ndonjë ndryshim i parashikuar që mund të ndodhë në të ardhmen në mungesë të projektit (situata “Pa projekt”)                              | Po | Jo |
| <b>Kontroll nëse grumbullimi i të dhënave dhe metodat e sondazhit janë të përshtatshme.</b>                                               |    |    |
| <b>Faktorët që duhet të konsiderohen përfshijnë:</b>                                                                                      |    |    |
| Zona e studimit është përcaktuar gjerësisht                                                                                               | Po | Jo |
| Ajencitë përkatëse kombëtare dhe lokale kanë siguruar informacion, ku është dashur                                                        | Po | Jo |
| Burimet e të dhënave janë referuar si duhet                                                                                               | Po | Jo |
| Metodat e përdorura janë të përshtatshme për këtë qëllim                                                                                  | Po | Jo |
| Ndonjë boshllëk/mangësi e rëndësishme të të dhënave është identifikuar dhe mjetet e përdorura për t'u marrë me to janë shpjeguar          | Po | Jo |
| <b>Kontroll nëse identifikimi i ndikimeve dhe parashikimi i efekteve të tyre është i përshtatshëm.</b>                                    |    |    |
| <b>Faktorët për të konfirmuar këtë përfshijnë:</b>                                                                                        |    |    |
| Është evidente se është adaptuar një qasje sistematike për identifikimin e ndikimit                                                       | Po | Jo |
| Është evidente që publiku i ndikuar është konsultuar rreth identifikimit të ndikimit                                                      | Po | Jo |
| Ka një përshkrim dhe, ku është e përshtatshme një vlerësim sasior i efekteve direkte, primare mbi:                                        | Po | Jo |
| - tiparet gjeologjike dhe karakteristikat e tokave;                                                                                       | Po | Jo |
| - faunën dhe florën dhe habitatet;                                                                                                        | Po | Jo |
| - hidrologjinë dhe cilësinë e ujit;                                                                                                       | Po | Jo |
| - përdorimet e mjedisit ujor;                                                                                                             | Po | Jo |
| - cilësinë e ajrit dhe kushtet klimatike;                                                                                                 | Po | Jo |
| - mjedisin akustik (zhurma dhe vibrimi);                                                                                                  | Po | Jo |
| - ngrohja, ndriçimi ose rrezatimi elektromanjetik;                                                                                        | Po | Jo |
| - asetet materiale dhe pakësimi i burimeve natyrore të parinovueshme;                                                                     | Po | Jo |
| - vendndodhjet ose tiparet e rëndësishme kulturore;                                                                                       | Po | Jo |
| - cilësia e peizazhit dhe pamjet panoramike dhe pikat e vrojtimit;                                                                        | Po | Jo |
| - demografia, kushtet sociale dhe socio-ekonomike në zonë.                                                                                | Po | Jo |
| Ka një përshkrim dhe, ku është e përshtatshme, një vlerësim sasior të efekteve sekondare për ndonjë nga pikat e mësipërme <sup>1</sup>    | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet e përkohshme, afatshkurtra                                                                                        | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet e përhershme mbi mjedisin                                                                                         | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet afatgjata të shkaktuara nga operimet gjatë gjithë jetës së projektit ose akumulimi i ndotësve                     | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet që mund të rezultojnë nga aksidentet ose katastrofat natyrore ose njerëzore                                       | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet e aktiviteteve ndihmëse (p.sh., ndërtimi i infrastrukturës, furnizimi me energji)                                 | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet indirekte të shkaktuara nga zhvillime të njëpasnjëshme                                                            | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet kumulative të projektit dhe zhvillimeve të tjera ekzistuese ose të planifikuara                                   | Po | Jo |
| Janë përshkruar faktorët që ndikojnë rëndësinë/domethënien e çdo efekti (kohëzgjatjen, frekuencën etj.)                                   | Po | Jo |
| Janë përshkruar efektet primare dhe sekondare mbi shëndetin e njerëzve dhe mirëqenien                                                     | Po | Jo |

<sup>1</sup> Ndikime sekondare janë ato ndikime që shkaktohen nga ndikimet primare mbi aspekte të tjera të (p.sh. efekte mbi faunën, florën dhe habitatet të shkaktuara nga ndotja e tokës, ajrit apo ujit ose zhurma; efekte mbi përdorimet e ujit të shkaktuara nga ndryshimet në hidrologji ose cilësinë e ujit; efekte mbi mbetjet arkeologjike të shkaktuara nga tharja e tokave).



|                                                                                                                                                                        |    |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| Janë përshkruar ndikimet, mbi çështje të tilla si: biodiversiteti, ndryshimi klimatik global dhe zhvillimi i qëndrueshëm                                               | Po | Jo |
| <b>Kontroll nëse domethënia e efekteve është parashikuar në mënyrë të përshtatshme dhe e shpjeguar qartë. Informacioni duhet të përfshijë:</b>                         |    |    |
| Përputhshmërinë e ndikimeve me kërkesat ligjore dhe/ose standardet dhe udhëzuesit                                                                                      | Po | Jo |
| Efektet pozitive mbi mjedisin, si dhe efektet negative                                                                                                                 | Po | Jo |
| Metodat e përdorura për të parashikuar efektet, arsyet për zgjedhjen e tyre dhe ndonjë paqartësi në rezultatet                                                         | Po | Jo |
| Rastet më të këqija të parashikimeve, ku ka paqartësi rreth ndikimeve të sakta                                                                                         | Po | Jo |
| Një diskutim mbi vështirësitë në përpilimin e të dhënave të nevojshme                                                                                                  | Po | Jo |
| Bazat mbi të cilat është bërë vlerësimi i domethënies dhe rëndësisë së ndikimeve                                                                                       | Po | Jo |
| Një përshkrim i ndikimeve pasi është zbatuar baza e të gjitha masave zbutëse të propozuara                                                                             | Po | Jo |
| <b>Kontroll nëse janë të kënaqshme propozimet për zbutje dhe menaxhim mjedisor Informacioni duhet të përfshijë:</b>                                                    |    |    |
| Mundësinë për zbutjen e ndonjë efekti negativ domethënës në mjedis                                                                                                     | Po | Jo |
| Një përshkrim të masave dhe efektit të të gjitha masave zbutëse të propozuara                                                                                          | Po | Jo |
| Një shpjegim të paqartësive të shoqëruara me efektivitetin e masave zbutëse                                                                                            | Po | Jo |
| Një shpjegim se si zhvilluesi do të sigurojë që zbutja do të financohet dhe do të zbatohet                                                                             | Po | Jo |
| Arsyet për zgjedhjen e zbutjes së propozuar                                                                                                                            | Po | Jo |
| Një shpjegim për ndonjë rast kur mund të kemi ndikime domethënëse negative por zbutja nuk është propozuar                                                              | Po | Jo |
| Evidencë që është marrë në konsideratë e gjithë gama e metodave për zbutje                                                                                             | Po | Jo |
| Propozime për të monitoruar dhe për të menaxhuar ndikimet jo të drejtpërdrejta                                                                                         | Po | Jo |
| Një përshkrim i ndonjë ndikimi negativ në mjedis i zbutjes së propozuar                                                                                                | Po | Jo |
| <b>Kontroll nëse raporti ka një përmbledhje joteknike të përshtatshme dhe të paraqitur mirë në mënyrë të arsyeshme. Faktorët që duhet të konsiderohen, përfshijnë:</b> |    |    |
| · Informacioni i paraqitur duhet të përfshijë një përmbledhje joteknike që:                                                                                            | Po | Jo |
| - siguron një informacion konçiz, por gjithëpërfshirës;                                                                                                                | Po | Jo |
| - thekson paqartësitë domethënëse;                                                                                                                                     | Po | Jo |
| - shpjegon procesin e lejes së zhvillimit dhe rolin e VNM-së;                                                                                                          | Po | Jo |
| - siguron një vështrim të përgjithshëm të përqasjes ndaj vlerësimit;                                                                                                   | Po | Jo |
| - shmang termat teknike, të dhëna të detajuara dhe diskutimin shkencor;                                                                                                | Po | Jo |
| - është i kuptueshëm për të gjithë publikun.                                                                                                                           | Po | Jo |
| <b>· Raporti i VNM-së duhet:</b>                                                                                                                                       |    |    |
| - të jetë i organizuar logjikisht dhe i strukturuar qartë;                                                                                                             | Po | Jo |
| - të ketë një tabelë të përmbajtjes në fillim të dokumentit/dokumenteve;                                                                                               | Po | Jo |
| - të përshkruajë qartë procesin që është ndjekur;                                                                                                                      | Po | Jo |
| - të shmangë paraqitjen e të dhënave dhe të informacionit të panevojshëm;                                                                                              | Po | Jo |
| - të përdorë me efektivitet tabelat, figurat, hartat, fotografitë dhe grafikët e tjerë;                                                                                | Po | Jo |
| - të përdorë me efektivitet shtojcat për të paraqitur të dhëna të detajuara;                                                                                           | Po | Jo |
| - të prezantojë të dhëna dhe evidenca për të mbështetur analizat dhe konkluzionet;                                                                                     | Po | Jo |
| - t'u referohet me korrektësi të gjitha burimeve të të dhënave;                                                                                                        | Po | Jo |
| - të përdorë terminologji konsistente në të gjithë dokumentacionin/dokumentet;                                                                                         | Po | Jo |
| - të lexohet si një dokument i vetëm me ndërthurje referencash sipas nevojës;                                                                                          | Po | Jo |
| - të prezantohet sa më shumë të jetë e mundur në një mënyrë të paanshme dhe objektive.                                                                                 | Po | Jo |



## SHTOJCA 1

## MARRJA NË KONSIDERATË E ALTERNATIVAVE DHE APLIKIMI I ANALIZAVE SHUMËKRITËRËSHE NË VNM

**MESAZHET KRYESORE**

1. Është një praktikë e mirë që të merren në konsideratë alternativat e zhvillimit të projektit dhe ndikimet e tyre shoqëruese mjedisore gjatë fazës së planifikimit të projektit.
2. Ekzaminimi i alternativave mund të jetë i njëkohshëm me procesin e VNM-së, por, në këtë rast, duhet të përfshijë të gjithë grupin e punës dhe të konsiderojë të gjithë faktorët e ndryshëm që ndikojnë zgjedhjen ndërmjet opsioneve, jo vetëm mjedisin.
3. Vetëm ato alternativa që janë të përshtatshme dhe të arsyeshme, në terma të kontekstit të projektit duhet të konsiderohen. Llojet e alternativave që do të jenë të përshtatshme dhe të arsyeshme do të varen nga konteksti i projektit, por mund të përfshijnë alternativat që lidhen me vendndodhjen dhe ato strategjike dhe alternativat që lidhen me projektin.
4. Alternativat mund të kenë nevojë të konsiderohen në stade të ndryshme të zhvillimit të një projekti dhe në çdo stad mund të ketë disa përsëritje, si rezultat i një vlerësimi të shpejtë, paraprak, të një liste të gjatë të opsioneve, nëpërmjet një investigimi më të detajuar të një liste të shkurtuar, në zgjedhjen e opsionit të preferuar. Në çdo stad, opsioni ose opsionet e identifikuar duhet të jenë subjekt i rishikimit ose modifikimit para se të konsiderohen më tej, në stadin tjetër.
5. Mënyrat e analizave shumëkriterëshe mund të përdoren për të ndihmuar në nxjerrjen dhe klasifikimin e informacionit për një numër opsionesh, alternativash, por opsioni i preferuar duhet të zgjidhet, gjithmonë, nëpërmjet një procesi debati dhe konsensusi brenda grupit vendimmarrës.
6. Ky mund të jetë një grup i brendshëm i stafit të projektit ose ky grup mund të përfshijë palë të jashtme të interesuara, sipas kontekstit të projektit. Nëse nuk përfshihen direkt palë të jashtme të interesuara, është e rëndësishme të merren në konsideratë se si do të jenë pikëpamjet e tyre.
7. Metodatat e vlerësimit të opsioneve, përkundrejt kritereve të vlerësimit, nuk duhet të jenë më të komplikuar se sa duhet; të fillojnë me shumë të thjeshta, teknika “të përafërta dhe të gatshme”, për të shkuar drejt metodave më të sofistikuar, kur është e nevojshme për të zgjedhur ndërmjet opsioneve.

**HYRJE**

Gjatë depozitimit të aplikimit për miratim, një zhvillues në informacionin mbi mjedisin të përfshijë: “... një përmbledhje të alternativave kryesore të studiuara nga zhvilluesi dhe një shpjegim mbi arsyet kryesore të zgjedhjes që bën duke marrë parasysh dhe pasojat në mjedis të tyre”.

Sipas ligjit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis informacionin që do të dorëzojë zhvilluesi në përshkrimin e projektit të propozuar përfshin dhe informacionin mbi alternativat e marra në konsideratë në kuptimin e vendzbatimit të projektit dhe teknologjisë që do të përdorë. Ky seksion do të diskutojë tipat e alternativave që mund të kenë lidhje me kontekstin e VNM-së dhe përpunon një kuadër për vlerësim paraprak, krahasim dhe zgjedhjen ndërmjet alternativave duke u bazuar në teknikat e analizës shumëkriterëshe. Më poshtë paraqiten dhe vlerësimet e mëtejshme mbi

shumëllojshmërinë e metodave të analizës shumëkriterëshe, ku përdoren analiza ekonomike në krahasimin e alternativave.

Është e rëndësishme të nënvizojmë se zhvilluesi duhet të marrë në konsideratë alternativat gjatë fazës së hartimit të projektit ose çdo alternativë duhet të jetë objekt i një VNM-je të plotë, por nënkupton atë që atje ku zhvilluesi, gjatë hartimit të projektit, ka marrë në konsideratë alternativat duhet të shpjegohet se çfarë janë këto alternative, si dhe arsyet pse u zgjodhën, përfshi dhe arsyet mjedisore, në analizat shumëkriterëshe. Kjo kërkesë, lidhur me diskutimin e alternativave, është e rëndësishme për një sërë arsyes:

- Nxiti zhvilluesit që të mendojnë me kujdes rreth çështjes së objektivave që shtynë përpara propozimin për një projekt për miratim dhe, nëse ekzistojnë, mundësitë e arritjes së objektivave me sa më pak ndikim në mjedis;



- Diskutimi mbi alternativat krijon një sfond të dobishëm mbi historikun e projektit, si dhe si kanë evoluar propozimet gjatë zhvillimit të tyre;

- Gjatë argumentimit të tyre për përzgjedhjen e projektit të tyre, zhvilluesit inkurajohen për dhënien e shpjegimeve të nevojës për vënien në jetë të tij dhe se si përkon me objektivat politike, rregullatore dhe ekonomike;

- Kjo i bën me dije autoritetet kompetente për sasinë e opsioneve në dispozicion që mund të merren parasysh për shmangien ose reduktimin e ndikimeve negative;

- Lejon palët e interesuara të kuptojnë arsyet e zhvilluesit për propozimin e projektit në fjalë.

Marrja në konsideratë e alternativave:

- Shpjegon arsyen pse zhvilluesi ka hartuar projektin në fjalë;

- Përshkruan procesin përmes të cilit zhvilluesi ka arritur në projektin në fjalë;

- Përshkruan alternativat që janë marrë parasysh gjatë procesit;

- Përgjithëson avantazhet dhe dizavantazhet e secilës prej alternativave, përfshi dhe çështjet mjedisore;

- Shpjegon si u morën parasysh në marrjen e vendimit rreth propozimit;

- Nëse alternativat më të mira janë hedhur poshtë, shpjegon arsyet pse faktorët e tjerë u konsideruan si më të rëndësishëm në avantazhet mjedisore.

Alternativat, që janë të përshtatshme për një projekt konkret, duhen marrë në konsideratë gjatë hartimit të tij, me qëllim që të programohen veprimtaritë e duhura gjatë studimeve mjedisore.

Roli i analizave shumëkriterëshe (ASHK)

Marrja në konsideratë e alternativave të ndryshme është një nga kërkesat bazë për procedurat e VNM-së. Analiza dhe krahasimi i alternativave të ndryshme (si në nivel strategjik dhe të një projekti) nënkupton balancimin e tipave të ndryshëm të ndikimit, duke njohur të mirat e çdo opsiioni dhe eventualisht arritjen e një renditjeje të preferencave ndaj tyre. Kjo kërkon një kuadër që integron informacionin faktik mbi efektet dhe ndikimet, me vlerat dhe preferencat e vendimmarrësve dhe palëve të interesuara.

Teknikat e ASHK-së ofrojnë një kuadër të tillë, dhe për këtë arsye po përdoren gjithnjë e më shumë në VNM. Mjaft metoda janë në dispozicion të zhvilluesve dhe ekipeve të tyre të projektit në

investigimin e opsioneve pro ose kundër të alternativave dhe zgjidhjen ndërmjet tyre.

ASHK-ja mund të përcaktohet si një përqasje e strukturuar për krahasimin e alternativave dhe ndihmon për zgjedhjen e një ose disa opsioneve të preferuara, kur zgjedhja duhet të marrë parasysh një tërësi kriteresh të ndryshme (shumëfishta) vendimmarrjesh.

Tërësia e kriterëve të vendimmarrjes që mund të merren në konsideratë gjatë përdorimit të ASHK-së ndryshon në varësi të interesave të zhvilluesit.

Këto, zakonisht, përfshijnë faktorë të një rëndësie të dorës së parë për sipërmarrjen, të tillë si kriteret tregtare dhe ekonomike dhe përputhjen me objektivat dhe politikën e saj. Përfshihen dhe faktorë të tjerë si ato të arritjes së objektivave përmes rrugës më të lehtë. Zhvillues të përgjegjshëm marrin parasysh objektivat më të gjerë sociale, të tillë si minimizimin e ndikimeve sociale e mjedisore.

Përqasja e ASHK-së janë metodat e marrjes parasysh të kriterëve të shumëfishta të vendimmarrjes në vlerësimin paraprak të alternativave. Ato mund të përdoren në përzgjedhjen midis alternativave në fazat e ndryshme të zhvillimit të projektit, që prej vendimeve të para rreth opsioneve strategjike, përmes zgjedhjeve të vendndodhjes dhe teknologjive e deri te konsideratat e detajuara të opsioneve gjatë hartimit të projektit. Në secilën prej këtyre fazave përqasja e ASHK-së mund të përdoret për identifikimin e një opsiioni të preferuar, të përzgjedhë disa opsione nga tërësia e tyre ose thjesht të eliminojë mundësi të papranueshme. Në çdo rast është me rëndësi të kuptohet se metodat e ASHK-së janë mjaft të dobishme në përzgjedhjen e informacionit mbi një numër alternativash në një nga format më të menaxhueshme, por që mund të përdoren rrallë për dhënien e një përgjigje përfundimtare mbi “opsionin më të mirë”. Metodatat e ASHK-së janë të dobishme edhe si inpute në marrjen e vendimeve, por nuk mund të zëvendësojnë rolin e gjyguesve të vërtetë nga ana e vendimmarrësve përkatës.

Tipat e alternativave

Alternativat janë, në thelbin e tyre, mënyra të ndryshme, përmes të cilave zhvilluesi mund të arrijë objektivat e tij. Ato mund të jenë alternativa të hapura për zhvilluesin në nivele të ndryshme që nga, p.sh., zhvillimi i ndryshuar i projektit përmes





ndërrimit të vendndodhjes së projektit, përdorimit të një teknologjie tjetër apo kuadrit të projektit. Alternativat mund të merren parasysh edhe në një nivel më të detajuar, p.sh., në zgjedhjen ndërmjet elementeve të ndryshme të veçanta të projektit, alternativave ndërtuese apo metodave operative. Në praktikë, alternativat formojnë një spektër të vazhdueshëm me masa lehtësuese dhe ka shumë rëndësi konsiderimi si të tilla brenda proceseve të VNM-së.

Në fund duhet të mendojmë rreth tri llojeve (shtresave) të alternativave: strategjike, alternative lidhur me vendndodhjen dhe alternativat lidhur me hartimin e projektit. Vendimi për të “mos bërë asgjë” është opsion për disa zhvillues. Këta tipa alternativash do të diskutohen në vijim.

#### Alternativat e vendndodhjeve

Ligji në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis kërkon që nga ana e zhvilluesit të sillet informacion rreth alternativave të marra në konsideratë mbi vendndodhjen e projektit. Kjo ka lidhje me faktin që tipa më të shpeshtë të alternativave të marra në konsideratë në VNM, kanë të bëjnë me vendndodhjen e projektit. Do të ishte me vend që në rast se nuk është parashikuar vendndodhja në plan ose kërkohet një vend i ri nga zhvilluesi, në projekt-VNM-në të merren në konsideratë të gjitha opsionet.

Disa zhvillues, p.sh., kur një kompani private së cilës i jepet një copë toke për qëllime të tilla, si ndërtim shtëpish ose aktivitet industriale, nuk janë të prirur të marrin në konsideratë vendndodhje alternative, por për disa zhvillime vendndodhja nuk është kaq e detyrueshme.

Kjo ndodh më shpesh në zhvillimin e sektorit publik, të tilla si rrugët, por mund të jetë, gjithashtu, e njëjtë edhe për zhvillimet private, ku një numër i konsiderueshëm i vendndodhjeve mund të jenë në dispozicion të zhvilluesit. Ndonjëherë mund të mos jetë e mundur që të merren në konsideratë vendndodhjet alternative për të tërë zhvillimin, por mund të ketë opsione për pjesë të projektit, për shembull, pikë shkarkimi uji për një fabrikë të re apo nyjat lidhëse në një autostradë të re. Kjo mund të jetë edhe në rastin ku pjesë të zhvillimit janë fikse, për shembull në miniera, ku, edhe pse burimet minerale nëntokësore janë në një vendndodhje fikse, sipërfaqja e minierës mund të jetë e vendosur në një numër të ndryshëm vendesh.

Atje ku vendndodhjet alternative janë marrë në konsideratë gjatë planifikimit të projektit, raporti mjedisor duhet të diskutojë mbi ato dhe të shpjegojë arsyen e përzgjedhjes së vendndodhjes në fjalë. Shpesh, kjo do të përfshijë një numër fazash që kanë çuar në zgjedhjen e alternativës së preferuar, duke filluar me identifikimin e të gjitha vendndodhjeve të mundshme në një zonë të gjerë të kërkimit, pastaj të mbashqyrtimit të listës së gjatë të vendndodhjeve të mundshme për të hartuar një listë më të shkurtër, dhe më në fund duke zgjedhur vendndodhjen më të mirë nga lista e shkurtër. Hartimi i hartës së vendndodhjeve është një mjet i dobishëm për të ndihmuar në identifikimin e vendeve të mundshme dhe sistemi i informacionit gjeografik siguron mjete të dobishme për këtë proces. Për zhvillimet lineare, të tilla si: lidhjet e transportit, linjat e energjisë elektrike dhe tubacionet, është e zakonshme që të fillohet me një sipërfaqe të gjerë kërkimi, zgjedhjen e një numri të korridoreve brenda kësaj, zgjedhjen e një ose më shumë korridoreve të preferuara, shqyrtimin e rrugëve alternative brenda këtyre, dhe më pas përsosjen e këtyre në vlerësime më të detajuara horizontale dhe vertikale. Termi “alternativë” është përdorur nganjëherë për të përshkruar këtë proces të axhustimit progresiv të projektpropozimeve.

#### ALTERNATIVA E DIZENJIMIT

Diversiteti më i gjerë i alternativave të mundshme lind në lidhje me hartimin e projektit. Nëse projekti përfshin një proces prodhimi, mund të jetë e mundur të merren në konsideratë teknologjitë alternative ose lëndët e para që kanë më pak ndikim, për shembull, ndërtimi i një turbine gazi me cikël të kombinuar përkundrejt një termocentrali me qymyr. Alternativat e projektimit mund të përfshijnë, gjithashtu, kufijtë e vendndodhjes dhe pamjen e brendshme, të sipërfaqeve të mëdha apo të vogla të objektit ose numrat e njërive, të tilla si turbinat me erë apo të shtëpive, lartësi të ndryshme për ndërtesat ose oxhaqet, përfundime të ndryshme për strukturat e jashtme dhe kështu me radhë.

Në disa pika të spektrit, këto lloje të alternativave shkrihen në zbutje/reduktim të detajuar. Megjithatë, si parim i përgjithshëm, kur ka shumë opsione të qarta në dispozicion për një zhvillues për çfarëdo aspekti të një projekti dhe kur këto janë krahasuar gjatë planifikimit të projektit, është praktikë e mirë diskutimi i këtyre opsioneve



dhe përfshirja e tyre në raportin mjedisor si alternativa.

#### ALTERNATIVA E TË MOSBËRIT ASGJË (SKENARI PASIV)

Opsioni i “Të mosbërit asgjë” (*To Do Nothing*) është përmendur shpesh si një alternativë në VNM. Në praktikë për shumë zhvillime, dhe sigurisht për shumicën e projekteve të sektorit privat, opsioni i të mosbërit asgjë, nuk është një alternativë reale; qëllimi i zhvilluesit privat është për të marrë pëlqimin për zhvillimin dhe për autoritetin kompetent dhënia e pëlqimit të zhvillimit, e të vendosë nëse është më i preferuar zhvillimi apo skenari i të mosbërit asgjë (skenari pasiv).

Në këtë kuptim, është më e dobishme për të marrë në konsideratë situatën e “Të mosbërit asgjë”, si bazë për vlerësimin e ndikimit dhe jo si një alternativë në të drejtën e vet. Ndikimi i projektit është përshkruar në termat e diferencës midis situatës mjedisore me dhe pa projekt. Në kërkimin mbi bazën e “Të mos bërit asgjë”, është e rëndësishme të mbahet mend se mjedisi do të ndryshojë edhe në qoftë se projekti nuk do të shkojë përpara si një rezultat i zhvillimeve të tjera dhe trendeve më të gjera. Kjo “bazë lëvizëse” duhet të konsiderohet si pjesë e vlerësimit. Pavarësisht llojit të zhvillimit, mund të jetë e nevojshme të parashikohet baza e “Të mos bërit asgjë”, në faza të ndryshme, për shembull, gjatë periudhës së planifikuar të ndërtimit, në kohën e hapjes së projektit, gjatë fazave të ndryshme të funksionimit të tij, dhe ndoshta pas përfundimit të tij. Alternativa e “të mosbërit asgjë” merr vlera të veçanta në mjedise specifike.

Megjithatë ka, disa rrethana ku “Të mos bërit asgjë” është një opsion real për një zhvillues. Shembujt kryesorë janë në investimet në infrastrukturë publike, ku opsioni i mosndërtimit të një të rruge të re apo vepra të trajtimit të ujërave të zeza mund të jetë një alternativë e arsyeshme për autoritetin përkatës. Si me bazën e “Të mos bërit asgjë”, alternativa e “Të mos bërit asgjë”, duhet të marrë në konsideratë veprime të tjera dhe ndryshimet mjedisore që do të lindin në mungesë të projektit. Kjo është përmendur shpesh si alternativë e zhvillimit minimal, për shkak se autoriteti publik do të vazhdojë të bëjë minimumin e nevojshëm për të ruajtur sistemin, por nuk do të bëjë investim të madh të ri të projektit. Ndikimet e

alternatives së bërjes minimale, do të përfshijnë cilindo nga ndikimet e këtyre veprimeve të tjera.

#### LISTA E KONTROLLIT E ALTERNATIVAVE

Një listë e plotë e dobishme për llojet e alternativave që mund të merren parasysh gjatë zhvillimit të një projekti janë dhënë më poshtë. Ndonjëra prej këtyre alternativave ose të gjitha mund të jenë të përshtatshme për projekte të ndryshme dhe kjo është e rëndësishme për hartuesit e VNM-së të konsiderojnë dhe të keshillojnë zhvilluesin, nëse janë apo jo të përshtatshme dhe praktikë e mirë për t'i konsideruar ato në kuadër të një projekti të veçantë. Kur një zhvillues nuk ka menduar për alternativa të mundshme, ekipi i VNM-së duhet të diskutojë me të, nëse ka ndonjë mënyrë tjetër të arsyeshme për të vazhduar me ndonjë zhvillim që do të ketë më pak ndikim në mjedis, i cili tashmë duhet të merret parasysh. Kjo duhet të bëhet në fazën e VNM-së së thelluar.

Lista e plotë e llojeve të alternativave të paraqitura më poshtë nuk është gjithëpërfshirëse dhe zhvilluesi i saj dhe hartuesit e VNM-së, duhet gjithmonë të konsiderojnë opsionet specifike që mund të jenë të përshtatshme për një projekt të veçantë, duke marrë parasysh objektivat e zhvilluesit në promovimin e zhvillimit.

Llojet e alternativave:

- Masa për të menaxhuar kërkesën për mallra apo shërbime (p.sh., veprimet e efikasitetit të energjisë);
- Masa për të ruajtur ose për të zvogëluar konsumin e burimeve (p.sh., kontrollimi rrjedhjes);
- Qasjet e ndryshme për të përmbushur kërkesën (p.sh., vendosja e çmimit për përdorimin e rrugës);
- Vendndodhjet ose rrugët;
- Proceset ose teknologjitë;
- Metodatat e punës (p.sh., trajtimin e materialeve manualisht apo automatizim);
- Planet e vendndodhjes dhe pamja që do të kenë;
- Projekti i strukturave (p.sh., madhësia e ndërtimit, forma apo paraqitja; lartësia e oxhakut);
- Llojet dhe burimet e materialeve (p.sh., burimet të agregateve vendore apo të importuara);
- Kohëzgjatja e ndërtimit, operimit dhe mbylljes në çdo fazë;



- Datat e fillimit dhe të përfundimit (p.sh., fillimi i ndërtimit në verë apo në dimër);

- Madhësia e vendit ose e objektit (p.sh., sa m<sup>2</sup> zyra ose hapësirë të shitjes (dyqane me pakicë); zona e hapësirës së hapur);

- Numri i njërive operuese (p.sh., shtëpitë, turbinat, vendparkimet);

- Niveli i prodhimit (p.sh., kapaciteti MW, shkalla e prodhimit);

- Kontrolli i hyrjeve dhe rrugët për trafikun nga dhe në objekt/strukturë;

- Sigurimi dhe vendndodhja e objekteve ndihmëse (p.sh., hedhja e mbeturinave, puse të huazuara, furnizimi me energji elektrike, strehim);

- Sistemimi i prishjeve, rehabilitimi i sipërfaqes/territorit dhe kthim në gjendjen e mëparshme;

- Të mos bësh asgjë (skenari pasiv) ose zhvillime minimale.

#### RËNDËSIA E ALTERNATIVAVE PËR PROJEKTIN

Kur merren në konsideratë alternativat, është e rëndësishme që të konsiderohen opsionet e vetme që janë të përshtatshme dhe të arsyeshme në aspektin e kontekstit të projektit. Llojet e alternativave që merren në konsideratë realisht nga zhvilluesi do të variojnë. Për shembull:

- Një kompani për nxjerrjen e mineraleve që ka blerë një parcelë toke me shpresën e nxjerrjes së rërës dhe të zhavorrit nga ajo, nuk do të konsiderojë mundësinë e saj për zhvillimin e strehimit (shtëpive) ose të turbinave të erës, por do të ishte e arsyeshme të konsideronte shkallën dhe fazën e operacionit të nxjerrjes, paraqitjen e saj dhe proceset alternative për nxjerrjen dhe depozitimin e mbeturinave, dhe planet alternative për rehabilitimin e sipërfaqes pasi nxjerrja e mineraleve ka përfunduar ose pasi miniera është mbyllur.

- Në të kundërt, një kompani uji private mund të pritët të marrë në konsideratë opsionet strategjike të menaxhimit të kërkesës, të tilla si: matësit dhe furnizimin me pajisje të kursimit të ujit dhe veprimet për të kontrolluar rrjedhjet, para se të marrë parasysh zhvillimin e një furnizimi të ri. Kjo pastaj mund të konsiderojë opsionet e ndryshme për sigurimin e furnizimit, duke përfshirë transferimin ndërbasenor, nxjerrjen e ujërave nëntokësore, një rezervuar të ri ose edhe shkripëzimin, si dhe opsionet për vendosjen dhe dizenjimin e objekteve të reja që janë identifikuar si

të nevojshme, dhe në fund opsione teknologjike për trajtimin e ujit dhe shpërndarjen.

Pika e rëndësishme për t'u marrë parasysh është se çfarë është dhe çfarë nuk është në përgjegjësinë normale të biznesit ose të sektorit publik të propozuesit të projektit. Kjo është vetëm ajo që zhvilluesi ka nevojë për të diskutuar në një raport mjedisor. Kjo nuk pengon autoritetin kompetent për të marrë parasysh nëse ka alternativa të tjera jashtë biznesit të zhvilluesit, të cilat dëshiron t'i marrë parasysh në marrjen e vendimit për lejen e zhvillimit, por këto mund të kenë nevojë të hulumtohen përmes ndonjë rruge tjetër, përveç raportit mjedisor të zhvilluesit.

Është gjithashtu e rëndësishme të kujtojmë se zgjedhjet e projektit janë bërë duke marrë në konsideratë një gamë të tërë të faktorëve të ndryshëm, jo vetëm ato mjedisorë. Hartuesit e VNM-së, pra, do të jenë pjesë e procesit duke propozuar alternativat e mundshme, por vendimi se çfarë alternativash të marrin në konsideratë dhe zgjedhja ndërmjet këtyre alternativave është për t'u bërë nga zhvilluesi, duke pasur parasysh të gjithë faktorët relevantë të ndryshëm në biznes.

#### ALTERNATIVAT E VLERËSIMIT DHE TË KRAHASIMIT

Zgjedhja e alternativës më të mirë të projektit në çdo pikë të planifikimit të një projekti kërkon marrjen sistematike në konsideratë të gamës së opsioneve në dispozicion në atë fazë të projektimit, duke krahasuar avantazhet dhe dizavantazhet e tyre, dhe përmes përsëritjes dhe përsosjes, duke afruar atë që i adresohet më shumë objektivave të zhvilluesit.

Në shumicën e projekteve ka faza në të cilën opsionet duhet të merren në konsideratë. Zgjedhjet në secilën fazë kanë të ngjarë të varen nga shumë faktorë të ndryshëm - kostoja, rreziku, fisibiliteti inxhinierik, kompleksiteti operacional, disponueshmëria e punëtorëve të kualifikuar, ndikimet ekonomike-lokale, gjenerimi i punësimit, dhe sigurisht ndikimi në mjedis. Të gjithë këta duhet të peshohen/vlerësohen ndaj njëri-tjetrit për të vendosur mbi opsionin më të mirë. Vendimet si ky, të cilat përfshijnë shumë faktorë të ndryshëm janë të njohura si vendime multiatribut ose multikriter dhe metodat, analiza shumëkritereshe (ASHK) të ndryshme janë zhvilluar për të ndihmuar në këtë lloj problemi.



Në kontekstin e planifikimit të projektit dhe të VNM-së, metodat ASHK përdoren për të ndihmuar në zgjedhjen e opsionit (ose opsioneve), të cilat arrijnë balancën më të mirë në mes të gjithë faktorëve të ndryshëm relevantë për vendimin. Zakonisht këto do të përfshijnë ndikime negative dhe të dobishme ekonomike, mjedisore dhe sociale (shpesh të referuara si kosto dhe përfitime) dhe këto mund të ndikojnë në palët e ndryshme të interesuara dhe ndodhin në afate të shkurtër dhe të gjatë. Metodatat ASHK sigurojnë mjetet për renditjen e këtij informacioni dhe për të përdorur atë për të arritur në zgjedhje më të mirë.

Si një rregull i përgjithshëm, qëllimi duhet të jetë përdorimi i metodës më të thjeshtë që lejon realizimin e një zgjedhjeje të fuqishme. Nëse një metodë e thjeshtë nuk është e mjaftueshme për të lejuar identifikimin e alternativave, atëherë mund të përdoren metoda më të ndërlikuara deri sa të bëhet e mundur një zgjedhje. Ky seksion përshkruan se si një tërësi mjetes mund të përdoren në një proces hap pas hapi për të vlerësuar, krahasuar dhe për të zgjedhur midis alternativave për një projekt tipik. Siç u tha më sipër, procesi duhet të përsëritet disa herë gjatë planifikimit të projektit për tipa të ndryshëm alternativash.

#### Hapi 1. përcaktimi i opsioneve fillestarë

Faza e parë në marrjen në konsideratë të alternativave është identifikimi i gamës së opsioneve të arsyeshme në dispozicion të vendimit në fjalë (p.sh., madhësinë, vendndodhjen, teknologjinë etj.). Të gjitha opsionet duhet të arrijnë objektivat e zhvilluesit dhe duhet të jenë relevante dhe të arsyeshme në kontekstin e projektit. Për alternativat lidhur me vendndodhjen, identifikimi i alternativave, zakonisht përfshin një fazë të parë të përcaktimit të një “zone të kërkimit”, brenda të cilit projekti mund të zbatohet. Vendndodhjet e mundshme brenda kësaj zone mund të identifikohen nga kufizimet hartografike, të tilla si: fizike, përdorimi i tokës, inxhinierike, faktorë mjedisorë dhe të tjerë, si dhe kufizimet e politikave të tilla si hartimi dhe planet e ardhshme zhvillimore. Disa kufizime mund të jenë absolute, kështu që për shembull, nuk është e mundur për të ndërtuar një fabrikë në një shpat shumë të pjerrët ose kur ka banesa ekzistuese, dhe fusha të tilla për këtë arsye duhet të përjashtohen. Të tjerat janë relative dhe duhet të konsiderohen si shkallë të

ndryshme të kufizimit të imponuar mbi përshtatshmërinë e vendeve.

Pasi evidentohen dhe hidhen në hartë shkallët e ndryshme të kufizimeve, alternativat e mundshme mund të zgjidhen duke identifikuar zonat më të mundshme. Kjo mund të bëhet duke përdorur metodologji të mbivendosjes së hartave ose duke përdorur teknologjinë e sistemeve të informacionit gjeografik (GIS). Procesi i mbivendosjes së kufizimeve është në vetvete një formë e analizës së shumëkriterëve dhe duhet të ndjekë parimet e përshkruara këtu.

Si për alternativat që lidhen me vendndodhjen edhe llojet e tjera në dispozicion për zhvilluesit, shpesh ka një numër të madh të opsioneve të mundshme. Një shembull do të jetë në furnizimin me ujë, ku autoritetet përkatëse mund të zgjedhin nga një gamë shumë e gjerë të llojeve dhe të madhësive të objekteve që përmbushin një kërkesë të dhënë për furnizim me ujë (p.sh., rezervuarë të mëdhenj ose më të vegjël të madhësive të ndryshme, të kombinuara me nivele të ndryshme të investimeve në kontrollin e matjeve dhe të rrjedhjeve). Kjo nuk është e qartë praktikisht apo edhe e mundur për të vlerësuar/studiuar të gjitha këto dhe përqasja që përdoret zakonisht në raste të tilla është zgjedhja e një game përfaqësuese të opsioneve për të ilustruar zgjedhjen që duhet bërë dhe më pas aplikimi i një procesi të vlerësimit paraprak, hartimit të një liste të shkurtër dhe vlerësimi për t'u përqendruar në zgjidhjen më të mirë. Zgjedhja përfundimtare nuk mund të jetë një nga opsionet që ishin konsideruar fillimisht por si kombinim midis tyre. Kjo është diskutuar më tej në hapin 5. Në mënyrë që të arrihet në zgjedhje të drejtë në fund të procesit, megjithatë, është e rëndësishme që të mendojmë me kujdes gjatë përcaktimit të gamës fillestare të opsioneve të sigurojmë që këto nuk përjashtojnë zgjidhje të ndjeshme që mund të identifikohen më vonë në proces.

#### Hapi 2. Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit

Me qëllim që të krahasojmë alternativa, është i rëndësishëm identifikimi i faktorëve që janë të përshtatshme për vendimin që duhet marrë. Këto janë zakonisht të referuara si kriterëve të vendimit apo të vlerësimit. Zakonisht, këto grupohen nën një numër të vogël, si: ekonomike, fisibilitet inxhinierik, mjedisore, sociale, sigurie, rreziqe të projektit dhe shprehen si objektiva (p.sh., për të



minimizuar koston, maksimizuar punësimin lokal, minimizuar ndikimin në ruajtjen e natyrës etj.) Për shkak se faktorët e vendimmarrjes janë përshtatur si objektiva (minimizoj, maksimizoj, shmang, arrij), ky lloj i qasjes është nganjëherë quhet “objektivat e drejtuar nga vlerësimi”. Nën çdo objektiv përcaktohen kriteret specifike dhe alternativat maten ose vlerësohen kundrejt këtyre.

Një shembull të llojeve të objektivave dhe kriterëve të vlerësimit që mund të jenë relevante

për një projekt në sektorin e ujit, është përcaktuar në tabelën më poshtë.

Shembull: Objektivat dhe kriteret për alternativat e zhvillimit të burimeve ujore

Duhet, gjithashtu, të përcaktohen treguesit e performancës për çdo kriter dhe metodat për vlerësim.

Shembull. Kriteret e vlerësimit dhe alternativat e vendndodhjes

Minimizimi i koston së zhvillimit:

- Kosto e ndërtimit;
- Kosto vjetore e veprimtarisë;
- Kostot e përgjithshme;
- Mundësia për mbulimin e tyre;
- Maksimizimi i lehtësirave në ndërtim e veprim;
- Lehtësirat lidhur me sistemin ekzistues të furnizimit;
- Lehtësirat e ndërtimit;
- Lehtësirat operacionale;
- Minimizimi i ndikimit në mjedis;
- Ndikimi mbi njerëzit;
- Zhurmat;
- Vizuale;
- Ndikimi në trafik;
- Ndikimi në mjediset çlodhëse;
- Ndikimi në trashëgiminë natyrore dhe kulturore;
- Ekologji;
- Ujë;
- Tokë;
- Bujqësi;
- Trashëgiminë historike;
- Konsumi i energjisë dhe çlirimi i CO<sub>2</sub>;

Minimizimi i rreziqeve të projektit:

- Besueshmëria dhe siguria e furnizimit;
- Paqartësitë në vlerësimin e koston – rreziku i mbikostove;
- Rreziku gjeologjik – stabiliteti sizmik dhe rrëshqitjet.



| Objektivi                                                             | Kriteret e vlerësimit                                                 | Treguesit dhe kriteret e vlerësimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|-----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Minimizimi i ndikimit në njerëz                                       | Ndikimi mbi banorët                                                   | Numri i banorëve që preken nga prishja e shtëpive ose pjesë të pronave si kopshte etj. si rezultat i punimeve. Llogaritja e niveleve të zhurmave nga transportet për ndërtim, duke përdorur modele të thjeshta parashikuese (decibel). Vlerësimi i ekspertëve mbi pluhurat dhe shqetësime të tjera që prekin banorët gjatë ndërtimeve dhe veprimeve të tjera, duke marrë parasysh numrin e shtëpive brenda rrezes prej 50, 100 dhe 500 metra të secilës prej vendndodhjeve alternative. |
|                                                                       | Ndikimi mbi tregtinë apo prona të tjera                               | Si më sipër, por nën këndvështrimin e tregtisë                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
|                                                                       | Ndikimi mbi vendet çlodhëse dhe përdorimit të truallit nga komuniteti | Distanca e vendndodhjes nga pika më e afërt çlodhëse vende të përdorimit nga komuniteti (parqe, rrugë biçikletash, parqe sportive etj.) (km) dhe numri i përafërt i përdorimit të tyre                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|                                                                       | Ndikimi mbi trafikun gjatë punimeve të ndërtimit                      | Gjatësia e rrugëve nga rruga kryesore në vendndodhje (metra) dhe numri i shtëpive anës këtyre rrugëve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|                                                                       | Ndikimi vizual                                                        | Shikueshmëria e zonës nga vende ku mund të ketë prezencë njerëzish (lartë/mesme/ulët) dhe numri i përafërt i njerëzve të prekur                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|                                                                       | Ndërprerje dhe shqetësime                                             | Vlerësimet e ekspertit për ndërprerje të mundshme të trafikut gjatë ndërtimit (lartë/mesme/ulët)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Minimizimi i ndikimeve në mjedisin natyror dhe trashëgiminë kulturore | Ndikimi mbi burimet bujqësore                                         | Sipërfaqja e tokës bujqësore të humbur (hektarë). Numri i fermave të prekura nga marrja e tokës, fragmentizimi dhe humbje të tjera                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|                                                                       | Rrezik nga ndotja e tokës                                             | Prezenca e sipërfaqeve të ndotura në zonë ose në afërsi të zonës; Vlerësimi i ekspertit për punëtorët dhe aktivitete afatgjata nga ndotjet prezente (lartë/mesme/ulët)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|                                                                       | Ndikimi në mjedisin ujor                                              | Gjatësia e rrymave të ujit (në metra) dhe zona e burimeve/ujëmbajtëse të tjerë(m <sup>2</sup> ) të prekur nga shkarkimet prej ndërtimit. Shtrirja në hektarë të tokave që rrezikohen nga përmytjet. Prezenca e shtresave ujëmbajtëse nëntokësore në vendndodhje dhe niveli i prurjeve (m <sup>3</sup> /ditë)                                                                                                                                                                            |
|                                                                       | Ndikimi mbi burimet ekologjike                                        | Prezenca në afërsi (distanca në metra) të zonave përcaktuara (ndërkombëtar, kombëtar, lokale) ose të njohura për vlerat e tyre ekologjike ose zona të banuara nga specie të mbrojtura                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|                                                                       | Ndikimet mbi burimet peizazhore                                       | Humbja e tipareve të përcaktuara peizazhistike. Dhe vlerësimi i ekspertit mbi karakterin dhe cilësinë e peizazhit bazuar në ndjeshmërinë e peizazhit, dhe kapacitetet për të pranuar ndryshimet e kërkuara (të larta/mesme/ulëta)                                                                                                                                                                                                                                                       |
|                                                                       | Ndikimi në burimet historike e kulturore                              | Vlerësimi i ekspertit mbi ndikimin mbi zona arkeologjike, historike dhe të rëndësishme kulturore, ose të një rëndësie të njohur prezente ose në afërsi të vendndodhjes së përcaktuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Minimizimi i ndikimeve në burime dhe klimën globale                   | Konsumi i energjisë dhe shkarkim i CO <sub>2</sub> gjatë veprimtarisë | KWH në vit të energjisë së kërkuar për vënien në jetë të instalimit, i shprehur si ekuivalencë e numrit të shtëpive bazuar në konsumin mesatar të energjisë prej tyre. Vlerësimi i shkarkimit të CO <sub>2</sub> gjatë punës së instalimit/impianitit                                                                                                                                                                                                                                   |



### Hapi 3. Opcionet e vlerësimit

Qëllimi i këtij hapi në procesin në fjalë është që të vlerësojë opcionet e përcaktuara në hapin 1 kundrejt kriterëve të vlerësimit duke përdorur indikatorët dhe metodat e identifikuar në hapin 2.

#### Metodat e vlerësimit

Mund të përdoren një shumëllojshmëri e metodave të ndryshme të vlerësimit, të cilat sigurojnë të dhëna sasiore dhe/ose cilësore në lidhje me efektet pozitive dhe negative të secilit opcion. Siç ilustron në tabelën më poshtë, treguesit mund të jetë mjaft të thjeshtë dhe kërkojnë vetëm metodat të drejtpërdrejta për vlerësim të tilla si matje nga hartat, vlerësimet nga ekspertët, metoda të thjeshta llogaritjeje. Qëllimi

është zgjedhja e indikatorëve që janë të detajuar aq sa janë të nevojshme për të dalluar mes alternativave. Në këtë fazë, shpesh, nuk është e nevojshme që të parashikohen ndikimet, por vetëm siguri i një baze për krahasimin e opsioneve. Kështu për shembull, vendndodhjet mund të krahasohen për potencialin e tyre për të ndikuar njerëzit në aspektin e numrave dhe distancave të shtëpive aty pranë, sesa llogaritja aktuale e niveleve të zhurmës ose të cilësisë së ajrit. Përdorimi i metodave më komplekse të vlerësimit do të jetë i nevojshëm vetëm në qoftë se ajo është e pamundur për të zgjedhur një alternativë të preferuar, duke përdorur këtë informacion.

### Shembuj të ndryshëm ndaj vlerësimit paraprak

Si një shembull, opcionet mund të vlerësohen në aspektin e ndikimit të tyre në ndryshimin e klimës globale:

- duke bërë një vlerësim cilësor duke i kërkuar ekspertëve të vlerësojnë nëse një opcion ka të ngjarë të shkaktojë çlirim gazi të efektit serrë duke e rritur ose ulur sasinë në krahasim me situatën ekzistuese dhe në çfarë shkallë kjo ndodh (të madhe/të moderuar/të vogël; rritje/ulje); ose

- duke llogaritur çlirimet e gazrave serrë në ton ekuivalent të CO<sub>2</sub>, duke përdorur faktorët standardë për prodhimin e energjisë dhe burime të tjera të çlirimeve.

Vlerësimi paraprak i ndikimit të alternativave mbi ekonominë lokale mund të bëhet duke i pyetur agjencitë lokale të zhvillimit të marrin në konsideratë nëse opcionet do të gjenerojnë mundësi më shumë ose më pak për bizneset vendore ekzistuese ose të reja për fillimin e biznesit. Për shembull, ndërtimi i një parku të ri biznesi do të ketë gjasa të tërheqë më shumë njerëz në disa zona sesa të tjerat. Mund të jetë i mundur përcaktimi i sasisë e niveleve të bizneseve që mund të krijohen (ose humbin), por, në qoftë se numrat aktualë nuk mund të parashikohen, duhet të jetë i mundur vlerësimi i drejtimin dhe shkallës së ndikimit - pozitive apo negative, të vogël, të mesme apo të madhe - të opsioneve të ndryshme të lidhur me njëri - tjetrin.

Kur gjykimi ekspert është përdorur si metodë e vlerësimit, mund të jetë e arsyeshme mbështetja vetëm në një ekspert për të dhënë një opinion, por do të ishte më me vlerë nëse mund të konsultohen një numër ekspertësh të ndryshëm për të marrë një gamë të pikëpamjeve. Kjo mund të bëhet individualisht ose duke sjellë së bashku ekspertë për të debatuar rreth çështjes dhe të arrijnë në një pikëpamje të përbashkët mbi opcionet.

Kur përdoren njohuritë lokale për vlerësim, mund të kërkojnë pikëpamjet e një grupi të gjerë të palëve të interesuarve. Sondazhet lokale apo takime të fokusuara të grupeve mund të jenë të dobishme në nxjerrjen e informacionit, duke përplasur pikëpamjet e kundërta dhe zhvillimin e konsensusit mbi meritat e opsioneve të ndryshme.

Metoda e vlerësimit e përdorur duhet të varet në nivelin e detajeve dhe saktësive të nevojshme për secilin rast. Faktorët për t'u marrë në konsideratë në zgjedhjen mbi cilën metodë duhet përdorur do të përfshijnë:

- Nëse dallimi midis opsioneve pritet të jetë vendimtar në zgjedhjen mes tyre - nëse të dy opcionet janë shumë të ngjashëm në të gjitha kriteret përveç njëres, atëherë një metodë më e hollësishme mund të jetë e nevojshme për të vlerësuar opcionet kundrejt një kriteri kyç me



qëllim sigurimin e arritjes së një konkluzioni të fuqishëm;

- Rëndësia e kriterit në zonën lokale mund të jenë të nevojshme më shumë përpjekje për detajime dhe saktësime të mëtejshme të rezultateve për një kriter që ka të bëjnë me një çështje të rëndësishme lokale;

- Nëse rezultatet e vlerësimit ka të ngjarë të jenë të diskutueshme - në qoftë se po, mund të jetë më me vend përdorimi i metodave më të hollësishme ose përfshirja e palëve të interesuara në vlerësim me qëllim që konstatimet të jenë më të kuptueshme;

- Nëse informacioni, koha, burimet dhe niveli i ekspertizës janë në dispozicion për kryerjen e

vlerësimit;

- Natyra e kriterit të vlerësimit dhe nëse performanca kundrejt tij mund të shprehet në mënyrë sasiore apo cilësore vetëm.

Përsëri është e rëndësishme të rikujtohet se metodat nuk duhet të jenë më të sofistikuar (dhe për rrjedhojë koha dhe burimet intensive) se sa nevojitet për të dalluar mes opsioneve, atë më të përshtatshmin.

Të prezantuarit e informacionit

Informacioni mbi performancën e secilit prej opsioneve kundrejt kriterëve të vlerësimit paraparak mund të regjistrohet në një tabelë të vlerësimit të opsioneve (për ilustrim shih tabelën më poshtë).

Shembull. Tabelë e vlerësimit të opsioneve

| Opsioni                                                               | Përshkrim i shkurtër i opsionit                                                            |                                                                       |                               |
|-----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|-------------------------------|
| Vendos numrin e opsionit                                              | Hapësirë për një përshkrim të shkurtër të komponentëve kryesorë të opsioneve që vlerësohen |                                                                       |                               |
| Objektivi                                                             | Kriteri                                                                                    | Objektiv                                                              | Kriteri                       |
| Minimizimi i ndikimeve në mjedisin natyror dhe trashëgiminë kulturore | Ndikimi në burimet ekologjike                                                              | Minimizimi i ndikimeve në mjedisin natyror dhe trashëgiminë kulturore | Ndikimi në burimet ekologjike |
| Ekonomia                                                              | Kosto ndërtimi                                                                             | Ekonomia                                                              | Kosto ndërtimi                |
| Rreziku                                                               | Besueshmëria operationale                                                                  | Rreziku                                                               | Besueshmëria operationale     |

Nëse ka vetëm disa opsione, mund të jetë e mundur mbledhja e informacionit rreth të gjitha opsioneve së bashku në një tabelë: Alternativa kundrejt kriterëve të vlerësimit. Kjo lloj tabele

zakonisht njihet si “matricë”. Një shembull është ilustruar në tabelën më poshtë

Ekstrakt nga një shembull me matricë vlerësimi paraparak

| Kriteri                          | Opsioni A                | Opsioni B                | Opsioni C     | Opsioni C                |
|----------------------------------|--------------------------|--------------------------|---------------|--------------------------|
| Kosto e përgjithshme e projektit | \$10m                    | \$9.5m                   | \$7m          | \$9m                     |
| Ndikimi në pronë dhe njerëz      | 40 shtëpi të zhvendosura | 60 shtëpi të zhvendosura | Pa zhvendosje | 20 shtëpi të zhvendosura |
| Zhurmat                          | I lartë                  | I lartë                  | Mesatar       | Ulët                     |
| Risku teknik                     | Ulët                     | Ulët                     | Ulët          | Mesatar                  |
| Etj.                             |                          |                          |               |                          |

Nëse përdoren tabela me vlerësime të një opsioni të vetëm apo matrica me shumë opsione, është e rëndësishme në këtë fazë regjistrimi i sa më shumë informacioneve që të jetë e mundur në lidhje me ecurinë e opsioneve reale se sa përmbledhjen e rezultateve në këtë fazë - shih hapin 4. Për këtë arsye matrica nuk duhet të përdoret në këtë fazë nëse ajo përmbledh shumë informacion, pasi kjo do të kufizojë informacionin

në dispozicion për hapin e ardhshëm. Vlerësimi duhet gjithashtu të nxjerrë në pah ndonjë paqartësi në lidhje me rezultatet në mënyrë që ata që e përdorin atë për vendimmarrje të kuptojnë besueshmërinë e informacionit.

Hapi 4. Krahasimi, përzgjedhja dhe hartimi i listës së shkurtër të opsioneve të preferuar

Kur vlerësimi është i plotë për të gjitha opsionet, informacioni mund të përdoret për





krahasimin e tyre dhe zgjedhur një prej tyre. Kjo fazë është kyçi për analizë shumëkriterëshe (ASHK). Ka një numër mënyrash për të bërë këtë. Sa për fillim, metoda të thjeshta të tilla si ato që bëjnë renditje mund të jenë të mjaftueshme për të identifikuar pa dyshim opsionet me performancë të mirë ose të keqe. Nëse jo, qasje më komplekse mund të përdoren, të tilla si vlerësimi me pikë dhe ponderimi, vlerësimi monetar ose sipas të ashtuquajturit “krahasimi në çifte”, për sa kohë zgjedhja midis opsioneve bëhet gjithnjë e më e vështirë. Një udhëzim mbi metodat e ndryshme të mundshme është dhënë në pikën A në fund të këtij kapitulli.

Cilado metodë që përdoret, është e rekomandueshme që zgjedhjet të bëhen nga një grup shumëdisiplinar në mënyrë që të jenë të përfaqësuar të gjitha pjesët e ekipit të projektit - zhvilluesit, hartuesit, inxhinierët, ekonomistët, operatorët, dhe hartues të VNM-së. Për disa lloje vendimesh mund gjithashtu të jetë e përshtatshme ose e dobishme përfshirja e partnerëve të jashtëm të tillë si autoriteti kompetent, hartuesit e akteve mjedisore apo komuniteti lokal. Nëpërmjet përfshirjes së tij në konsultimet, ekipi i VNM-së mund të luajë një rol të rëndësishëm për të ndihmuar zhvilluesin të mendojë rreth çështjes se cilët duhet të përfshihen duke vepruar si një ndërmjetës për procesin “e operimit me opsione”.

Hapi 5. Përmirësimi/përpunimi i opsioneve të zgjedhur

Faza finale kyçe në procesin e përzgjedhjes së opsioneve duhet të jetë gjithmonë rishqyrtimi i opsioneve të përzgjedhur për të parë nëse mund të përmirësohet më tej para se të bartet në fazën e ardhshme të zhvillimit apo në VNM e thelluar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ekziston një numër shumë i madh i opsioneve në dispozicion dhe vlerësimi ka marrë në konsideratë vetëm një grup përfaqësues në vend të gjithë gamës. Në të tilla raste është e rëndësishme të marrim në konsideratë nëse opsioni i preferuar mund të përmirësohet duke përfshirë elemente pozitive që janë neglizhuar më parë.

Kur një vlerësim është përdorur për të hartuar një listë të shkurtër të opsioneve në vend të një opsioni të preferuar, rishikimi është gjithashtu një fazë e rëndësishme para se të ndërmarë vlerësim më të detajuar të listës së shkurtër, siç ilustrohet në hapin 1.

Konsultimi me palët e interesuara

Një aspekt i rëndësishëm i çdo hapi në proces duhet gjithashtu të jetë konsiderimi i pikëpamjeve të palëve të interesuara. Nëse procesi i operimit me opsione zhvillohet në mënyrë private, brenda një organizate të projektit (të themi në fazat e para të planifikimit të një zhvillimi komercial) mund të jetë e papërshtatshme për t'u konsultuar me palët e jashtme, por është gjithmonë me vlerë të merret në konsideratë se cilat ka të ngjarë të jenë shqetësimet e tyre dhe marrja parasysh e tyre në vlerësimin paraprak, pasi kjo do ta bëjë më të lehtë për arritjen e marrëveshjes për opsionin e zgjedhur, kur është bërë një kërkesë për leje zhvillimi.

Në shumë projekte është me vend konsultimi me autoritetin kompetent, autoritetin mjedisor ose edhe atë publik, si në fillim për të ndihmuar në përcaktimin e kriterëve të opsioneve dhe vlerësimeve të mundshme, ashtu edhe më vonë për të vlerësuar opsionet dhe zgjedhjen ndërmjet tyre. Shkalla e shtrirjes së konsultimeve të nevojshme dhe koha varet nga konteksti i projektit dhe tipat e alternativave të vlerësuara. Nëse palët e konsultuara sugjerojnë opsione të reja ose ndryshimin e tyre, këto ndofta kërkojnë të vlerësohen dhe krahasohen me opsionet e tjera (duke u kthyer në hapat 3 dhe 4).

A. METODAT PËR KRAHASIMIN DHE ZGJEDHJEN NDËRMJET ALTERNATIVAVE

Mund të përdoret një numër i ndryshëm i qasjeve edhe për të filtruar informacionin në lidhje me mënyrën se si alternativat performojnë kundrejt kriterit të vlerësimit me qëllim që të zgjidhen opsioni ose opsionet e preferuara. Këto janë paraqitur më poshtë:

1. RENDITJA
  2. KLASIFIKIMI
  3. VLERËSIM ME PIKË DHE PONDERIMI
  4. VLERËSIMI MONETAR
  5. KRAHASIMI ÇIFTEVE
- A1. RENDITJA

Renditja thjesht përfshin renditjen e opsioneve nga më i miri te më i keqi (d.m.th. 1, 2, 3 etj.) për secilin kriter duke përdorur informacione nga tabelat e vlerësimit. Rezultatet mund të paraqiten siç ilustrohet në tabelë më poshtë; hijëzimi mund të përdoret për të ndihmuar me interpretim.

Në raste të thjeshta kjo mund të jetë e mjaftueshme për të identifikuar opsionin më të



mirë, nëse për shembull, nëse i njëjti opsion paraqitet si i pari ndër opsionet e shqyrtuara.

Në shembullin e mësipërm, A është renditur si më i miri (i pari) në të gjitha, përveç dy kritereve mbi të cilat vjen barabartë me të parën dhe të dytën. Për këtë arsye, ndoshta është e sigurt për të konkluduar se A është opsioni më i mirë. Megjithatë, është e rëndësishme që të jemi të kujdesshëm kur të përdorim renditjen, pasi ajo nuk i tregon asgjë vendimmarrësit rreth shkallës së diferencës midis opsioneve. Nëse, për shembull, A ishte shumë më keq se B në kriterin 5 dhe vetëm pak më mirë se B në të gjitha të tjerat dhe se 5 është shumë e rëndësishme, kjo mund të jetë e mjaftueshme për të bërë opsionin B të preferuar. Kjo mund të kontrollohet duke iu referuar përsëri informacionit të detajuar në tabelat e vlerësimit. Prandaj renditja rekomandohet vetëm si një kontroll i parë dhe i shpejtë për të parë nëse ekziston një kryesues i qartë.

#### A2. KLASIFIKIMI

Klasifikimi është një informacion shtesë që kemi në dispozicion, i cili na tregon nëse opsionet janë të klasifikuar apo renditur për performancën e tyre kundrejt çdo kriteri. Ndryshe nga renditjet, klasifikimi thotë diçka në lidhje me performancën e tanishme dhe shkallën e diferencës midis opsioneve. Shumë sisteme të ndryshme të

Shembull: Tabela e klasifikimit të opsioneve

|  | Kriteri    | Opsionet |    |     |    |   |  |
|--|------------|----------|----|-----|----|---|--|
|  | Vlerësimit | I        | II | III | IV | V |  |
|  | 1.         | A        | C  | C   | D  | E |  |
|  | 2.         | C        | D  | D   | A  | E |  |
|  | 3.         | B        | B  | B   | A  | E |  |
|  | 4.         | E        | D  | C   | A  | B |  |
|  | 5.         | A        | E  | B   | B  | D |  |
|  | 6.         | B        | A  | E   | C  | C |  |
|  | 7.         | C        | D  | C   | A  | E |  |
|  | 8.         | B        | D  | A   | B  | E |  |
|  | 9.         | A        | E  | B   | B  | B |  |
|  | 10.        | A        | B  | D   | A  | D |  |

Sistemi “hijezimit” ndihmon lexuesin për të parë shpejt nëse opsionet janë në përgjithësi më të mira ose më të këqija se të tjerët për secilin kriter. Kjo mund të jetë e dobishme për përcaktimin e dukshëm të “opsionit kryesor” dhe anasjelltas.

Në këtë shembull opsionet II, III dhe V janë vlerësuar më pak të favorshme në shumicën e

klasifikimit mund të përdoren, duke përdorur ngjyrat (p.sh., e kuqe, portokalli, jeshile), simbolet (p.sh., + + +/+ +/+0/-/--/---) ose shkronja (p.sh., A - E). Notat mundet gjithashtu të përdoren në mënyra të ndryshme, për shembull, alternativa më e mirë mund të jetë vlerësohet me A, më e keqja E, dhe të tjerët ndërmjetëm sipas performancës së tyre relative, ose ato mund të përdoren për të përfaqësuar një shkallë të vërtetë, themi se A = shkëlqyer dhe E = shumë e varfër. E rëndësishme të mos përzihen këto dy qasje të ndryshme në të njëjtin vlerësim si një opsion që merr një notë A për të qenë më i miri në një kriter dhe ende mund të jetë vetëm një veprues shumë i varfër në krahasim me atë që merr një notë B si i mirë në një kriter tjetër. Në të dyja rastet është gjithashtu e rëndësishme të kujtojmë se një notë e lartë për një kriter nuk do të thotë të njëjtën gjë në aspektin e meritave relative si nota e lartë për një kriter tjetër.

Një shembull i mirë A = më e mira/E = më e keqja është ilustruar në tabelën A2. Mund të shihet se jo të gjitha notat janë përdorur për secilin kriter dhe më shumë se një opsion mund të vlerësohet me të njëjtat nota.

kritereve duke sugjeruar se ndoshta favoritët janë I dhe IV, por siç u tha më lart është e rëndësishme që të kontrollohet përsëri në tabelën e vlerësimit për të parë pse II dhe III morën vlerësim A dhe nëse këto kritere janë të rëndësishme për vendimin.

Qasja klasifikimit alternativ (A = i shkëlqyer/E = shumë dobët) mund të jetë më e dobishme, por



shpesh është e vështirë për ta aplikuar në disa kriterë, ku meritat e opsioneve mund të gjykojnë vetëm në terma relativë, për shembull në kosto ose emetimet e CO<sub>2</sub>.

### A3. VLERËSIM ME PIKË DHE PONDERIMI

Një zhvillim i mëtejshëm i klasifikimit është që të përdoren rezultatet numerike për të përfaqësuar performancën. Kjo lloj qasjeje mund të jetë e dobishme, pasi ka një numër më të madh të alternativave dhe aty ku renditjet dhe klasifikimet të ndryshojnë shumë midis opsioneve dhe asnjë model i qartë nuk mund të shihet. Rezultatet mund të përdoren si nota, për të përfaqësuar performancën relative midis opsioneve (0 = më i keq, 10 = më i miri), ose për të përfaqësuar një shkallë reale (p.sh., 1 pikë = 10 tonë CO<sub>2</sub>). Avantazhi i pikëzimit është se ato mund të shtohen së bashku për të dhënë një rezultat të përgjithshëm për secilin opsion, qoftë drejtpërdrejt, ose pas

#### Shembulli: Vlerësimi me pikë dhe ponderimi

| Kriteri                    | Ponderimi | Opsioni      |      |              |      |              |      |
|----------------------------|-----------|--------------|------|--------------|------|--------------|------|
|                            | (P)       | (P)          |      |              |      |              |      |
|                            |           | A            |      | B            |      | C            |      |
|                            |           | S            | x    | S            | x    | S            | x    |
|                            |           | Rezultat (S) | Ë    | Rezultat (S) | P    | Rezultat (S) | P    |
| 1                          | 0.1       | 4            | 0.4  | 6            | 0.6  | 10           | 1.0  |
| 2                          | 0.5       | 8            | 4.0  | 3            | 1.5  | 2            | 1.0  |
| 3                          | 0.4       | 10           | 4.0  | 5            | 2.0  | 5            | 2.0  |
| 4                          | 0.8       | 5            | 4.0  | 7            | 5.6  | 8            | 6.4  |
| 5                          | 1         | 1            | 1.0  | 4            | 4.0  | 5            | 5.0  |
| Vlera e ponderimeve totale |           |              |      |              |      |              |      |
|                            |           |              | 13.4 |              | 13.7 |              | 15.4 |

Rezultati; P – Ponderimi

Kjo tregon se opsioni C ka rezultatin më të lartë dhe për këtë arsye është më i preferuari.

Këto qasje nganjëherë referohen si kompensuese të teknikave ASHK, qëkurse rezultatet e ulëta në një kriter mund të kompensohet nga rezultate të larta në një tjetri.

Vlerësimi me pikë dhe ponderimi ka avantazhin sipërfaqësor në thjeshtësinë e aparencës dhe në prodhimin e një përgjigjeje të qartë, por në realitet Faqe| 13032

vlerësimit për të përfaqësuar rëndësinë e secilit kriter për vendimin. Megjithatë, ky është edhe një dizavantazh në atë që mund të sugjerojë një përgjigje të lehtë, e cila mund të të çojë në një përfundim të gabuar.

Në shumë shembuj, shkallët që shtrihen nga 0 në 10 ose 100 përdoren për secilin kriter, ku 0 paraqet një opsion real apo hipotetik me pak të preferuar, dhe 10 ose 100 lidhet me opsionin real apo hipotetik më të preferuar. Çdo opsioni i është caktuar një rezultat numerik për forcën e shkallës së preferencës për secilin kriter. Ponderimet numerike i janë caktuar pastaj secilit kriter sipas rëndësisë relative të një zhvendosjeje ndërmjet shkallës së sipërme dhe të poshtme për secilin. Rezultatet janë shumëzuar me ponderimet për të dhënë rezultate krahasuese nëpër të gjitha kriteret dhe pastaj mbledhen së bashku për të dhënë një total për secilin opsion, me opsionin e dhënies së rezultatit më të lartë atij që ka qenë më i miri.

përdorimi i duhur i tij përfshin disa konsiderata shumë të ndërlikuara teorike në lidhje me llojin e shkallës së pikëve përdorur dhe mënyrën se nga rrjedhin ponderimet. Ekziston një literaturë e konsiderueshme në ponderimin dhe derivimin e ponderimeve dhe metodat të fuqishme kanë tendencë të përfshijnë shumë kërkime dhe analiza komplekse, të kushtueshme, shpërdoruese kohe. Në praktikë, megjithatë, vlerësimi me pikë dhe ponderimi janë të vendosura shpesh nga grupi i



vendimarrjes. Prandaj vlerësimi me pikë dhe ponderimi duhet të përdoren gjithmonë me kujdes dhe, si të gjitha këto metoda, grupi vendimmarrës duhet t'i referohet përsëri informacionit të vërtetë në lidhje me performancën e opsioneve për të kontrolluar se sa e saktë është përgjigja.

#### A4 VLERËSIMI MONETAR

Një formë e veçantë e “vlerësimit me pikë dhe ponderimit” është përdorimi i vlerësimit monetar për të përshkruar performancën e alternativave. Në këtë qasje, - ndonjëherë, referuar si analiza e kosto-përfitimit - rezultatet për të gjitha kriteret konvertohen në njësi monetare (p.sh. \$), kështu që mund të mbledhen së bashku për të dhënë një vlerë totale ekonomike për çdo alternativë. Ka metoda të ndryshëm për nxjerrjen e vlerave monetare për kriteret e ndryshëm të vlerësimit dhe me metoda të thjeshta të vlerësimit me pikë dhe ponderimit, këto përfshijnë disa çështje metodologjike të sofistikuar dhe duhen përdorur me kujdes.

Një pikë e veçantë që duhet bërë kujdes është fakti se vlerat monetare mund të nxirren relativisht lehtësisht për disa kriteret, por jo për disa të tjerë. Në raste të tilla është e rëndësishme të mos harrojmë kriteret e “jomonetizuara” në marrjen e vendimit.

#### A5 KRAHASIMI NË ÇIFTE

Një dizavantazh i konsiderueshëm i metodave “vlerësimi me pikë dhe ponderimi”, përfshirë metodat e vlerësimit monetar, është se mund të jetë e vështirë për të shpjeguar dhe justifikuar vlerësimin me pikë dhe ponderimin ose vlerat, prandaj konkluzionet e arritura prej tyre, palët e interesuara të jashtme, sidomos kur metoda

rigoroze dhe teorike të nevojitura për derivimin e tyre nuk janë përdorur.

Një qasje alternative që lejon vendimmarrësit për të shpjeguar arsyetimin më lehtë është “krahasimi në çifte” d.m.th. duke krahasuar opsionet në çifte (dy në një kohë). Duke përdorur informacionin në tabelat e vlerësimit, opsionet krahasohen dy nga dy në të njëjtën kohë derisa çdo opsion që është krahasuar mjaftueshëm me të gjithë të tjerët për hartimin e një renditjeje të përgjithshme.

Procesi zakonisht përfshin dy faza kryesore. Së pari, mund të jetë e mundur që të anashkalohen disa opsione për shkak se performojnë më keq se të paktën një opsion tjetër në të gjitha kriteret e vlerësimit. Kjo është ilustruar në tabelën A4, ku shtatë opsione nga B të H janë krahasuar me opsionin A. Për gjashtë nga shtatë alternativa ndaj opsionit A ekziston një përzierje e disa preferencave për A dhe disa për opsione të tjera, por për opsionin F, A-ja është si gjithmonë më e keqe ose e barabartë me F. Duke pasur parasysh zgjedhjen midis A dhe F, F prandaj do të jetë gjithmonë më i preferuar se A dhe A mund të refuzohet.

Faza tjetër përfshin përdorimin e tabelave të vlerësimit për të vendosur preferencat midis opsioneve të mbetura duke i shikuar ato në çifte, deri sa një renditje të shfaqet për të gjitha opsionet. Një shembull është ilustruar në tabelën A5. B krahasohet me C, pastaj me D, pastaj me E, e etj., pastaj C me D, E, F, dhe kështu me radhë derisa krahasimet të jenë të mjaftueshme për t'u shfaqur një renditje, për shembull, se  $D > B > G > C$  E  $\Rightarrow H = F$ .



Tabela A4

| Kriteri                                                | Opsioni B                                                                                                                                                                                                                                     | Opsioni C                                                                                                                         | Preference                |
|--------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------|
| Kostot                                                 | \$100m +/- 5%                                                                                                                                                                                                                                 | <input type="checkbox"/> \$90m +/- 10%                                                                                            | C – preferencë e Moderuar |
| Punësimi                                               | Siguron 200 vënde pune në një zonë me papunësi të lartë me potencial të lartë në zhvillimin e aftësive                                                                                                                                        | <input type="checkbox"/> Siguron 200 vënde pune në një zonë me papunësi të lartë                                                  | B – preferencë e Fortë    |
| Ndikimi në njërëz                                      | Humbja e 15 shtëpive. 100 shtëpi mundësisht të ndikuara nga impakti i zhurmave të moderuara. Diversiteti i rrugëve të këmbësorëve për në qytet.                                                                                               | <input type="checkbox"/> Humbja e 12 shtëpive. 10 shtëpi mundësisht të ndikuara nga ndikimi i zhurmave të larta                   | C – preferencë e Moderuar |
| Ndikimi në mjedisin detar                              | Nuk ka ndikim                                                                                                                                                                                                                                 | <input type="checkbox"/> Rrezik i madh nga humbja e popullatës lokale të zogjve detare të rrezikuar (specie Evropiane e mbrojtur) | B – preferencë e Fortë    |
| Ndikimi në interesat historike dhe kulturore Etj. Etj. | Kërkon prishjen e vëndeve me rëndësi historike - Disa shëmbuj të tjerë lokale                                                                                                                                                                 | <input type="checkbox"/> Nuk ka ndikim                                                                                            | C – preference e Moderuar |
| Preferenca e përgjithshme                              | Në bilanc, kërcënimi ndaj popullsisë së zogjve detarë dhe për Përfitimin potencialisht të ulet të punësimit lokal në Opsionin C<br>Është konsideruar të vlerësohet ndikimi i madh në banorët Lokalë dhe ndikimi historik lokal në Opsionin B. |                                                                                                                                   | Preferohet<br>Opsioni B   |

## SHTOJCA 2

### VLERËSIMI EKONOMIK I KOSTOVE DHE PËRFITIMEVE NË VNM MESAZHET KRYESORE

- Faza parashikuese e një VNM-je përfshin një përshkrim objektiv se si mund të jenë ndikimet e një projekti të marrë në konsideratë. Por para përdorimit të informacionit gjatë vendimmarrjes, është e rëndësishme të kuptohet se sa i rëndësishëm është ndikimi i tij. Faza e ardhshme ka të bëjë me vlerësimin e rëndësisë së ndikimit.

- Një mënyrë e vlerësimit të rëndësisë është kthimi i ndikimeve në vlera monetare, të cilat shpjegojnë se si shoqëria dëshiron të përfitojë ose të shmange efektet negative të projektit.

- Përcaktimi i vlerave monetare të ndikimeve pozitive (përfitimeve) dhe të atyre negative (kostove/shpenzimeve) me qëllim përcaktimin e vlerave ekonomike bëhet vetëm nëse evidentohet një ndikim/ndryshim pozitiv ose negativ në mirëqenien e njerëzve.

- Nxjerrja e vlerës ekonomike të një burimi natyror përfshin vëzhgimin direkt, indirekt dhe opsionit të vlerave të përdorshme, si dhe të ekzistencës së vlerave të pa përdorshme.

- “Mallrat dhe shërbimet”, të cilat rrjedhin nga burimet natyrore shpeshherë vuajnë nga “falimentimi i tregut” nëse nuk paraqiten kostot e plota sociale dhe përfitimet nga burimet mjedisore. Prandaj është i rëndësishëm përdorimi i atyre mekanizmave të cilat bëjnë të mundur përcaktimin



e këtyre vlerave në mënyrë indirekte/të tërthortë. Këto mund të shihen në tregjet reale botërore (metoda e preferencës së pranuar) ose ato hipotetike (metoda e preferencës së deklaruar).

- Përdorimi i këtyre metodave në mënyrën e duhur mund të kërkojë kohë dhe kosto të konsiderueshme, gjë e cila kërkon një hartim dhe realizim të kujdesshëm të studimeve të nevojshme. Zakonisht kjo nuk është praktike për një projekt të vetëm. Transferimi i përfitimeve përdoret shpesh.

- Nëse përfitimet dhe kostot janë parashikuar të ndodhin në një moment të caktuar në të ardhmen, zbritjet mund të përdoret për të parë ndikimet e tyre në çmimet e sotme.

#### HYRJE

Kjo shtojcë jep udhëzime se si mund të kontribuojnë analizat ekonomike në vlerësimin e ndikimeve negative dhe pozitive të një projekti në mjedis, domethënë kostot dhe përfitimet e tij mjedisore. Analizat ekonomike mund të përdoren ose për të ndihmuar në vlerësimin e opsioneve ose në vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve.

Analiza ekonomike përdoret kryesisht, aty ku është e mundur, për të shprehur kostot dhe përfitimet mjedisore të një projekti në terma monetarë në mënyrë që të krahasohen me kostot dhe përfitimet jomjedisore. Një zonë kyçe, ku kjo teknikë është përdorur shpesh herë, është në planifikimin e transportit. Metodot janë zhvilluar për të shprehur ndikimin e projekteve të rrugëve dhe hekurudhave në cilësinë e ajrit, zhurmave, përdorimin e tokës, ekologji etj. në terma monetarë, në mënyrë që të krahasohet në mënyrë direkte me kostot operacionale dhe kapitale, si dhe me kursimet në kostot e udhëtimit, vlerën e kohës së kursyer, si dhe vlerën e aksidenteve të shmangura, gjatë kohëzgjatjes së projektit, në mënyrë që të jepet një vlerësim i përgjithshëm ekonomik i projektit.

Ekonomia është gjithashtu një element i rëndësishëm në shqyrtimin e opsioneve për zbutjen siç sqarohet në shtojcën 3, ku vlerësimi i kostove të shmangies se ndikimeve negative mund të kontribuojë në vendimet aty ku është e arsyeshme dhe e praktikueshme nga zhvilluesi. Vlerësimi ekonomik mund të ndihmojë edhe atëherë kur merren vendime në lidhje me veprimet kompensuese që duhen ndërmarrë për zbutjen e ndikimeve mjedisore (për shembull, për të llogaritur vlerën, llojin e habitateve të humbura, si

dhe zgjerimin e habitatit të ri që duhet të krijohet si zëvendësues).

Është e rëndësishme të theksojmë se vlerësimi ekonomik i ndikimit mjedisor nuk është i detyrueshëm nga legjislacioni në fuqi për VNM-së, gjithsesi aty ku është e mundur, vlerësimi në vlerë monetare mund të japë një informacion suplementar për vendimmarrësit. Megjithatë duhet të mirëkuptohet fakti që përlogaritja e mirë e vlerave monetare është një proces harxhimi kohe dhe e kushtueshme. Gjithashtu, është një zonë teorikisht komplekse, në të cilën mund të ndodhë që lehtësisht të përdoren në mënyrë të gabuar metodat dhe rezultatet. Prandaj duhet bërë një kujdes i konsiderueshëm në adoptimin e tij në VNM.

#### SFONDI I VLERËSIMIT MONETAR

##### Mirëqenia ekonomike

Përcaktimi i vlerave monetare të ndikimeve pozitive (përfitimet) dhe ndikimeve negative (kostot) të projektit për të përcaktuar vlerat ekonomike, bëhet vetëm nëse ekziston ndonjë ndryshim pozitiv ose negativ në mirëqenien njerëzore (e njohur edhe si mirëqenie ose dobi), pavarësisht kush përfiton ose humb. Pra thuhet që vlerat ekonomike janë antropocentrike. Vendosja e një vlere monetare mbi ndikimet e një projekti shërben për të informuar procesin e marrjes së vendimit duke e ndihmuar me një udhëzues mbi preferencat shoqërore. Këto preferenca janë shprehur në terma shoqërorë, si “Gatishmëri për të paguar” për të përfituar ose për të shmangur ndonjë efekt negativ dhe “gatishmëri për të pranuar kompensimin”. “Gatishmëri për të paguar” mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme të përshkruara në shtojcën 3.

Së pari, gjithsesi, është e rëndësishme të kuptohet pse është e rëndësishme “Gatishmëria për të paguar” dhe për të shpjeguar disa nga konceptet ekonomike që shpjegojnë preferencat shoqërore. Preferencat e individëve kundrejt ndryshimeve në mirëqenie tregohen përditë nëpërmjet tregut. Vendimet që individët marrin për të blerë (ose për të mos blerë) mallra apo shërbime të caktuara na tregojnë se perceptimi i përfitimit të individit që bën një blerje të një malli ose shërbimi, është më i madh sesa përfitimi i të njëjtit individ, duke pasur mundësinë e një blerjeje të një malli alternativ. Tregu ka dy karakteristika të



rëndësishme për vlerësimin e ndikimeve ekonomike.

1. Sa më e madhe të jetë preferenca për diçka, aq më e madhe është “Gatishmëria për të paguar” (GPP). Duke shprehur (GPP) e tyre, individët, bazuar në vendimet kundrejt blerjeve pasqyrojnë intensitetin e preferencave të tyre.

2. “Gatishmëria për të paguar” (GPP) është e kufizuar nga të ardhurat. Nëse një individ tregon një GPP të lartë për një blerje në treg, fondet e akorduara për këtë blerje domosdoshmërisht parandalojnë kryerjen e blerjeve të tjera.

Falimentimi i tregut

Shumica e mallrave dhe shërbimeve që rrjedhin nga një burim natyror, të tilla si ajri i pastër apo ekosistemet e vlerësuara, nuk mund të tregtohen. Ndërsa analiza e “Vlerës së përgjithshme ekonomike” (VPE) e biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme, në vitet e fundit nuk ka ndonjë çmim ose vlerë komerciale të konsiderueshme, dhe tregu nuk reflekton koston dhe/apo përfitimin e tyre të plotë social. Me fjalë të tjera është një “falimentim tregu”. Prandaj, vlera e ndikimeve negative ose të dobishme mbi këto burime nuk mund të merret parasysh në vendim marrje. Shembuj mund të jenë të mirat “publike” të siguruara nga rritja e reduktimit të gazit karbonik nëpërmjet pyllëzimit ose e “keqe” publike si rezultat i përkeqësimit të cilësisë së ajrit. Një e mirë (ose e keqe) është publike nëse përfitimi që një person siguron nga shërbimi nuk bie në kundërshtim me konsumin e një personi tjetër. Për shembull, një individ që përfiton mirëqenie (një të mirë) e cila vjen nga pyjet tropikale të Amazonës ekzistuese, dhe do të ruhet për gjeneratat e ardhshme, nuk përjashton të tjerët të përfitojnë prej saj dhe ekzistenca e saj.

Përdorimi i mjeteve ekonomike ndihmon në kuptimin e preferencave të shoqërisë për burimet natyrore, si dhe vlerat pozitive dhe negative të ndikimeve të ndryshme që rrjedhin nga projekti.

Burimet e mirëqenies ekonomike

Deri tani kemi shpjeguar se duke kuptuar kostot dhe përfitimet ekonomike të ndikimeve të një projekti na ndihmon në vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve që sjell projekti përmes ndryshimeve në mirëqenien shoqërore. Para përshkrimit të mjeteve që mund të përdoren për të nxjerrë vlerën ekonomike, është mirë të analizohen komponentët

e vlerës ekonomike. Dy kategoritë kryesore të mirëqenies ekonomike janë quajtur vlera “përdorimi” dhe “mospërdorimi”.

Të ashtuquajturat vlera “përdorimi” lidhen me përdorimin aktual të burimeve natyrore të marra në konsideratë. Për shembull, vlera e përdorimit lind direkt nga kënaqësia që të sjell një shëtitje në një park kombëtar, ose indirekt nga shërbimet e ekosistemit që ofrohen nga një burim mjedisor, të tilla si sekuestrimi i karbonit në pyje dhe mbrojtja nga përmbytjet në zonat kënetore.

Vlerat e përdorimit lindin edhe nga ndërgjegjësimi që një burim është në dispozicion për t’u përdorur edhe pse ajo nuk është përdorur ose përdoret në të vërtetë, këto janë të quajtura vlera opsionale. Vlerat opsionale janë të rëndësishme pasi individët mund të jenë të gatshëm të paguajnë për të ruajtur burimet mjedisore ekzistuese, duke ruajtur mundësinë për ta përdorur atë në momente të caktuara në të ardhmen, edhe nëse nuk kanë një përdorim aktual ose të planifikuar momentalisht.

Vlerat e “mospërdorimit” mund të ndahen në dy kategori:

- Vlerat të ekzistencës. Këto i referohen mirëqenies që rrjedh nga njohuritë që burimet mjedisore ekzistojnë për brezat e sotëm, edhe pse nuk ka tendencë që ato të përdoren ndonjëherë.

- Vlerat e trashëguara lidhen me dobitë që rrjedhin nga shoqëria me njohuritë që burimet mjedisore në fjalë do të jenë në dispozicion për gjeneratat e ardhshme.

#### MJETET PËR VLERËSIMIN MONETAR

Hyrje

Qasjet ekonomike për vlerësimin e ndikimeve të projektit ndahen në dy kategori:

- Përqasjet e bazuara në treg, ku vlera e një burimi natyror “zbulohet” nga studimi i tregut për një të mirë ose shërbim zëvendësues - “preferencë e pranuar”.

- Përqasje jo sipas tregut, kur individëve i paraqitet një treg hipotetik për një burim aktual mjedisor, dhe ata pyeten se çfarë ata do të jenë të gatshëm të paguajnë ose pranojnë nga ndryshimi në rritje i një burimi natyror – “preferencë e deklaruar”.

Teknika e preferencës së pranuar

Në disa situata, të dhënat e tregut janë në dispozicion të mallrave dhe shërbimeve që janë në një farë mënyre të lidhura me burimet mjedisore që



po vlerësohen. Bazuar në këto, mund të nxirren vlerat e tregut për të mirat dhe shërbimet e burimeve natyrore. Ekziston një tërësi e teknikave preferenciale të njohura.

- Teknika më shpesh e përdorur e “teknikës së preferencës së njohur” është metoda e “kostos së udhëtimit”. Kjo metodë përdoret për të vlerësuar burimet natyrore të tilla si parqet kombëtare, ku përfitimi rrjedh nga vizitat në këto pasuri. Duke përdorur këtë teknikë, kurba e kërkesës për një burim natyror mund të nxirret nga një marrëdhënie e llogaritur midis numrit të vizitave dhe koston së udhëtimit në këto vende. Duke kuptuar se sa shumë njerëz janë të gatshëm të paguajnë për të shkuar te ky burim mjedisor, është e mundur që të kuptohet vlera që ata përfitojnë nga burimi mjedisor në fjalë.

- Vlera e një burimi mjedisor gjithashtu mund të nxirret edhe nga shuma e parave që njerëzit janë të gatshëm të shpenzojnë për të shmangur ose zbutur pasojat e humbjes së tij. Për shembull, nëse një specie është nën kërcënimin e zhdukjes, kostoja e një programi të kryqëzimit mund të përdoret për të vlerësuar përfitimin e siguruar nga vazhdimi i mbijetesës së kësaj specie. Kjo qasje është e njohur si sjellje parandaluese ose mënjanuese.

- Nga ana tjetër edhe kostoja e zëvendësimit të biodiversitetit të humbur me një zëvendësues mund të vlerësohet. Sjellja mënjanuese dhe teknikat e preferencës zëvendësuese të vlerës së njohur nuk mund të masin në mënyrë rigoroz vlerën përfituese të burimit natyror, sepse ato mund të masin vetëm kostot e lidhura me sigurimin e zëvendësuesit ose shmangien e humbjeve.

Teknikat e tjera të pranuar preferenciale vëzhgojnë veprimet e njerëzve në tregje që janë të lidhura në mënyrë specifike me ndryshimin e mjedisit. Teknikat hedonike të vendosjes së çmimit përdorin marrëdhëniet ndërmjet çmimit të një malli apo shërbimi të tregtuar dhe faktorit të një burimi natyror që të llogarisin vlerën e ndryshimit në mjedis. Për shembull, çmimi i tokës për aktivitete bujqësore do të ndikohet nga cilësia e tokës. Në teori, nëse nuk ka të dhëna të mjaftueshme, marrëdhënia midis çmimit dhe cilësisë së tokës

mund të veçohet nga çmimi i tokës dhe nga vlera e rrjedhur. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e lartë të faktorëve që ndikojnë në çmimin përfundimtar të një produkti kjo ndarje është shumë e vështirë në praktikë.

Teknika e preferencës së deklaruar

Teknikat preferenciale të deklaruara janë përshtatur për të adresuar kufizimet në rangun e vlerave të burimeve natyrore që mund të rrjedhin nga preferencat e njohura. Avantazhi kryesor i teknikës preferenciale të deklaruar është se lejon vlerat e “mospërdorimit”, si dhe të “përdorimit” që të njihen; preferencat e njohura mund të përdoren vetëm për ato burime të cilat janë ose mund të përdoren nga shoqëria. Teknikat preferenciale të deklaruara mund të zbulojnë vlerën e një burimi natyror edhe në qoftë se personi përgjegjës nuk e përdor aktualisht atë apo ka ndërmend ta përdore në të ardhmen. Vlerat e “mospërdorimit” janë veçanërisht të rëndësishme kur te burimi natyror në fjalë ka disa zëvendësues.

Teknika preferenciale e deklaruar dominuese është metoda e kontingjentit të vlerësimit (MKV). Ekzistojnë nënteknika të ndryshme, por, në thelb, metoda e kontingjentit të vlerësimit (MKV) përfshin pyetjen e një grupi njerëzish të përzgjedhur si kampion se çfarë janë të gatshëm të paguajnë për të siguruar përmirësimin e ndonjë aspekti të veçantë në mjedis. Në rastin e kundërt, ky grup njerëzish mund të pyetet se çfarë pagese/shume janë të gatshëm të pranojnë në mënyrë që të lejojnë një nivel të degradimit të mjedisit. Teknika përfshin ndërtimin e një tregu hipotetik, në të cilën ndryshimi në mjedis i “shitet” individëve apo familjeve.

Një pyetje e thjeshtë e metodës së kontingjentit të vlerësimit mund të jetë e formatit të mëposhtëm: “Sa jeni i/të gatshëm të paguani, që të kemi rritje në formën e ndonjë takse vendore, që të keni mundësi hyrjeje në parkun kombëtar X?”

Gjithsesi, shumë çështje të vështira adresohen për t'u trajtuar në planifikimin dhe projektimin e sondazheve të metodës së kontingjentit të vlerësimit.





Pyetje që duhen marrë parasysh gjatë përgatitjes së një studimit MKV

1. Çfarë ndryshimi, në cilësinë e mjedisit, duhet t'u kërkohej të anketuarve që të vlerësojnë, dhe si iu duhet përshkruar atyre ky ndryshim?
2. Ç'loj formati duhet përdorur në sondazh gjatë intervistës (d.m.th. direkt, me telefon ose me postë)?
3. Çfarë lloj pyetjesh duhet të përdoren për të marrë vlerësimin e të anketuarve rreth ndryshimit të cilësisë së mjedisit?
4. Si u duhet thënë të anketuarve, saktësisht, se do t'iu duhet të paguajnë për ndryshimin në cilësinë e mjedisit?
5. Si mund të besohet se të anketuarit kanë vlerësuar, në të vërtetë, ndryshimin e përshkruar në cilësinë e mjedisit specifikisht dhe jo disa ndryshime të tjera të cilësisë së mjedisit, dhe nëse vlerat e gjetura janë të sakta?

*Burimi: OECD.*

Në vitet e fundit një adaptim i metodës së kontingjentit të vlerësimit ka fituar popullaritet. Modelimi i zgjedhjes i paraqet individit si një seri zgjedhjesh hipotetike, me vlera të paracaktuara. Kështu, dallimi themelor me MKV-në është se modelimi i zgjedhjes dëshmon “Gatishmërinë për të paguar” nga renditjet ose vlerësimet në tërësinë e zgjedhjeve të njohura, ndërsa MKV pyet direkt për “Gatishmërinë për të paguar” nga ana e të intervistuarit.

Një shembull i modelimit të zgjedhjes është ilustruar në tabelën 1, në të cilën një tërësi zgjedhjesh është përdorur për të kuptuar rëndësinë e të pasurit me shumë përfitime nga bujqësia (p.sh., produktivitet më të madh dhe punësim) kundrejt cilësisë së ulët të mjedisit (p.sh., prurje më të vogla lumi, incidencë të ulët të llojeve të shpendëve etj.) në Luginën Macquarie, Australi. Analizat bëjnë të mundur që këmbimet ekonomike, mjedisore dhe sociale të nxirren dhe të llogariten në vlera monetare.

Tabela 1. Shembull i pyetësorit të kënetave të *Macquarie*

|                                      | <b>Opsioni 1: Situata ekzistuese</b> | <b>Opsioni 2: Rritje</b> | <b>Opsion 3: Rritje</b> |
|--------------------------------------|--------------------------------------|--------------------------|-------------------------|
|                                      |                                      | Ujë në Macquarie         | Ujë në Macquarie        |
|                                      |                                      | kënetë                   | kënetë                  |
| Tarifat e ujit<br>(one off increase) | Pa ndryshim                          | \$20 rritje              | \$50 rritje             |
| Që lidhen me vaditjen punësimin      | 4,400 vende pune                     | 4,350 vende pune         | 4,350 vende pune        |
| Zona e ligatinës                     | 1,000 km <sup>2</sup>                | 1,250 km <sup>2</sup>    | 1,650 km <sup>2</sup>   |
| Zonat e shumimit të zogjve të ujit   | Çdo 4 vjet                           | Çdo 3 vjet               | Çdo vit                 |
| Speciet e rrezikuara                 | 12 specie                            | 25 specie                | 15 specie               |
| Specie e mbrojtura prezente          |                                      |                          |                         |

#### Transferimi i përfitimeve

Metoda e transferimit të përfitimeve përfshin “huazimin” e vlerës së “Gatishmërisë për të paguar” të nxjerrë nga një vend dhe aplikuar në një vend tjetër, për shembull huazimi i vlerësimit nga një studim akademik dhe aplikimi i tij në VNM e një projekti. Transferimi mund të jetë me një vlerë

mesatare prej një numri studimesh dhe kjo mund të modifikohet në bazë të nevojave për t'iu përshtatur vendit të ri. Në shumicën e rasteve modifikim i vlerave të “Gatishmërisë për të paguar” të studimeve origjinale, rrit saktësinë e vlerës së transferuar.

Aty ku vlerësimi monetar është përdorur për VNM, është bërë më shpesh duke përdorur



transferimin e përfitimeve, sepse ndodh tepër rrallë që brenda kohës dhe koston së parashikuar të bëhet vlerësimi direkt monetar i ndikimeve mjedisore brenda një projekti të vetëm. Transferimi i përfitimeve ka avantazhin e të qenit me kosto të ulët, pasi shmang nevojën për të ndërmarrë kërkime parësore të detajuara sipas specifikave të vendit ku do të zbatohet projekti përshkruar më lart.

Megjithatë, ka një numër rreziqesh me qasjen e transferimit të përfitimeve, që rrjedhin kryesisht nga dallimet e pashmangshme ndërmjet këndvështrimeve të studimit origjinal dhe përfituesve. Dallimet në terren lindin nga karakteristikat e mëposhtme:

- Karakteristikat sociale-ekonomike të popullsisë përkatëse. Nëse popullsia përfituese ka një nivel më të ulët se të ardhurat e popullsisë së studimit, një transferim jo i rregullt ka të ngjarë të mbivlerësojë “Gatishmërinë për të paguar” të zonës përfituese.

- Karakteristikat fizike, ekologjike dhe/ose estetike nga ana e studimit origjinal kanë të ngjarë të jenë të ndryshme nga ato të përfituesit.

- Detajet e parashikuara të ndryshimit në burimin mjedisor mund të ndryshojnë ndërmjet territoreve në vlerësim. Për shembull, popullsia e studimit origjinal mund jetë kërkuar për të ofruar një “Gatishmëri për të paguar” për ruajtjen e vazhdueshme të parkut kombëtar prej 100,000 hektarë. Territori përfitues mund të jetë më i madh ose më i vogël dhe të ketë mundësi të ndryshme rekreative dhe rëndësie ekologjike. Natyra e efekteve mbi rekreacionin dhe karakteristikat ekologjike gjithashtu mund të jenë të ndryshme.

- Mund të ketë dallime në kushtet e tregut ndërmjet territoreve të studimit dhe atyre përfituese, për shembull, mund të ketë një ndryshim në disponueshmërinë e zëvendësuesve. Duke përdorur shembullin e parkut kombëtar, transferimi i vlerave të “Gatishmërisë për të paguar” mund të rezultojë në një mbivlerësim nëse territori i studimit të ketë më pak burime alternative të mundësive rekreative në krahasim me territorin përfitues.

Kujdesi është gjithashtu i nevojshëm për të siguruar që vlerat origjinale të jenë të dhëna të mira parësore. Është e mundur për vlerat që të transferohen në mënyrë të përsëritur nga një

studim në tjetrin dhe në këtë proces të humbin vlefshmërinë e tyre si burime të dobishme.

#### PROBLEMET ME PËRCAKTIMIN E VLERAVE MONETARE TË NDIKIMEVE MJEDISORE

Vlerat monetare duhen përdorur për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve mjedisore me kujdes dhe vëmendje të madhe. Kritikë e ndryshme mund të jenë kundër monetizimit dhe është e rëndësishme që të tregohet kujdes që metodat të jenë të përshtatura në një mënyrë të tillë që të adresojnë kufizimet sa më shumë të jetë e mundur. Vështirësitë kryesore në përcaktimin e vlerave monetare në mjedis janë si më poshtë:

- Për të dhënë vlerësimet e sakta të vlerës së burimeve mjedisore, ka shumë çështje teknike që adresohen në përdorimin e mjeteve ekonomike të përshkruara më sipër. Në veçanti, ka vështirësi në sigurimin e informacionit të mjaftueshëm për t'u mundësuar pjesëmarrësve të studimit marrjen e vendimeve të informuara, veçanërisht në lidhje me çështje komplekse shkencore siç është biodiversiteti apo ndryshimi klimatik. Të anketuarit gjithashtu mund të shtrembërojnë qëllimisht preferencat e tyre në një përpjekje për të manipuluar rezultatet e procesit të vendimmarrjes në favor të tyre (të ashtuquajturat “vota protestë”). Vlera e “gatishmërisë për të paguar vlerën e njohur” gjithashtu mund të jetë shumë më e madhe se gatishmëria aktuale për të paguar, kryesisht për shkak të natyrës hipotetike të pyetjes dhe faktit se pagesa aktuale nuk është e kërkuar.

- Studimet e vlerësimit ekonomik duhet të jenë projektuar dhe zbatuar me shumë kujdes në mënyrë që të prodhojnë rezultate të mira dhe për këtë arsye ato kanë tendencë të jenë shumë të kushtueshme.

- Në veçanti, kur përdoret metoda e kontingjentit të vlerësimit, marrëdhëniet ndërmjet vendimeve të përdorimit të burimeve dhe ndikimeve në sistemet ekologjike duhet të kuptohen tërësisht dhe t'u shpjegohen të anketuarve në terma të thjeshtë, në mënyrë që ata të mund të marrin vendime të informuara për gatishmërinë e tyre për të paguar.

- Është i diskutueshëm fakti se mjedisi duhet të ruhet në një kohë të pacaktuar dhe se reduktimi i mjedisit në një komoditet që mund të blihet ose të shitet në një farë mënyre zhvlerëson vlerën e tij. Këto argumente po bëhen më pak domethënies



pasi vlera e përdorimit të informacionit ekonomik për të informuar politikat zgjedhëse bëhet më e qartë dhe siguron që përdorimi i vlerave monetare të ndihmojë për të informuar, dhe jo për të diktuar vendimet e tyre. Për shkak se vendimet e politikës informohen kryesisht nga implikimet e tyre financiare, është e dobishme që të shprehen kostot jomonetare dhe përfitimet në kushte të njëjta. Nëse nuk mund të vendoset një vlerë monetare mbi ndikimet mjedisore, ekziston rreziku që ndikimi thjesht të injorohet.

- Krahas kësaj, ekziston edhe rreziku që, në qoftë se disa ndikime janë përkthyer në terma monetarë, dhe disa të tjerë jo, mund të ndodhë që ato që nuk mund të konvertohen në para, të lihen jashtë procesit të vendimit. Prandaj është gjithmonë e rëndësishme të kujtohet se mund të ketë faktorë të tjerë të mundshëm për t'u marrë në konsideratë përveç atyre që të janë lidhur me analizën ekonomike. Pavarësisht këtyre vështirësive, mjetet ekonomike të përshkruara ende mund të jenë të dobishme për të ndihmuar vendimmarrësit të kuptojnë preferencat e shoqërisë për ndryshimet në mjedis dhe për këtë arsye mund të shërbejnë si plotësues të dobishëm për VNM konvencionale. Aty ku është mundësia, qasjet e transferimit të përfitimeve në përgjithësi janë më të praktikueshmet, por edhe këto duhet të aplikohen me kujdes në mënyrë që jenë përdorur vlerat e duhura të transferimit.

Aplikimi i metodave ekonomike mund të jetë veçanërisht i dobishëm kur ndikimet mjedisore kanë të ngjarë të ndodhin me kalimin e kohës ose në ndonjë moment në të ardhmen. Ekonomistët përdorin një mjet të njohur si “zhvlerësim” për të përshkruar dhe krahasuar vlerën e kostove dhe përfitimeve të ardhme me çmimet e sotme. Nëse ndikimet mjedisore janë konvertuar në vlera monetare, “zhvlerësimi” mund të aplikohet për të lejuar krahasimin me llojet e tjera të kostove dhe përfitimeve të cilat ndodhin në kohëra të ndryshme p.sh., shpenzimet kapitale dhe operative, kursimet kohore, minimizimin e aksidenteve. Përzgjedhja e një norme “zhvlerësimi” të përshtatshme është vendimtare dhe paraqet vetë sfidën e saj të vështirë. Në disa vende një normë standarde e skontimit është krijuar nga qeveria për aplikim në vendimmarrjen e sektorit publik, për shembull, në Mbretërinë e Bashkuar (UK) norma aktuale e “interesit” është 3.5 për qind.

Nëse të gjitha kostot dhe përfitimet e projektit mund të konvertohen në para dhe të “zhvlerësuara” në çmimet aktuale, mund të përcaktohet vlera aktuale neto (NVP) e projektit. Në teori, nëse vlera aktuale neto është pozitive, ajo do të jetë në dobi të shoqërisë dhe bën të mundur që projekti të shkojë përpara dhe për këtë arsye të jepet pëlqimi për të. Nëse NVP është negative, pëlqimi duhet të refuzohet. Kur alternativat krahasohen, duhet zgjedhur opsioni me vlerën aktuale neto pozitive më të lartë. Ashtu si me çdo analizë ekonomike, NVP është një panoramë e plotë dhe e rrallë dhe faktorët e tjerë jo të përshtatshëm të monetizimit gjithashtu duhet të merren parasysh. Shumë ndikime mjedisore kanë të ngjarë të jenë në këtë grup dhe prandaj dobia e analizës kosto-përfitim në kontekstin e vendimmarrjes për leje zhvillimi dhe të VNM është e kufizuar.

### SHTOJCA 3

#### TRAJTIMI I MASAVE ZBUTËSE DHE NË VNM, TEKNIKAVE MË TË MIRA NË DISPOZICION

Mesazhet kryesore. Minimizimi i ndikimeve në mjedis është konsideruar çdo veti e projektit të propozuar, që shmang, redukton, kuron ose kompenson për efektin e saj negativ mbi mjedisin apo siguron përfitime mjedisore.

1. Minimizimi përfshin jo vetëm zgjidhje teknologjike, të tilla si kontrollet e ndotjes, por edhe planin e projektit, metodat e punës dhe masat e menaxhimit gjatë të gjitha fazave të zhvillimit.

2. Opsionet për zbutjen duhet të konsiderohen si një “hierarki zbutëse”, për të ndihmuar në identifikimin e atyre masave të cilat duhet të konsiderohen në radhë të parë. Kjo hierarki është e bazuar në parimin se është më mirë të parandalosh gjenerimin e ndikimit në burim sesa të përpiqesh të luftosh efektet e tij pasi ka ndodhur.

3. Minimizimi duhet të konsiderohet në të gjitha fazat e ciklit të projektit, dhe në fazat dytësore brenda secilës prej këtyre fazave.

4. Aplikimi i masave minimizuese duhet të fillojë herët dhe të vazhdojë si një proces që duhet të përsëritet gjatë gjithë zhvillimit të projektit. Ajo nuk duhet të kufizohet në një pikë në vlerësim ose në fund të VNM-së.



5. Raporti i VNM-së duhet të marrë në konsideratë një tërësi masash zbutëse dhe duhet t'i paraqesë ato në mënyrë të qartë në mënyrë të tillë që ata që nuk janë ekspertë, të kenë mundësi t'i kuptojnë ato.

6. Raporti i VNM-së duhet gjithashtu të demonstrojnë angazhimin e zhvilluesit për zbatimin e masave zbutëse, për shembull, nëpërmjet një masave minimizuese apo një plani menaxhimi mjedisor.

7. Nëse projekti nuk është në mënyrë të mjaftueshme i detajuar për të lejuar detajet e masave të minimizimit të finalizohen, raporti i VNM-së mund të përcaktojë angazhime ose për arritjen e standardeve specifike mjedisore ose për paraqitjen e detajeve për miratim nga autoriteti përkatës në një fazë të mëvonshme.

8. Autoriteti kompetent duhet të kujtojë se raporti i VNM-së në vetvete mund të mos jetë një dokument i detyrueshëm, dhe se mund të jetë e nevojshme që të përfshijë masat zbutëse si kusht specifik për lejen e zhvillimit në qoftë se ato do të jenë të zbatueshme.

9. Lista përfundimtare e masave zbutëse për t'u zbatuar është përcaktuar shpesh në vijim të dorëzimit të raportit të VNM-së.

10. Kushtet e lejes së zhvillimit duhet të specifikojnë se çfarë monitorimi duhet të kryhet, nga kush dhe çfarë duhet të bëhet me rezultatet. Rezultatet e monitorimit duhet të përdoren për të informuar procesin e zbatimit.

11. Për projekte të mëdha, zbatimi i sistemit të menaxhimit të mjedisit mund të sigurojë një mbështetje të dobishme për angazhimet zbutëse, duke i dhënë garanci autoritetit kompetent se propozimet zbutëse do të zbatohen.

HYRJE

Qëllimi

Qëllimi kryesor i VNM-së është të identifikojë mënyrat se si projektet mund të ndryshohet, transformohen për të zbutur efektet e tyre në mjedis. Në mënyrë të thjeshtë, zbutja e mjedisit është konsideruar të përfshijë ndonjë veti të një projekti të propozuar, i cili shmang, zvogëlon ose riparon efektin e saj negativ mbi mjedisin apo siguron përfitime mjedisore. Masat zbutëse mund të përfshijnë aspektet fizike të projektit apo mënyrat sipas të cilave ai është ndërtuar apo operon. Ato gjithashtu mund të përfshijnë apo të përjashtojnë veti të projektit, për shembull,

komponentë të projektit që hequr për të reduktuar ndikimin e tij apo karakteristikat shtesë që janë shtuar për të rritur përfitimet mjedisore.

Rëndësia e zbutjes së efekteve në VNM

VNM-ja mendohet si një mënyrë për të ndaluar projekte që kanë ndikime të papranueshme në mjedis, por një pikëpamje shumë më pozitive dhe e dobishme është të mendohet për VNM si një mënyrë për të ndihmuar zhvilluesit dhe vendimmarrësit të projektojnë projekte që të kenë ndikim sa më të vogël të mundshëm në mjedis, në mënyrë që ata të mund të lejohen të shkojnë përpara dhe të sigurojnë përfitime të tjera që zhvillimi krijon për ekonominë dhe shoqërinë. VNM bën këtë duke identifikuar zbutjen e mjedisit gjatë studimeve vlerësuese.

Ekipi i VNM-së ka një rol jetik në këtë proces. Detyra e tyre është të identifikojë kur një projekt mund të ketë ndikime të rëndësishme mbi mjedisin dhe të punojnë me zhvilluesin për të identifikuar mënyrat nëpërmjet të cilave ato mund të reduktohen. Ky duhet të jetë një proces i përsëritur që duhet të fillojë në faza të hershme dhe të vazhdojë gjatë gjithë zhvillimit të projektit.

Zakonisht nuk është e mundur të zbutet çdo ndikim i një projekti, por puna e ekipit të VNM-së është që të punojë me zhvilluesin e projektit për të vendosur se çfarë është e mundur dhe e përballueshme në kontekstin e zhvillimit të propozuar.

Sapo të jetë kryer vlerësimi i ndikimeve mbetëse, raporti i VNM-së duhet të përshkruajë masat që zhvilluesi është përgatitur të adoptojë dhe ndikimet mbetëse të mbetura pas zbutjes. Masat zbutëse duhet të paraqiten si angazhime në mënyrë që autoriteti kompetent të dijë se çfarë mund të marrë parasysh në marrjen e vendimit nëse do të japë pëlqimin. Nëse është e nevojshme, angazhimet mund të përkthehen në kushte të pëlqimit/lejes në mënyrë që ato të mund të zbatohen. Nëse autoriteti kompetent vendos se zbutja e ofruar nga zhvilluesi është e pamjaftueshme, mund të shtohen më tej kërkesa shtesë si kushte të pëlqimit/lejes. Zhvilluesi pastaj do të duhet të vendosë nëse projekti është ende teknikisht dhe komercialisht i realizueshëm para se të shkohet përpara me zbatimin.

Sipas ligjit në fuqi për lejet e mjedisit, kushtet e lejes së mjedisit duhet të përfshijnë vlerat limit të shkarkimeve dhe këto duhet të bazohen në aplikimin e TMD-së. Këto janë përcaktuar si:



*“... stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kuqi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundshme, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi”*

- “Teknikë” është teknologjia dhe mënyra me të cilën instalimi është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe çmontuar;

- “Teknika të disponueshme” janë teknikat e zhvilluara në atë nivel që mundëson përdorimin e tyre, në sektorin përkatës industrial, me rezultate të mira ekonomike e teknike. Vlerësimi i teknikave merr parasysh kostot dhe përparësitë, pavarësisht nga fakti nëse ato teknika përdoren apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë ato janë të arritshme nga përdoruesi.

Teknikat më të mira në dispozicion në kontekstin e VNM-së

Termi “Teknikat më të mira në dispozicion” është zhvilluar specifikisht për lejet e mjedisit, por është gjithashtu i përshtatshëm për VNM nëse projekti kërkon të dyja si VNM dhe leje mjedisi. Ka disa projektpropozime për të cilët aplikohet leja e

mjedisit dhe VNM, në këto raste; masat zbutëse të përshkruara në raportin e VNM-së do të përfshijnë TMD-në për atë sektor.

Për tipat e tjerë të projekteve ku nuk kërkohet leje e mjedisit, TMD-ja nuk është detyrim ligjor, por koncepti është akoma i dobishëm, pasi ai na kujton nëse është e legjitimuar të konsiderohet nëse kostot e zbutjes janë proporcionale me fitimet që zbutja do të sigurojë. Kështu nuk do të jetë e arsyeshme për zhvilluesin të shpenzojë sasi të mëdha parash për zbutjen nëse ndikimi mjedisor që shmanget është shumë i vogël. Në mënyrë të barabartë, nëse një përmirësim i konsiderueshëm mjedisor mund të arrihet me një kosto të vogël, zhvilluesi duhet ta përfshijë atë në propozim, me përjashtim të rastit kur kjo do ta bënte projektin të pamundur për arsye të tjera. Përdorimi i fjalës “teknikë” është gjithashtu i dobishëm në atë që na kujton nëse zbutja përfshin praktikën e ndërtimit, metodat e operimit, sistemet e menaxhimit, trajnimin dhe monitorimin, si dhe zgjidhjet teknologjike të tilla si kontrolli fundor i ndotjes.

Lidhja ndërmjet VNM-së dhe lejes së mjedisit

Ka disa ndërthurje potenciale ndërmjet VNM-së dhe lejet e mjedisit dhe një vështrim i përgjithshëm i këtyre jepet më poshtë:



### Lidhjet ndërmjet VNM-së dhe lejes së mjedisit

Instalimet e reja që mbulohen nga ligji në fuqi për lejet e mjedisit mund gjithashtu të bien nën juridiksionin e ligjit në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis. Ka dy mënyra kryesore në të cilat dy direktivat janë të lidhura.

Së pari, të dyja ligjet e sipërpërmendura kërkojnë grumbullimin dhe analizat e informacionit në lidhje me shkarkimet e ndotësve, ndikimet dhe mbetjet nga projekti i propozuar.

Ligji në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij, fokusohet në sigurimin e informacionit për të ndihmuar vendimet për lejet e zhvillimit dhe përfshin projektin, ndërtimin, operimin dhe mbylljen/përfundimin e mundshëm dhe rehabilitimin (kthimin në gjendjen e mëparshëm). Vlerësimi mbulon të gjitha aspektet e mjedisit, përfshin ndikimet fizike, në përdorimin e tokës, ekologjinë, peizazhin, trashëgiminë kulturore etj., si dhe ndotjen nga mbetjet. Autoriteti kompetent e përdor këtë informacion, për ta vlerësuar atë përkundrejt një game të gjerë faktorësh të tjerë përfshi ndikimet ekonomike dhe sociale për të vendosur nëse një zhvillimi duhet t'i jepet leja.

Lejet e mjedisit lidhen së pari me operimin e instalimeve dhe kanë fokusim më të ngushtë – kryesisht ndotja mjedisore – shkarkimet në ajër, shkarkimet, mbetjet etj. Qëllimi i aplikimit të lejes së mjedisit është t'i sigurojë autoritetit kompetent informacion duke demonstruar që instalimi i propozuar do të operojë për të reduktuar ndotjen duke përdorur TMD. Leja e mjedisit jepet vetëm kur është rasti. Te lejet e mjedisit, ndikimet mjedisore nuk janë të balancuara përkundrejt kostove të tjera dhe përfitimeve në vendim marrje.

Aplikimet për leje zhvillimi dhe leje mjedisi mund të bëhen në të njëjtën kohë ose njëri pas tjetrit. Në shumicën e rasteve aplikimi për leje zhvillimi është i pari dhe formon parimin e lejimit të përdorimit të tokës për projektin. Aplikimi i lejes së mjedisit shpesh ka nevojë për më shumë detaje rreth aspekteve teknike të projektit se sa kërkohej nga VNM, dhe kështu shpesh aplikohet për të ardhmen në zhvillimin e projektit. Nëse projekti është subjekt i të dyjave, VNM dhe leje mjedisi, një pjesë e informacionit të grumbulluar për VNM mund të jetë e dobishme për lejen e mjedisit dhe e kundërta.

Lidhja e dytë ndërmjet dy ligjeve zbulohet kur autoriteti i lejes së zhvillimit dëshiron të zbatojë kushte me qëllim kontrollin e çështjeve që mbulon leja e mjedisit, si shkarkimet në ajër etj. Është e rëndësishme që autoritetet për lejet e zhvillimit të mos kapërcejnë/tejkalojnë përgjegjësitë e që i janë dhënë autoriteteve për lejet e mjedisit, meqenëse kjo mund të gjenerojë konflikte ndërmjet dy lejeve. Autoritetet për lejet e mjedisit duhet të sigurojnë respektimin e standardeve absolute nëpërmjet lejes së mjedisit. Këto janë projektuar për të siguruar nivelin më të mirë të mbrojtjes mjedisore. Nga ky moment është e nevojshme që autoritetet e lejes së zhvillimit të mbështeten te leja e mjedisit për të arritur nivele të pranueshme të mbrojtjes mjedisore më mirë se të vendosin standarde për veten e tyre.

### TIPAT E MASAVE ZBUTËSE

Ka zakonisht shumë mënyra të ndryshme nëpërmjet të cilave ndikimi i projektit mund të zbutet dhe është e rëndësishme që të gjitha këto të konsiderohen në vendimin mbi përjasjen me kosto më efektive. Një pikënisje e dobishme kur konsiderohen opsionet është hierarkia e masave zbutëse.

#### Hierarkia e masave zbutëse

“Hierarkia e zbutjes” është e dobishme në identifikimin e rregullit sipas të cilit duhet të konsiderohen masat. Hierarkia bazohet në parimin se është më mirë të parandalohet gjenerimi i

ndikimit në burim, sesa të përpiqemi t'i përgjigjemi efekteve të tij pasi ndikimi ka ndodhur:

1. Përjasja e preferuar e zbutjes është të hartosh një projekt duke shmangur tiparin që të drejton te ndikimi.

2. Nëse ndikimi nuk mund të shmanget, hapi tjetër është ta minimizosh atë, p.sh., ta reduktosh atë që të bëhet sa më i vogël të mundet zvogëlimi në vend.

3. Sapo ndikimi të jetë reduktuar sa më shumë të jetë e mundur në burim, reduktime të tjera mund të arrihet nga zvogëlimi te receptori.



4. Nëse efektet e padëshiruara mbeten akoma, opsioni tjetër është të konsiderohet nëse ka mënyra të riparimit të dëmit pasi ai ka ndodhur.

5. Nëse ndikimi nuk mund të riparohet, duhet të konsiderohet opsioni i kompensimit për të duke zëvendësuar çfarë ka humbur. Ky kompensim mund të jetë në natyrë (p.sh., duke siguruar një burim të ngjashëm me atë që ka humbur) ose duke siguruar një përfitim tjetër mjedisor.

Hierarkia e mundshme e masave zbutëse është përmbledhur më poshtë:

Hierarkia e masave zbutëse  
Shmang në burim  
Minimizimi duke e zvogëluar në vend  
Minimizimi duke e zvogëluar te receptorit  
Riparimi i dëmit  
Kompensimi në natyrë  
Kompensime të tjera dhe nxitje

Në praktikën e mirë, masat në krye të listës duhet të zbulohen para se ato të kalojnë më poshtë, pasi kështu ato ofrojnë efikasitet dhe efektivitet më të madh në përdorimin e burimeve të kufizuara për zbutjen **e ndikimit në mjedis**.

Opsionet e masave zbutëse

Mund të jetë një seri e madhe opsionesh zbutjeje në dispozicion brenda kësaj hierarkie për një projekt specifik apo ndikim. Siç është diskutuar në lidhje me TMD, kjo do të përfshijë jo vetëm zgjidhjet teknologjike, por gjithashtu edhe metodat e punë dhe menaxhimit të masave.

Zbutja e ndikimeve në mjedis gjatë projektimit mund të lidhet me kontrole të ndotjes, por gjithashtu edhe me shtrirjen në zonë, projektin arkitektonik të strukturave, projektin e proceseve të prodhimit, peizazhin, rregullimet e aksesit, dhe shumë aspekte të tjera të projektit. Ajo mund të

përfshijë masatë izoluar nga burimi (zvogëlimi te receptorët), të tilla si barrierat e zhurmës etj.

Zbutja e ndikimeve në mjedis gjatë metodave të punës dhe menaxhimit mund të përfshijë masa, të tilla si grafiku i aktiviteteve, burimi i materialeve, skursin e trafikut për dhe nga vendndodhja, trajnimin e stafit, raportimin, dhe kontrollin e incidenteve ndotëse etj. Zbutja e ndikimeve në mjedis mund të përfshijë edhe regjimet e monitorimit për të kontrolluar nivelet aktuale të ndikimit projekti të jetë duke u zbatuar dhe masat për t'iu përgjigjur ndikimeve nëse ato janë më të mëdha se ato të parashikuara.

Zbutja mund të përfshijë gjithashtu tipat e opsioneve strategjike të cituara në shtojcën 1 në të cilin ndikimet janë shmangur ose reduktuar nga adoptimi i qasjeve të ndryshme për të arritur objektivat e projektit ose duke përdorur kërkesën e menaxhimit për të reduktuar nevojën për zhvillim, dhe vendosjen e alternativave për lëvizjen e projektit në një vend tjetër. Në këto raste, zbutja fillon të kombinohet me trajtimin e alternativave në VNM siç citohet në shtojcën 1. Nëse alternativat janë konsideruar si duhet në fillim të planifikimit të projektit, opsioni më i mirë strategjik duhet të jetë identifikuar tashmë, por gjithmonë është e mundur që opsione të reja ngrihen ndërsa projekti zhvillohet, kështu duhen mbajtur në konsideratë mënyra të mundshme të zbutjes së ndikimeve negative madhore.

Një listë kontrolli e tipave të masave që mund të përdoren për të zbutur ndikimet jepet më poshtë. Duhet theksuar që vetëm pak prej tyre mund të jenë të përshtatshme për një projekt të veçantë, por mund të ketë mundësi të tjera në dispozicion në kontekstin e projektit dhe ndikimit specifik.

Lista e kontrollit të opsioneve zbutëse  
Modifikime të planit të zonës ose strukturave të projektit  
Peizazhi brenda dhe jashtë zonës (punimet e tokës dhe mbjellja)  
Procese operimi ose lëndësh të para alternative  
Materiale dhe burime alternative të energjisë  
Masa për kursimin e energjisë dhe burimeve  
Ndryshime në planin e produkteve  
Shkallë të reduktuar të aktivitetit, masë më të vogël  
Modifikime të pajisjeve ndihmëse  
Futja e teknikave të kontrollit të ndotjes si kontrole të shkarkimeve ose teknologji të trajtimit të ujërave të ndotura  
Metoda për të reduktuar zhurmën, vibrimin, ndriçimin, rrezatimin çlirimin e energjisë në burim  
Barriera dhe ekrane për të fshehur projektin ose për të zvogëluar zhurmën



Masa të marra te receptori për të reduktuar ekspozimin ndaj ndikimeve, p.sh., të përkohshme ose të përhershme, rivendosje, izolim të zhurmës  
 Reduktim të mbetjeve, riciklim, rikuperim, rregullime të trajtimit dhe depozitimit  
 Modifikime të metodave dhe praktikave të punës, p.sh., metoda alternative ndërtimi  
 Procedura të emergjencave dhe planeve për në rast aksidentesh, rrjedhjes etj.  
 Kufizime të orëve të punës  
 Organizimi i aktiviteteve të projektit  
 Kufizime të aksesit dhe kontrolli i rrugëve  
 Rregullime të mbylljes, rehabilitimit të zonës pas përdorimit  
 Sigurimi i kompensimit (në mall ose financiar), zëvendësimi i habitateve, i burimeve të humbura, sigurimi i përfitimeve të tjera për komunitetin, përmirësime të pronave  
 Kërkime në ruajtjen e trashëgimisë kulturore  
 Sistemet e menaxhimit mjedisor  
 Politika të punësimit – p.sh., punësimi lokal  
 Trajnimi i stafit  
 Monitorimi dhe auditimi  
 Informimi i komunitetit  
*Plus*  
 Alternativat strategjike  
 Alternativat që lidhen me vendndodhjen  
 Skenari pasiv “mos bëj asgjë” apo “pa zhvillim”

#### Fazat e projektit

Së fundi, ashtu si identifikimi dhe parashikimi i ndikimeve, zbutja duhet të konsiderohet për të gjitha fazat e zhvillimit. Fazat kryesore, të cilat kanë nevojë të konsiderohen, janë:

- ndërtimi (duke përfshirë punimet paraprake);
- përgatitja;
- operimi;
- mbyllje/përfundim; dhe
- kthimi në gjendjen e mëparshme, rehabilitimi dhe pas përdorimi.

Fazat sekondare brenda secilës nga këto faza mund të ketë nevojë të konsiderohet gjithashtu. Për shembull, ndërtimi mund të përfshijë pastrim të zonës, lëvizje dherash, instalim shërbimesh, ndërtim të strukturave kryesore etj.

Operimet mund të kryhen gjithashtu në faza me njësi të reja që vijnë nga zona të ndryshme në këtë zonë në të cilën është punuar për një periudhë kohe. Masa të ndryshme zbutëse mund të nevojitet të konsiderohen në çdo fazë.

#### TRAJTIMI I MASAVE ZBUTËSE GJATË STUDIMEVE TË VNM-së DHE RAPORTIT TË VNM

Procesi bazë i studimeve të VNM është përshkruar si përfshirës:

1. vlerësim paraprak për të identifikuar ndikimet e mundshme domethënëse;

2. investigime dhe rregullime mbi propozimet për masat zbutëse; dhe

3. vlerësimi përfundimtar për të përcaktuar ndikimet mbetëse pas zbutjes.

Në praktikë zhvillimi i masave zbutëse duhet të jetë një proces i njëpasnjëshëm, duke përfshirë zhvilluesin, grupin e projektimit dhe grupin e VNM-së në shkëmbim të rregullt të informacionit dhe ideve rreth ndikimeve dhe mënyrave të reduktimit të tyre gjatë planifikimit të projektit dhe VNM. Ky ndërveprim ndërmjet procesit të VNM-së dhe procesit të planifikimit të projektit duhet të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur me qëllim që të rritet në maksimum mundësia për të integruar masat zbutëse me përfitime (*cost-effective mitigation*) në projektim para se ta shtosh atë në fund. Kujdesi fillestar për zbutjen sjell përfitime të ndryshme:

-Vëmendja e hershme për zbutjen do të thotë që masat mund të bëhen pjesë e projektit që nga fazat fillestare e në vijim.

- Zbutja është e integruar në planin e projektit para se t'i shtohet më vonë, sa më parë aq më e lirë.

- Përfshirja e zbutjes në projekte para se ato të jenë paraqitur për miratim mund të shmangë vonesat në marrjen e miratimeve.

- Ofrimi i zbutjes që zhvilluesi e di që është e arritshme, redukton rrezikun e masave të





paarritshme që i imponohen nga autoriteti kompetent.

Ndërsa studimet e VNM-së procedojnë, grupi i VNM-së do të rishikojë vlerësimin për të marrë në konsideratë zbutjen për të cilën është rënë dakord me zhvilluesin. Në fund, duhet të kryhet një vlerësim përfundimtar i ndikimeve mbetëse, duke marrë parasysh të gjitha zbutjet për të cilat është rënë dakord dhe rezultatet e paraqitura në raportin e VNM-së.

Gjatë këtij procesi, palët e treta të interesuara, si autoriteti kompetent, autoritetet e tjera mjedisore, komunitetet lokale dhe OJF-të, duhet të përfshihen nëse është e mundur, pasi kjo ndihmon në zgjedhjen e opsionit më të mirë zbutës. Kjo siguron gjithashtu një mundësi për të shpjeguar përse masat janë dhe nuk janë praktike për zhvilluesin dhe përfshirja e palëve të treta mund të jetë e vlefshme në identifikimin e zbutjes dhe kjo bën të mundur parandalimin e vërejtjeve në të ardhmen e procesit.

#### PARAQITJA E ZBUTJES NË RAPORTIN E VNM-së

Sapo të jenë përfunduar studimet e VNM-së, raporti i VNM-së duhet të identifikojë qartë të gjitha propozimet zbutëse dhe ndikimet mbetëse. Këto duhet të paraqiten si angazhime më shumë se si rekomandime ose propozime të vakëta, pasi vetëm kështu vendimmarrësi krijon një vizion të qartë se çfarë do t'i ndodhë mjedisit me projektin. Për të mbështetur propozimet e zbutjes, është gjithashtu e rëndësishme të përshkruhen opsionet e zbutjes që janë konsideruar si dhe arsyet për zgjedhjen e zbutjes së propozuar. Këto mund të përfshijnë arsye teknike dhe komerciale ashtu si dhe mjedisore. Duke diskutuar llojet e mundshme të opsioneve zbutëse të mundshme, raporti i VNM-së do të demonstrojë kuptimin dhe angazhimin e zhvilluesit për rëndësinë e zbutjes, ndërsa autoriteti kompetent do të jetë në gjendje të kuptojë se çfarë konsideron zhvilluesi të jetë i realizueshëm ose jo për projektin.

Qartësia e përshkrimit të zbutjes në raportin e VNM-së është shumë e rëndësishme. Raporti i VNM-së ka për qëllim të informojë dhe ndihmojë vendim marrjen. Autoriteti kompetent duhet të jetë i qartë në atë se çfarë nuk është përfshirë. Raporti i VNM-së duhet të përfshijë:

-Përshkrim të qartë të masave zbutëse, duke përfshirë natyrën e efektit të zbutur, vend ndodhjen dhe planin e masës, efektivitetin e zbutjes si dhe rregullimet për monitorimin dhe vlerësimin;

-Përshkrim të qartë të ndikimeve mbetëse pas zbutjes, dhe shpjegim se përse zbutje e mëtejshme nuk mund të zbatohet nëse mbeten efekte domethënëse negative;

-Përshkrim i mekanizmave nëpërmjet të cilëve do të zbatohet zbutja, monitorimi dhe zbatimi.

Përshkrimet duhet të lejojnë si lexuesit ekspertë dhe jo ekspertë të kuptojnë çfarë është propozuar cilat janë ndikimet që rezultojnë.

Në disa raste mund të mos jetë e mundur të përcaktohen masat zbutëse në detaje në raportin e VNM-së, sepse projekti nuk ka qenë i dizenuar mjaftueshëm në detaje në fazën e VNM. Në këto raste Zhvilluesi dhe grupi i VNM-së mund të përcaktojnë dhe të angazhohen për performancën mjedisore p.sh., që shkalla e humbjes së habitatit nuk do të kalojë një nivel të caktuar, që ndërtimet nuk do të jenë të dukshme nga një pikë e caktuar, ose që projekti të jetë i tillë që nivelet e ndotjes të jenë nën nivelet e specifikuar. Përmes kësaj, zhvilluesi është i angazhuar të zbatojë çfarëdo zbutje të jetë e nevojshme për të arritur respektimin e standardeve.

Nëse zbutja nuk mund të specifikohet në detaje, në fazën e VNM-së dhe lejes së zhvillimit, mund të dakordësohet për një proces për miratim të detajeve në fazat e mëtejshme. P.sh., zhvilluesi duhet të angazhohet që të paraqesë një plan të detajuar të peizazhit tek autoritetet kompetente për miratim, para se të fillojë ndërtimin. Rregullime mund të bëhen gjithashtu për miratime të mëvonshme nga autoritetet mjedisore.

Megjithëse nuk kërkohet me ligj, mund të jetë e dobishme të sigurohet një listë të masave zbutëse në raportin e VNM-së me qëllim që të mundësohen angazhimet zbutëse të zhvilluesit.

Lista mund të përfshijë masa shtesë integrale, angazhime për performancën mjedisore dhe ndonjë zonë ku për zbutjen do të dakordësohet në faza të mëvonshme. Lista mund të shpjegojë edhe propozime për monitorimin (shiko më poshtë).



Një shembull ekstrakti nga një listë të masave zbutëse

| Ndikimi                                                                                                            | Zbutja                                                                                                                                                                                                                                                                                                   | Ndikimi mbetës                                                                                                                                     |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ndikimi i shkarkimeve të ujërave të ndotura në ujë                                                                 | Të gjitha shkarkimet e procesit do të shkarkohen në kanalizime.<br>Nuk do të ketë shkarkime rutinë direkt në ujërat sipërfaqësorë.                                                                                                                                                                       | Do të sigurohet një trajtim i përshtatshëm për shkarkimet e procesit. Nuk do të ketë ndikim domethënës.                                            |
| Ndotje e tokës dhe e ujit nga rrjedhjet e hidrokarbureve                                                           | Të gjitha depozitat e naftës do të jenë të rrethuara me vaska për të parandaluar shkarkimet në mjedis. Të gjitha vaskat do të jenë të papërshkueshme dhe me kapacitet 110% të përmbajtjes. Kutitë e ndihmës në rast rrjedhje do të mbahen në zonë dhe stafi do të jetë i trajnuar për përdorimin e tyre. | Rrezik shumë i vogël për ndikime negative                                                                                                          |
| Ndotje nga mbetjet e ndërtimit. Këto do të depozitohen në vende të përshtatshme dhe të licencuara për këtë qëllim. | Të gjitha mbetjet toksike do të veçohen dhe izolohen dhe do të depozitohen në vende të përshtatshme dhe të licencuara për këtë qëllim.<br>Materialet e shembjeve do të riciklohet sa më shumë të jetë e mundur në zonë.                                                                                  | Depozitimi në vende të përshtatshme dhe të licencuara për këtë qëllim do të shmangë ndikimet negative.                                             |
| Humbja e lëvizjes të banorëve/njerëzve                                                                             | Lëvizja e banorëve/njerëzve do të riorganizohet për të mos kaluar përmes zonës. Një kalim tjetër rrotull zonës do të mundësohet për lëvizjen e banorëve/njerëzve.                                                                                                                                        | Komforti nga rruga e kalimit do të reduktohet duke humbur atraktivitetin e pamjes së rrugës ekzistuese dhe do të rritet gjatësia e rrugës me 500m. |
| Humbja e pemëve                                                                                                    | Të gjitha pemët e prera do të vlerësohen nga një staf i kualifikuar profesional. Ato do të zëvendësohen duke mbjellë pemë të reja (autoktone).                                                                                                                                                           | Biodiversiteti lokal do të përmirësohet duke zëvendësuar speciet jo karakteristike të zonës me ato lokale indigjene.                               |
| Humbja e zonave të shumimit mbarështimit të specieve                                                               | Një habitat i ri për shumimin dhe mbarështimin e specieve do të krijohet pranë zonës së projektit dhe popullsia lokale do të zhvendoset nga kjo zonë në një kohë të përshtatshme të vitit. Zona e re do të monitorohet për një periudhë 5 vjeçare pas ndërtimit.                                         | Një shqetësim afatshkurtër për shumimin dhe mbarështimin e specieve do të ndodhë, por popullimet do të rikuperohen brenda 3 vjetëve.               |
| Ndikimi i ndërtimeve të projektuara në pamjen X                                                                    | Pika më e lartë e ndërtimit nuk do të kalojë 12.5 metra mbi nivelin e tokës.                                                                                                                                                                                                                             | Ndërtimi nuk do të jetë i dukshëm nga X – pa ndikim domethënës                                                                                     |



|                                                                    |                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                             |
|--------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ndikim i ndërtimeve të projektuara në karakterin e peizazhit lokal | Projektpropozim i detajuar, materialet dhe trajtimi i pamjes së jashtme të të gjitha ndërtimeve dhe strukturave të tjera a do t'i dërgohet autoritetit vendor për miratim para se të fillojë ndërtimi. Ndërtimi nuk do të fillojë pa u marrë miratimi me shkrim. | Do të shmangen ndikimet negative.                                                           |
| Ndikimi i trafikut nga ndërtimi te zhurmat                         | Makinat e ndërtimit nuk do të lejohet të lëvizin gjatë rrugëve X Y Z për dhe nga sheshi i ndërtimit.                                                                                                                                                             | Numri i shtëpive të afektuara nga trafiku si rezultat i ndërtimit do të ulet nga 20 në 5.   |
| Ndikimi i pluhurave nga ndërtimi në shtëpitë pranë                 | Në kohë të thatë do të spërkatet zona për të parandaluar pluhurin. Shpejtësia limit do të jetë 15 km/orë. Të gjitha makinat që dalin nga sheshi i ndërtimit do të kalojnë nëpër larësin e gomave dhe ngarkesat me pluhur do të mbulohen.                         | Nivelet e pluhurit të ndërtimit do të jenë tipike të një sheshi ndërtimi të menaxhuar mirë. |
| Ndikimi i zhurmës nga operimet pranë shtëpive                      | Një barrierë zhurme do të ngrihet pranë sheshit të ndërtimit në mënyrë që nivelet e zhurmës në shtëpitë më të afërta nuk do të jenë më të larta 4 dB (12 orë LAeq).                                                                                              | Pranë pronave private do të ketë një rritje të lehtë të zhurmës                             |

Alternativa për një listë të masave zbutëse është të përgatitet një plan menaxhimi mjedisor (PMM) i Projektit. Edhe kjo nuk kërkohet me ligj, por mund të ndihmojë Zhvilluesin dhe autoritetin kompetent. PMM-ja do të vendosë të gjitha masat e propozuara, programin dhe burimet për zbatimin, përgjegjësitë, masat e duhura, përgjegjësitë për monitorimin dhe se çfarë do të bëhet nëse masat nuk janë të suksesshme, duke përfshirë dhe raportimin të palët e treta të interesuara.

#### SIGURIMI I MASAVE ZBUTËSE – VENDIMMARRJA DHE KUSHTET E MIRATIMIT

##### Zbatimi i masave zbutëse

Siç është shpjeguar më sipër, është praktikë e mirë të përshkruhet qartë në raportin e VNM-së që zhvilluesi angazhohet të adoptojë zbutjet e propozuara, dhe ku është e përshtatshme, të monitorojë efektet gjatë zbatimit të projektit. Megjithatë, masat zbutëse do të jenë të suksesshme

vetëm nëse zbatohen dhe për këtë arsye është thelbësore që autoriteti kompetent të detyrojë zhvilluesin për zbatimin e tyre nëse zhvilluesi nuk i kryen ato. Autoritetet kompetente kanë përgjegjësinë të detyrojnë zbatimin e masave të përcaktuara në raportin e VNM-së. Kjo mund të bëhet ose me referencë të raportit të VNM-së, ose duke siguruar detaje në dokumentet e aplikimit për leje zhvillimi, ose në dokumentin e miratimit. Në përputhje me ligjin në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, zhvilluesi është përgjegjës për të kryer monitorimin e ndikimit mjedisor të projektit në përputhje me deklaratën mjedisore. Shpesh raporti i VNM-së në vetvete nuk është detyrues, dhe në këtë rast duhet që të vendosen kërkesa dhe përgjegjësi për masat zbutëse si kushte në lejen e zhvillimit. Nëse masat zbutëse nuk janë zbatuar, autoriteti kompetent ndërmerr veprime për shkelje të lejes sipas procedurave të kushteve të lejes së zhvillimit.



Dakordësimi i masave zbutëse dhe zhvillimi i kushteve

Lista përfundimtare e masave zbutëse që duhet të zbatohen, përcaktohet zakonisht sipas raportit të VNM-së të paraqitur dhe të vendosura në deklaratën mjedisore. Masat zbutëse mund të vendosen gjithashtu si kushte në lejen e zhvillimit. Për shumë zhvillime kjo mund të kërkojë një numër të madh kushtesh individuale për të siguruar që të gjitha masat e përshkruara në raportin e VNM-së janë mbuluar. Në këto rrethana autoriteti kompetent mund të vendosë kushte të përgjithshme, duke i kërkuar zhvilluesit t'i zbatojë të gjitha masat e propozuara në raportin e VNM-së dhe të përcaktuara në deklaratën mjedisore. Për arsye të detyrimeve ligjore, citimi i të gjitha kërkesave dhe përgjegjësi mund të jetë shumë i saktë dhe për sa kohë raportet e VNM-së janë nganjëherë jo shumë të sakta, është zakonisht funksionale të shtohen kushte specifike për masa zbutëse të rëndësishme, vetëm për të garantuar që ato përcaktojnë qartë detyrimin për zbatueshmërinë.

#### Monitorimi dhe menaxhimi

Kushtet e deklaratës mjedisore dhe të lejes së zhvillimit mund të kërkojë monitorimin, me qëllim që të kontrollohet që zbutja është zbatuar dhe ndikimi mbetës nuk është më i madh se ai i

parashikuar në raportin e VNM-së. Në vendin tonë kjo është përgjegjësi e inspektimeve të lejeve të ndërtimit dhe operimit, por megjithatë duke e adresuar atë është e rëndësishme të njihet që monitorimi është po aq i dobishëm sa edhe vetë veprimi i ndërmarrë në përgjigje të rezultateve.

Kushtet e monitorimit duhet të specifikojnë se çfarë duhet të bëhet me rezultatet (p.sh., ato duhet të dërgohen tek autoriteti kompetent një herë në muaj) dhe çfarë duhet të bëhet nëse ndikimi rezulton më i madh se sa i parashikuar. Një qasje alternative për të krijuar kushte specifike, është t'i kërkohe zhvilluesit të krijojë një sistem të menaxhimit të mjedisit (SMM), i cili ofron mjete më të strukturuar dhe të gjithanshme të menaxhimit të ndikimit mjedisor të zhvillimit. SMM do të listojë të gjitha detyrimet ligjore dhe kërkesat e tjera mjedisore, përfshi kushtet e lejes, dhe do të përcaktojë përgjegjësitë dhe procedurat për sigurimin e zbatimit të tyre, monitorimin, raportimin, auditin dhe rishikimin. Standardi ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të mjedisit ISO14001 dhe EU EMAS sigurojnë një bazë të dobishme për krijimin e sistemeve të tilla. Disa aspekte kryesore të praktikave më të mira në menaxhimin e mjedisit janë përmbledhur më poshtë.

#### Praktikë e mirë në menaxhimin e mjedisit

Praktika e mirë në menaxhimin e mjedisit përfshin zhvillimin e politikave të qarta, planeve dhe procedurave për identifikimin dhe menaxhimin e ndikimeve mjedisore të një aktiviteti, përcaktimin e përgjegjësi specifike për veprim, duke siguruar që stafi di çfarë bën dhe është kompetent për të bërë atë që i kërkohe, duke krijuar sisteme monitorimi dhe auditim të sistemit.

Një sistem menaxhimi i gjithanshëm do të përfshijë procedura për të siguruar që masat zbutëse janë përfshirë në planin e projektit dhe janë zbatuar si duhet dhe që projekti operon në mënyrë të tillë që i kontrollon ndikimet e tij. Kontrolli operacional mund të përfshijë:

- Sistemet për kontrollin e aktiviteteve (p.sh., procedurat e operimit dhe instruksionet);
- Sistemet për monitorimin e efekteve të projektit dhe mekanizmat shoqërues në përgjigje të tyre;
- Sistemet për menaxhimin e informacionit dhe komunikimet (mbajtja e të dhënave, komunikimet brenda dhe jashtë etj.).

Komunikimet me palët e treta mund të jenë të vlefshme pasi ndihmojnë zbutjen dhe mund të përfshijnë:

- sigurimin e informacionit rreth performancës të palët e interesuara të projektit;
- krijimin e grupeve lokale të bashkëpunimit;
- krijimin e procedurave për trajtimin e ankesave.

Në përgjithësi sa më kompleks të jetë projekti, aq më i dobishëm është për zhvilluesin dhe autoritetin kompetent që raporti i VNM-së të

ofrojë angazhime për adoptimin e një SMM si pjesë e propozimit për zbutje.



| Komponenti mjedisor                                                                              | Ndikimet e mëdha të mundshme negative në mjedis                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Zbutja e propozuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përdorimi i hapësirës (në lidhje me planet e zonimit)                                            | Mungesa e harmonizimit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Harmonizimi i projektit me planet përkatëse fizike                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Përdorimi i burimeve të tjera (të rinovueshme dhe jo – të rinovueshme)                           | Përdorim pa kriter i burimeve që janë të rralla në një zonë të caktuar ose globalisht (lëndët e para, energjia), në mënyrë të veçantë në lidhje ndikimet pozitive të projektit                                                                                                                                                                               | a) Alternativa teknike;<br>b) Alternativa vendndodhjeje në të cilat burimi në fjalë është më pak i rrallë ose me vlera;<br>c) Reduktimi i madhësisë së projektit/kapaciteti.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Gjenerimi i të gjitha tipave dhe kategorive të mbetjeve                                          | a) Gjenerimi i mbetjeve të ndërtimit gjatë ndërtimit të projektit;<br>b) Gjenerimi i mbetjeve industriale (në mënyrë të veçantë të rrezikshme) gjatë operimit të projektit;<br>c) Mungesa e faciliteteve për menaxhim të përshtatshëm të mbetjeve pranë zonës së projektit;<br>ç) Gjenerimi i mundshëm i mbetjeve të rrezikshme të ndërtimit gjatë mbylljes. | a) Përcakto më përpara vende depozitimi dhe/ose metoda të menaxhimit të mbetjeve të ndërtimit;<br>b) - Ndërmerr veprime të shpeshta dhe të kontrolluara për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe industriale në përputhje me rregulloret, ose ndalo depozitimin e përkohshëm ose të përhershëm të këtyre mbetjeve në zonën përreth dhe vendos kontejnerë rezistentë ndaj rrjedhjeve;<br>c) Zhvillo një plan të menaxhimit të mbetjeve nëse sasitë e mbetjeve janë të konsiderueshme ose mund të tejkalojnë kapacitetet e infrastrukturës ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve në zonë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Gjenerimi i shkarkimeve në mjedis siç përcaktohen nga legjislacioni në fuqi për lejet e mjedisit | Shkarkime të tejkaluara të çdo tipi në mjedis                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | a) Teknikat më të mira në dispozicion (TMD);<br>b) Reduktimi i madhësisë së projektit/kapacitetit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |
| Uji (ujërat sipërfaqësorë, ujërat nëntokësorë)                                                   | a) Ndotja e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë gjatë;<br>b) Pikë shkarkimi e ujërave të zeza gjatë operimit;<br>c) Ndotje e ujit sipërfaqësor (e përhapur).                                                                                                                                                                                               | a) Zonat e parkimit të mjeteve dhe makinerive duhet të bëhen rezistente ndaj rrjedhjeve, ndërsa precipitimet duhet të trajtohen në separatorë para se të shkarkohen në tokë; b) Para shkarkimit në mjediset pritëse, ujërat e zeza duhet të trajtohen në një shkallë që i korrespondon kategorisë së cilësisë së ujit të pritësit. Të gjitha njësitë e trajtimit të ujërave të zeza duhet të kontrollohen rregullisht dhe të mirëmbahen;<br>c) Apliko TMD me qëllim reduktimin e përhapjes së ndotjes ose si alternativë reduktio madhësinë e projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
| Mjedi detar                                                                                      | a) Eutrofikimi;<br>b) Kërcënime të zonave të mbrojtura;<br>c) Pengimi i qarkullimit në det;<br>ç) Futje e specieve që nuk janë karakteristike për zonën;<br>d) Kërcënime për sigurinë e lundrimit                                                                                                                                                            | a) Nëse risku i eutrofikimit të detit ekzistonte para fillimit të projektit, duhet të zgjidhet një vend ndodhje alternative e projektit;<br>b) Duhet të zgjidhet një vendndodhje alternative e projektit ku specie dhe zonat e mbrojtura nuk do të jenë të rrezikuara;<br>c) Ndrysho gjeometrinë e projektit/projektin teknik/proporcionet në mënyrë që të sigurohet një qarkullim i kënaqshëm në det;<br>ç) Apliko TMD për të reduktuar kërcënimet për speciet karakteristike të zonës nga futja e specieve jo karakteristike;<br>d) Në mënyrë alternative, zgjidh një vend ndodhje më të përshtatshme ose reduktio madhësinë e projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Toka dhe toka bujqësore (e zënë nga projekti). Aktiviteti bujqësor                               | a) Sipërfaqja e tokës së zënë;<br>b) Ndryshimi i përdorimit të tokës;<br>c) Shkarkimet e substancave të dëmshme në tokë;<br>ç) Erozioni;<br>d) Fragmentimi.                                                                                                                                                                                                  | a) Shmang përdorimin e tokës me cilësi të lartë për qëllime zhvillimi;<br>b) Gjatë lëvizjes së dherave, depozito shtrësën e humusit në mënyrë që ta përdorësh më tej për peizazhin dhe zonat e gjelbra buferike për rrugët ose për qëllime të tjera në përputhje me rregulloret;<br>c) Siguro që toka në zonat e parashikuara me ndikim (në mënyrë të veçantë toka bujqësore e cilësisë së lartë) është e mbrojtur si duhet nga grimcat e shkarkimeve, duke vendosur bimësi në zonat buferike;<br>ç) Në rast rreziku të erozionit të tokës nga veprimi i ujit, merr masa të përshtatshme për ta ndaluar atë<br>d) Siguro akses të duhur për të zëvendësuar rrugët ose kalimet nga secila pjesët e krijuara nga projekti ose në mënyrë alternative, blej të gjitha pjesët me qëllim që të konsolidosh tokën ose ndrysho përdorimin e saj, në këtë mënyrë pengon krijimin e vendeve të grumbullimit të plehrave. |
| Flora dhe vegjetacioni                                                                           | a) Humbja e habitatit;<br>b) Ndryshimi në përbërjen e komuniteteve florale dhe                                                                                                                                                                                                                                                                               | a) Shkarko mbetjet e tepërta në landfille, në vend që t'i "nivelosh" ato me terrenin;<br>b) Shmang habitatet dhe speciet e rralla dhe të rrezikuara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |



| Komponenti mjedisor                                     | Ndikimet e mëdha të mundshme negative në mjedis                                                                                                                                                                                                                     | Zbutja e propozuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
|---------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                         | reduktimi popullimeve të specieve të bimësisë:<br>c) Kërcënime për speciet e bimëve;<br>ç) Futja e specieve jo karakteristike.                                                                                                                                      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Fauna                                                   | a) Humbja e habitatit dhe/ose shkatërrimi (përfshirë ato speleologjike);<br>b) Ndërpërja e kalimeve migratore;<br>c) Pengimi i komunikimit ndërmjet individëve të të njëjtë popullim;<br>ç) Kërcënime të specieve të kafshëve të mbrojtura;<br>d) Vrasjet në rrugë. | a) Gjatë ndërtimit të facilitateve, përcakto me kujdes rrugët e lëvizjes së makinave me qëllim minimizimin e shkatërrimit të habitatit;<br>b) Ruaj korridoret e kafshëve (gjallesave) të egra migratore nga ndërtimi i tuneleve, urave, mbikalimeve (respekto kërkesat specifike) ose facilitetet specifike (kalimet e kafshëve, gjallesave të egra), si dhe vendos struktura më të vogla të përshtatshme për kafshë të vogla (përfshi amfibët);<br>c) Punimet që përfshijnë ndërtime që gjerojnë, presin më shumë se 10m dhe/ose tunele, duhet të monitorohen nga një biospeleolog;<br>ç) Në rast se shkohet pranë strukturave nëntokësore, punimet e projektit duhet të ndërpriten deri sa një grup biospeleologësh të vendosi për situatën dhe të përcaktojë masat e nevojshme mbrojtëse për faunën dhe habitatet nëntokësore;<br>d) Është e nevojshme të sigurohet monitorim i përhershëm i faunës dhe habitateve (të menduara domethënëse nga biospeleologët);<br>dh) Kontroll i rregullt i zonës buferike, në mënyrë të veçantë të tunelet dhe pikat dalëse të kanaleve kulluese. |
| Pyjet dhe pylltaria (sipërfaqet e zëna, aksesibiliteti) | a) Sipërfaqja e zënë e tokës;<br>b) Pyjet dhe rreziqet e zjarrit;                                                                                                                                                                                                   | a) Gjatë planit të projektit, planifiko marrjen e masave për të parandaluar rrëshqitjet e tokës;<br>b) Gjatë ndërtimit shmang dëmtimin e pemëve dhe rrënjët e tyre;<br>c) Sapo të hapet një brez pylli, krio dhe mirëmbaj rregullin në pyll, largo mbetjet, kujdesu për drurët, për trungjet e prerë;<br>ç) Vëmendje e veçantë gjatë ndërtimit duhet t'u kushtohet materialeve që marrin flakë dhe të respektohen rregulloret dhe procedurat përkatëse për mbrojtjen nga zjarri                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Gjuetia                                                 | a) Fragmentimi i habitatit;<br>b) Ndërpërja e kalimeve migratore;<br>c) Shqetësimet nga gjuetia;<br>ç) Humbja e tokës produktive të gjuetisë.                                                                                                                       | a) Mbro tokën nga hyrjet e panevojshme dhe të pakontrolluara dhe lëvizjet në tokën e gjuetisë, duke projektuar korridore specifike dhe kalime në pyll për njerëzit dhe automjetet;<br>b) Në bashkëpunim me gjuetarët, rivendos ose zëvendëso facilitetet ekzistuese të menaxhimit të gjuetisë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Zhurma dhe vibrimet                                     | Nivele të larta të zhurmës dhe vibrimeve                                                                                                                                                                                                                            | a) Redukto nivelet e zhurmës dhe vibrimeve në burim duke aplikuar TMD;<br>b) Siguro distancën e duhur ndërmjet projektit dhe facilitateve të rrezikuara me qëllim mbajtjen e niveleve të zhurmës dhe vibrimeve brenda kufijve të lejuar;<br>c) Nëse do të jetë e pamundur të mbahet distanca e duhur, përdor barrierë zhurme;<br>ç) Nëse barrierat me dimensione të përshtatshme nuk janë të mjaftueshme për të ulur nivelet e zhurmës, ul nivelet e zhurmës duke përdorur instrumente mbrojtës, dritare me dy xhama etj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Cilësia e ajrit (lokal)                                 | a) Rritje e përqendrimeve të ajrit me substanca të dëmshme;<br>b) Rritje e përqendrimeve të ajrit me grimca.                                                                                                                                                        | a) Redukto shkarkimet në ajër të ndotësve në burim duke aplikuar TMD;<br>b) Siguro një distancë të madhe të mjaftueshme ndërmjet projektit dhe facilitateve vulnerabël me qëllim mbajtjen e niveleve të shkarkimit brenda kufijve të pranueshëm, duke marrë parasysh gjithashtu dhe nivelet e shkarkimeve ekzistuese (situata pa projekt);<br>c) Nëse do të jetë e pamundur të sigurohet një distancë e madhe e mjaftueshme, kufizo kapacitetin prodhues ose transferoje projektin në një vend tjetër.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Cilësia e ajrit (global)                                | a) Shkarkimet e CO2 ozonit (paraprakisht SO2 and NOx)                                                                                                                                                                                                               | a) Në nivel strategjik përcakto mënyrat për të reduktuar shkarkimet me komponentë aktivë globalë (burime alternative energjie, procese teknologjike alternative në industri) dhe zbatoi ato në raste konkrete nëse është e mundur;<br>b) Redukto shkarkimet në ajër të ndotësve në burim duke aplikuar TMD.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Popullsia (aspektet e shëndetit)                        | Efektet kumulative të disa ndikimeve të dëmshme, të cilat individualisht nuk i kalojnë vlerat limit, por është e arsyeshme të presësh që shuma e këtyre ndikimeve individuale mund të shkaktojë ndikim negativ                                                      | a) Nëse analizat toksikologjike tregojnë rrezik aktual nga efekte të dëmshëm kumulative modifiko projektin për të shmangur efektet kumulative ose tërhiqe projektin;<br>b) Në mënyrë alternative, kufizo kapacitetin e projektit;<br>ç) Si alternativë, në nivel strategjik, konsidero mundësitë për të reduktuar shkarkimet nga një tjetër burim dominant.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Shumëllojshmëria biologjike                             | Biodiversiteti i reduktuar, si rezultat i:<br>a) shkatërrimit dhe fragmentimit të habitateve të sipërfaqes dhe nëntokës;                                                                                                                                            | a) Shmang kontaktin me specie dhe habitate të rralla dhe vulnerabël;<br>b) Ruaj korridoret ekzistuese të botës së egër migratore duke ndërtuar tunele dhe kanaleve kulluese që janë në përputhje me kërkesat të miratuara, dhe tunele artificiale – me kalime për kafshët e vogla (përfshi amfibët dhe reptilët);                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |



| Komponenti mjedisor                                     | Ndikimet e mëdha të mundshme negative në mjedis                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Zbutja e propozuar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                         | b) ndërprerje e korridoreve të migrimit, p.sh., krijimi i barrierave;<br>c) ndotje e ujit;<br>ç) vrasjet në rrugë;<br>d) ndryshime në përbërjen florale të komuniteteve.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | c) Gjatë ndërtimit të faciliteteve, përcakto me kujdes rrugët e kalimit të automjeteve për të minimizuar shkatërrimin e habitatit;<br>ç) Punimet që përfshijnë ndërtim tunelesh dhe prerjesh më të mëdha se 10m duhet të monitorohen nga një biospeleolog;<br>d) Në rast të kalimit përmes strukturave nëntokësore, punimet e projektit duhet të ndalohen derisa një grup biospeleologësh të vendosin situatën në vend dhe të përcaktojnë masat mbrojtëse të nevojshme për faunën dhe habitatet nëntokësore;<br>dh) Nëse është e nevojshme, përdor një sistem të mbyllur të ujërave të ndotur;<br>e) Kontroll të rregullt të zonave buferike, në mënyrë të veçantë të kanalet kulluese dhe pikat dalëse të tuneleve. |
| Peizazhi                                                | a) Zhvillim urban i shpërndarë dhe disproporcional e i parregullt nga ana mjedisore;<br>b) Projekte të mëdhenj infrastrukture;<br>c) Projekte ujërash;<br>ç) Ndërtim dhe ndryshime në peizazhe me vlera;<br>d) Ndryshime vizuale në zonë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | a) Para fazës së konceptimit të projektit, zhvillo vëzhgime dhe ndërmerr vlerësime të peizazhit kur nuk ka dokumente të menaxhimit të peizazhit;<br>b) Shmang vendosjen e projektit në peizazhe me vlerë;<br>c) Në fazën e projektimit, merr masa që komponentët e ndërtimit (materiale, format etj.) të jenë të harmonizuar me karakteristikat e peizazhit;<br>ç) Gjatë fazës së zhvillimit të projektit, zhvillo një projekt të peizazhit që merr në konsideratë tiparet bazë të zonës përreth;<br>d) Në krijimin e peizazheve, përdor specie që janë karakteristike të zonës për komunitetet e vegetacionit;<br>dh) Në fazën e planifikimit kujdesu për rregullore të menaxhimit të peizazhit                     |
| Trashëgimi natyrore e mbrojtur (përfshi zënien e tokës) | Kërcënime për zonat e mbrojtura                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Duke pasur parasysh vulnerabilitetin ekologjik të zonave të mbrojtura, nëse projekti do të kërcënojë fenomenin e tyre bazik, është e nevojshme ta transferosh atë jashtë kufijve të zonës së mbrojtur së paku në një distancë të barabartë me zonën e ndikimit të projektit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          |
| Trashëgimia mbrojtur kulturore                          | a) Shkatërrimi fizik i objekteve;<br>b) Shkatërrimi i përgjithshëm i integritetit të trashëgimisë kulturore                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | a) Lëvizje e rrugës;<br>b) Lëvizje e strukturave të trashëgimisë kulturore;<br>c) Mbrojtje në vend e strukturave të trashëgimisë kulturore;<br>ç) Kërkim dhe dokumentim i strukturave të trashëgimisë kulturore;<br>d) Supervizion nga ekspertët.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Marrëdhëniet socio-ekonomike dhe ekonomia               | a) Shfrytëzimi i burimeve që janë të rëndësishme për ekonominë lokale (toka, mjedisi ujor, uji i pijshëm, energjia, rezervat minerare);<br>b) Angazhim i fuqisë punëtore, duke përfshirë punëtorët shtesë të sjellë nga jashtë zonës dhe efektet që lidhen me të;<br>c) Presion i tepërt mbi infrastrukturën ekzistuese publike (rrugët, largimi i mbeturinave, shkarkimin e ujërave të zeza furnizimi me ujë);<br>ç) Disponueshmëri e reduktuar e faciliteteve ekzistuese për shkak të ndikimeve në cilësinë e ajrit, nivelet e zhurmave dhe peizazhin. | a) Harmonizo qasjen e projektit me kapacitetet ekzistuese ekonomike dhe teknologjitë;<br>b) Zgjero kapacitetet e infrastrukturës me shpenzimet e projektit;<br>c) Kompensime të përkohshme ose të përhershme për ndërmarrjet tregtare të ndikuara nga projekti;<br>ç) Masa të tjera mbrojtëse që varen nga specifikat e projektit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |
| Siguria dhe situatat e emergjencave                     | Efektet mjedisore të aksidenteve të ndryshme, duke u varur nga tipi i projektit                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                          | Zhvillo një plan veprimi operativ për raste emergjencash të harmonizuar me planin lokal/rajonal të emergjencave                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |



## SHTOJCA 4 – TRAJTIMI I RREZIQEVE DHE “NGJARJEVE TË PAZAKONSHME”

### TË TJERA NË VNM

#### MESAZHET KRYESORE

1. Është praktikë e mirë të merren në konsideratë rreziqet për mjedisin dhe shëndetin e njeriut që rrjedhin nga aksidente dhe ngjarje të tjera jonormale të paktën në mënyrë cilësore brenda VNM-së.

2. Vlerësimi i rrezikut duhet të fillojë në një nivel të thjeshtë dhe mund të bëhet më i sofistikuar, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të rreziqeve që janë nën vlerësim.

3. Një numër i aktiviteteve esenciale janë të përfshira në vlerësimin e rrezikut. Këto bëhen në pesë hapa kryesore: identifikimi i rrezikut; analiza e rrezikut; analiza e pasojave; përcaktimi i rrezikut, dhe; vlerësimi dhe masat zbutëse.

4. Parimi ALARP (rreziqe sa më të ulëta që është e mundur) specifikon nivelin, i njohur zakonisht si kriteri tolerancës maksimale, mbi të cilin rreziku konsiderohet si i patolerueshëm. Poshtë këtij niveli, rreziqet duhet të bëhen “të ulët sa të jetë arsyeshme praktikisht” (ALARP- sa më të ulët që është e mundur). Ky parim mund të aplikohet për vlerësimin dhe reduktimin e rreziqeve.

#### HYRJE

Parashikimi i ndikimit të ngjarjeve të pazakonshme në VNM-në merret kryesisht me pasiguritë që lidhen me ndikimet që janë relativisht të sigurt që të ndodhin - ato janë pasojat e operacioneve rutinë të projektit. Megjithatë, gjithmonë qëndron një rrezik që një ngjarje e pazakonshme mund të shkaktojë probleme të rënda mjedisore gjatë ciklit të jetës së një projekti.

Identifikimi i rreziqeve kërkon ekzaminimin sistematik të të gjithë elementeve në hartimin e projektit dhe ndërveprimeve të tyre me njerëzit dhe mjedisin për të përcaktuar se sa dëme (për shëndetin ose për mjedisin) mund të lindin. Shembujt përfshijnë:

- rreziqet natyrore të tilla si paqëndrueshmëria e tokës, përmytjet dhe tërmetet;
- dështimi i strukturave inxhinierike nën presion të tilla si digat;

- mosfunksionimi i impianteve dhe pajisjeve, duke shkaktuar çlirimin aksidentalisht të kimikateve toksike, të ndezshme ose eksplozive;

- derdhjet aksidentale të substancave të tilla si nafta.

Një rrezik mund të përkufizohet si një situatë që në rrethana të caktuara mund të sjellë dëmtime ose të dëmtuar. Niveli i rrezikut llogaritet duke kombinuar probabilitetin, ose frekuencën, e shfaqjes së një rreziku të përcaktuar dhe madhësinë e pasojave që mund të ndodhin. Përderisa ligji në fuqi për vlerësimin e ndikimit në mjedis, nuk i referohet në mënyrë eksplicite rrezikut, si pjesë e fushës së VNM-së, është praktikë e mirë për raportin mjedisor të përshkruajë rreziqet mjedisore dhe shëndetësore që rrjedhin nga projektet, ku këto janë të rëndësishme. Ky mund të jetë rasti tipik për projekte/instalime të mëdha që përdorin substanca të rrezikshme, dhe në ato projekte ku zonat i nënshtrohen niveleve të larta të rreziqeve natyrore, ku i garantohen masa dhe politika të veçanta (p.sh., në zonat e mbrojtura nga tërmetet dhe përmytjet). Këto projekte mund të jenë subjekt i një vlerësimi të veçantë kuantitativ (VVK) të rrezikut dhe rezultatet e tij duhet të përmbledhen në raportin mjedisor. Kur një VVK (vlerësim i veçantë kuantitativ) formal nuk është kryer, është ende e përshtatshme të sigurohet një diskutim cilësor i rreziqeve në VNM. Kjo shtojcë merret me metodat për vlerësimin e rrezikut nga ngjarjet e pazakonshme dhe aksidentet.

#### VLERËSIMI I RREZIKUT

Vlerësimi i rrezikut (VR) është metoda shkencore e përcaktimit të pasigurisë në lidhje me ngjarjet e ardhshme të këtij lloji. Teknikat mund të jenë ose cilësore ose sasiorë. Teknikat cilësore janë përdorur zakonisht për të vlerësuar sisteme të thjeshta ku pasojat e ngjarjeve janë më pak të rënda. Vlerësimi sasior i rrezikut është përdorur për sistemet më komplekse dhe për rreziqet që mund të çojnë në konsekuenca të rënda si vdekja e njerëzve (viktima).

Vlerësimi i rrezikut adreson tri pyetje themelore:

1. Çfarë mund të shkojë keq?
2. Sa shpesh mund të ndodhë?
3. Cilat janë pasojat për njerëzit dhe mjedisin?
4. Kombinon përgjigjet në matjen e rreziqeve.

Vlerësimet duhet të fillojë në një nivel të thjeshtë dhe mund të bëhen më të sofistikuar, në varësi të natyrës dhe kompleksitetit të rrezikut dhe nevojat e vendimmarrësit (në menaxhimin e riskut kjo është e njohur si një “qasje e niveluar” (*tiered approach*). Duke përdorur një “qasje nivelesh” duhet





të sigurohet që burimet e aplikuara për vlerësimin e rrezikut të jenë proporcionale me rrezikun.

Një numër aktiviteteve esenciale janë të përfshirë në vlerësimin e rrezikut. Këto ndahen në pesë hapa kryesorë:

- Identifikimi i rrezikut;
- Analiza e rrezikut;
- Analiza e pasojave;
- Përcaktimi i rrezikut,
- Vlerësimi dhe masat zbutëse.

Kjo shtojcë jep një pasqyrë të këtyre hapave.

#### Hapi 1: Identifikimi i rrezikut

Ky hap përfshin identifikimin e materialeve të rrezikshme ose ndonjë ngjarje të rrezikshme që mund të lidhet me projektin. Një konsekuencë e përbashkët në krijimin e rreziqeve të mundshme është që të administrohen rreziqet dytësore që mund të lindin. Për shembull, gjatë një përmbytjeje të një lumi, sedimentet mund të depozitohen nëpër fusha në toka bujqësore. Nëse këto sedimente janë të ndotura, ato mund të përbëjnë një rrezik për të korrat në tokën që është përmbytur ashtu si dhe rreziku për njerëzit dhe pronat të shkaktuara nga vetë përmbytjet.

Është e rëndësishme që gama e plotë e rreziqeve të mundshme të identifikohet që në fillim, edhe nëse është për të sqaruar se pse disa rreziqe të mundshme janë hedhur poshtë si të tilla dhe që nuk kërkojnë vlerësim të mëtejshëm.

#### Hapi 2: Analiza e rrezikut

Ky është vlerësimi i frekuencës ose i probabilitetit të të ndodhurit të ndonjë incidenti të rrezikshëm që mund të shkaktojë dëm. Kjo përfshin:

- specifikimin e sekuencës së ngjarjeve që mund të çojnë në të ndodhurin e incidentit të rrezikshëm nga defekti ose analizës së pemës/historisë së ngjarjes;

- kuantifikimin e gjasës së incidentit.

“Analiza e pemës/historisë së defektit, shkakut” fillon me incidentin që shkakton efekti mbi njerëzit e mjedisin (p.sh., zjarr ose derdhje/rjedhje) dhe të rikthehet përmes dështimeve apo ngjarjeve që mund të kenë çuar në këtë pikë. “Analiza e pemës/historisë së ngjarjes” shtrihet nga fillimi i ngjarjes deri në incidentet që mund të dëmtojnë njerëzit dhe mjedisin. Të dyja mund të përdoren për të siguruar një paraqitje grafike të marrëdhënieve ndërmjet ngjarjeve të veçanta dhe incidenteve të padëshiruara përfundimtare

(nganjëherë referuar si “ngjarje kryesore”). Për shembull, nëse incidenti i rrezikshëm është një zjarr i madh, atëherë ngjarja që ka sjelle këtë incident mund të jetë një rrjedhje nga një valvul e dëmtuar që ka pasur një derdhje të madhe të lëngshme të djegshme ose një shkëndijë elektrike. Analizat e ngjarjes dhe historisë së shkakut janë në përgjithësi të lejueshme për të lejuar bashkimin e dy vlerësimeve kuantitative dhe kualitative për probabilitetin e dështimit.

Studimet e rrezikut dhe operacionalitetit (HazOps) “*Hazard and Operability Studies*” është qasje e veçantë për analizën e pemës/historisë së ngjarjes e përdorur shpesh në studimet e instalimeve me rrezikshmëri të lartë. Qasja HazOps është që të shqyrtojë segmente të vogla të procesit ose operimit në një mënyrë sistematike për të identifikuar të gjithë skenarët e mundshëm të aksidenteve. Informata të hollësishme të projektimit, karakteristikat operative dhe të dhënat historike mbi frekuencat e dështimit nga uzina ose pajisje të ngjashme janë përdorur për të kryer analiza. Pasi janë identifikuar fillesat e ngjarjeve të ndryshme, historitë e ngjarjeve janë gjurmuar përmes incidenteve të rrezikshme që prekin njerëzit apo mjedisin dhe probabiliteti që të ndodhin të përcaktohet, nëse është e mundur. Burimi i çdo të dhëne të përdorur në llogaritjet duhet të referohet për të siguruar një tregues besueshmërie.

#### Hapi 3. Analiza e pasojës

Kjo fazë në proces përfshin parashikimin e pasojave për njerëzit dhe mjedisin që mund të lindin nga një rrezik i dhënë. Ajo mund të ndahet në tri faza kryesore, si më poshtë:

- përcaktimi i pasojave ose ndikimeve të mundshme të rrezikut, duke përfshirë sekuencën e ngjarjeve nga incidentet e rrezikshme deri në ndikimi;

- parashikimin e përmasave të pasojave të mundshme;

- vlerësimin e probabilitetit të ndodhjes së pasojës.

#### *Ekzaminimi i ndikimeve/pasojave*

Është e rëndësishme që gama e plotë e pasojave të mundshme është konsideruar në këtë fazë. Disa pasoja janë të lidhura qartë me rrezikun e veçantë që analizohet, të tilla si ndikimet shëndetësore të njeriut dhe fauna e egër, nga shkarkimet e kimikateve toksike në kanalet e ujërave. Të tjerat janë më pak të dukshme, të tilla si ndotja që vjen



nga një përmbetje që është shkaktuar nga një mbi derdhje e sistemit të kanalizimit.

Shqyrtimi i sekuencës së ngjarjeve nga incidenti i rrezikshëm deri të ndikimi do të ndryshojnë në kompleks, në varësi të natyrës së rrezikut të konsideruar. Për shembull, ajo është relativisht e thjeshtë për të analizuar ndikimet mbi shëndetin njerëzor të një shpërthimi të një sasie të njohur kimikatesh. Shpërthimi do të çlirojë një energji që mund të shprehet në terma ekuivalentë të një shpërthimi. Presioni i valës që del nga shpërthimi do të ndikojë objektiva të caktuara, në afërsi. Në anën tjetër, është më e vështirë për të analizuar ndikimet e çlirimit të kimikateve toksike në atmosferë, se sa të përfshish shqyrtimin e kushteve meteorologjike të mundshme, që ndikojnë shpërndarjen/shpërhapjen.

#### *Parashikimi i përmasave të pasojave*

Parashikimi i përmasave të pasojave do të ndryshojë në varësi të kompleksitetit të ngjarjes së rrezikshme në vlerësim. Disa karakteristika kyçe duhet të konsiderohen në këtë fazë:

- Shkalla hapësinore e pasojave. Shkallë gjeografike e dëmit që rezulton nga një ndikim mjedisor shpesh do të shtrihet në mënyrë të konsiderueshme përtej kufijve të burimit të rrezikut. E rëndësishme është që vlerësimi i rrezikut të mos jetë shumë i kufizuar në këtë drejtim.

- Shkalla e përkohshme e pasojave. Është e rëndësishme për t'u marrë parasysh kohëzgjatja e një ndikimi se si mund të shkaktojë dëme që do të zgjasin gjatë në të ardhmen. Për shembull, pasojat e mundshme të një derdhjeje të madhe të naftës që prek plazhet mund të kenë ndikime afatgjata në industrinë e turizmit në zonë; një derdhje e një solventi në tokë të depërtueshme mund të rezultojë në një ndikim në shtresat ujëmbajtëse për shumë vjet më vonë.

Për vlerësime sasiore/kuantitative, modelimi i fuqishëm dhe afatgjatë, duke përdorur mjete të ngjashme me ato të përdorura në parashikimin e ndikimit konvencional, mund të përdoret për të parashikuar dhe përcaktuar shkallën kohore dhe shtrirjen e ndikimit mjedisor.

#### *Vlerësimi i probabilitetit të pasojave*

Qëllimi i këtij hapi është që të vlerësojë mundësinë e pasojave që/dhe përbëhet nga tre komponentë: probabilitetin e të ndodhurit të incidentit të rrezikshëm, probabilitetin e

receptorëve të ekspozuar ndaj rrezikut dhe probabilitetin e dëmit që rezulton nga ekspozimi ndaj rrezikut.

Varur nga rrethanat e incidentit të rrezikshëm, caktimi i probabiliteteve mund të jetë relativisht i drejtpërdrejtë ose mund të kërkojë një qasje më të sofistikuar. Për shembull, në një nivel të shqyrtimit, mund të jetë e mjaftueshme të gradosh probabilitetin me shkallën 1 - 5 mbi bazën e eksperiencës së ekspertëve. Në situata të tjera mund të jetë e nevojshme që të caktohet një shpërndarje probabiliteti në krahasim me një vlerë diskrete me ngjarjen në fjalë. Për shembull, probabiliteti i dëmit njerëzor për shkak të marrjes së një ndotësi kancerogjen të tokës do të varet nga niveli i ndotjes së tokës dhe sasisë së konsumuar të tokës dhe të pasurit të paqartësive ose ndryshueshmërisë në këto vlera. Simulimi mund të përdoret për të përcaktuar probabilitetin e ndikimit, shiko shtojcën 5. Një metodë për përcaktimin dhe paraqitjen e probabilitetit të ekspozimit të receptorëve në një derdhje të naftës është ilustruar në shembullin e mëposhtëm.

Përcaktimi i probabilitetit të ekspozimit të receptorëve për një derdhje naftë

Probabiliteti i ekspozimit të çdo burimi të identifikuar (p.sh., zonës së folesë se zogjve, akomodimeve turistike etj.) llogaritet duke shumëzuar probabilitetin e sipërfaqes me naftë për vendndodhjen përkatëse nga probabiliteti i Derdhjes së naftës për çdo skenar, dhe pastaj duke përmbledhur rezultatet për secilin burim të të gjithë skenarëve.

$$PE = \sum (P_{ex} P_s)_n$$

Ku

PE = Probabiliteti i përgjithshëm i ekspozimit

Pe = Probabiliteti i sipërfaqes me naftë nën skenarin n

Ps = Probabiliteti i një derdhjeje që arrin një burim për skenarin n

Gjykimi ekspert duhet të përdoret për të vlerësuar se në cilin zarf probabiliteti të burimeve të lëvizshme/mobile duhet të vendosen. Gjykimi duhet të jetë konservator për të siguruar se janë të mbuluara skenarët e rastit më të keq. Kjo do të thotë se burimi zakonisht vlerësohet duke u vendosur në probabilitetin e ekspozimit përmes të cilit ai kalon. Një shembull i përfundimit nga ky hap është treguar më poshtë.



#### Hapi 4: Përcaktimi i rrezikut

Pasi probabiliteti dhe shkalla e pasojave që lindin si pasojë e incidentit të rrezikshëm janë përcaktuar, është e rëndësishme që të jenë të vendosur në kontekst (vlerësuar). Kjo fazë zakonisht përfshin përdorimin e gjykimit për të caktuar rëndësinë e rreziqeve të mundshme, zakonisht përmes referimit ndaj një matje paraekzistuese, standardi ose pragu.

Faktorët në vijim duhet të merren parasysh kur të përcaktuar nëse një rrezik është i rëndësishëm:

- Gjasat (probabiliteti dhe/ose frekuenca) e shfaqjes së ndikimit;
- Ashpërsia e ndikimit në drejtim të, p.sh.:
- Mjedisit, p.sh., shtrirja gjeografike, kthyeshmëria;
- Shëndetit dhe sigurisë: p.sh., ashpërsia e lëndimeve; numri i lëndimeve;
- Implikimet publike p.sh.: dëmtimi i imazhit publik dhe reputacionit, humbje e besimit të të interesuarve; penalizimet rregullatore.

Vlerësimi i rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore të njeriut si pasojë e projekteve të reja është bërë zakonisht duke përdorur një ndikim apo analiza të pasojave të rangut apo sistemit të shqyrtimit i cili konsideron gjasat e shfaqjes dhe rreptësinë e ndikimit.

#### Hapi 5: Vlerësimi dhe masat zbutëse

Kjo fazë e procesit përfshin vlerësimin e pranueshmërisë ose tolerancës së rreziqeve të identifikuar, dhe ku rreziqet nuk janë të pranueshme identifikimin e masave të duhura zbutëse.

Në thelb, teoria e tolerancës së rrezikut është bazuar në faktin e thjeshtë se rreziku është toleruar në proporcion me përfitimet e ardhura. Kurdo që bëhet diçka që përfshin marrjen e një rreziku - edhe kur shkelet jashtë një trotuari kur ka trafik - zakonisht bëjmë kështu, sepse në besojmë se në mund të shohim disa dobi që kompensojnë atë (rrezikun). Në përgjithësi është perceptuar se ekspozimi vullnetar ndaj rrezikut është më shumë i tolerueshëm se ekspozimi i pavullnetshëm. Kur në zgjedhin për t'i dhënë një makinë në një autostradë, në jemi të ekspozuar ndaj rrezikut të vdekjes në një aksident me probabiliteti 1 në 10.000 në vit. Megjithatë, ne nuk jemi të përgatitur për të toleruar këtë nivel të rrezikut të vdekjes për shkak të një aksidenti në një fabrikë kimike, pranë vendit ku jetojmë, sepse rreziku është i pavullnetshëm; sepse

është i imponuar mbi ne.

Objektivi themelor në reduktimin e rreziqeve është për t'i bërë ato "sa më të ulët që është e mundur". Një nivel maksimal i lejueshëm është përcaktuar si kriter më sipër mbi të cilin rreziku konsiderohet i patolerueshëm, sido që të jenë përfitimet, dhe si i tillë duhet të reduktohet. Nën këtë nivel, rreziqet duhet të bëhen "sa më të ulët që është e mundur". Kur vendoset se çfarë masash reduktuese janë të arsyeshme praktikisht, mund të merret parasysh kostoja dhe përfitimi prej masave të marra - nga rreziqet më të larta, sa më i lartë të jetë rreziku aq më frytdhënëse është për të shpenzuar në to për të ulur rrezikun.

#### Nivelet e rrezikut dhe ALARP

Parimet ALARP të reduktimit të rrezikut janë zhvilluar në lidhje me rreziqet për jetën e njeriut, goftë në jetën e një individi të identifikuar (rrezikut individual) apo për njerëzit në përgjithësi (rrezikut shoqëror). Kur parimi ALARP është aplikuar ndaj rreziqeve mjedisore p.sh., të ekosistemeve ose karakteristikave historike, është e rëndësishme të kuptohet origjina e vlerave të patolerueshme dhe të pranueshme të rrezikut. Një rrezik vjetor një në një milion është gjerësisht i njëjtë si ai e mungesës së energjisë në shtëpi, ose vdekjes nga rrezatimi. Kufiri i ulët i tolerancës për këtë arsye mund të barazohet me nivelin e 'rreziqeve natyrore' që shumica e njerëzve përjetojnë në jetën e përditshme. Prandaj rreziqet që lidhen me projektin mund të vendosen në atë kontekst, duke iu referuar niveleve të rrezikut të përditshëm.

Nëse është e përshtatshme për projektin e vlerësuar, kriteri i pranueshmërisë mund të zhvillohet duke përdorur ALARP të derivuar nga vlerat individuale dhe sociale të rrezikut, dhe i përdorur për të vlerësuar rreziqet në terma të tolerancës dhe masave të përshtatshme zbutëse.

#### SHTOJCA 5 – MENAXHIMI I PASIGURIVE NË VNM

##### MESAZHET KRYESORE

1. Dy lloje pasigurish mund të nevojiten të adresohen në VNM: pasiguritë që lindin në parashikimin e ndikimeve dhe pasiguritë mbi ngjarjet e jashtëzakonshme që lidhen me projektin (aksidentet dhe rreziqet natyrore).

2. Procesi i parashikimit përbëhet nga një numër fazash, përfshirë dhe vendimin mbi çështjen se si të përshkruhet një ndikim, mbledhja e të dhënave, në lidhje me projektin dhe mjedisin, si dhe përzgjedhja



e aplikimi i metodës së parashikimit. Pasiguria mund të shfaqet te secila nga këto faza.

3. Menaxhimin i pasigurisë në parashikim duhet të përfshijë: i) vlerësimin dhe qartësimin e nivelit të pasigurisë; dhe ii) reduktimin e pasigurisë në një nivel të pranueshëm për vendimmarrjen, duke përdorur mjetet e duhura.

4. E rëndësishme është të mos përpiqemi të mbledhim më shumë të dhëna ose të përdorim një metodë që është më e saktë se sa është e nevojshme për të bërë një parashikim më adekuat. Parashikimi “Adekuat” është i tillë që lejon vlerësimin gjykues të bëhet në lidhje me rëndësinë dhe i jep vendimmarrësit dhe palëve të tjera të përfshira në proces informacion të mjaftueshëm për të bërë gjykimet e tyre.

5. Metodatat duhet të jenë gjithmonë sa më të thjeshta të jetë e mundur. Të mos përdoret metoda që është më komplekse, e kushtueshme dhe që humb kohë, me shumë se sa është e nevojshme në parashikimin e arsyeshëm të ndikimit.

#### HYRJE

Kjo shtojcë diskuton rëndësinë e shqyrtimit të pasigurisë në VNM. Pasiguria është e rëndësishme pasi mund të ndikojë cilësinë e informacionit disponibël në vendimmarrje. Ka dy mënyra kryesore në të cilat pasiguria është relevante në VNM:

- Pasiguria në parashikimin e ndikimeve. Parashikimet, nga natyra janë të pasigurta pasi kanë të bëjnë me të ardhmen. Pasiguria është e lidhur kryesisht me mungesën e dijeve se si do të sillen në të ardhmen projekti dhe mjedisi. Për shembull, efekti i shkarkimeve të projektit në cilësinë e ajrit do të varet në mënyrë vendimtare nga pozicioni i saktë, forca e shkarkimit, temperatura dhe përbërja e shkarkimeve, si dhe kushtet e ardhme të motit dhe të gjitha këto janë të paqarta. Por pasiguria/paqartësia mund të rritet edhe sepse dija jonë rreth mjedisit bazë bazohet vetëm në mostrat/modelet, si dhe metodat që përdoren për të parashikuar ndikimet (modelet etj.) janë gjithmonë thjeshtime të atyre që ndodhin në botë. Gjithashtu, mund të ketë gabime në të dhëna dhe në aplikimin e metodave por me shpresë që këto mund të shmangen me ndihmën e kontrolleve të kujdesshme dhe të detajuara.

- Pasiguri rreth ekzistencës së “ngjarje të jashtëzakonshme” gjatë zbatimit të projektit;

- Rreziqe të paparashikuara mund të shkaktojnë rreziqe në jetën e njerëzve dhe mjedis;

- Nga keqfunksionimi i fabrikave dhe pajisjeve që marrin pjesë në projekt dhe shkaktojnë aksidente si zjarr, shpërthime dhe rrjedhje të ndryshme; ose

- Nga rreziqe natyrore, si përmbytje dhe paqëndrueshmëria e tokës.

#### PASIGURIA NË PARASHIKIMIN E NDIKIMEVE

Procesi i parashikimit përbëhet nga një numër fazash, përfshirë vendimin se si të përshkruash ndikimet, mbledhjen e të dhënave lidhur me projektin dhe mjedisin, dhe selektimin dhe aplikimin e metodës së parashikimit. Pasiguria mund të shfaqet te secila nga këto faza.

##### *Përsëritimi i ndikimit*

Ka një sërë kriteresh për marrjen e vendimit se si të përshkruhet një ndikim. Këto përfshijnë:

- natyrën e ndikimit në vetvete, p.sh., vendndodhjen dhe shtrirjen, kohën dhe karakteristikat të tjera të lidhura me të;

- llojin e standardeve ose kriteret të tjera kundrejt të cilëve do të vlerësohen parashikimet;

- aftësia dhe mundësia e metodave për të bërë lloje të ndryshme parashikimesh (mesatare /amplituda maksimale, afatshkurtra/gjata, afër/larg etj.).

Vendimi për përsëritimin e ndikimit duke përdorur një masë se sa atë që mund të çojë në një përfundim të ndryshëm rreth ndikimit. Për shembull, përqendrimi ndotës vjetor mesatar i parashikuar mund të jetë brenda limitit ligjor, por përqendrimi maksimal mund të jetë i mjaftueshëm për të shkaktuar një dëm të rëndësishëm. Falë kësaj, do të ketë gjithmonë një shkallë pasigurie nëse mënyra se si është përshkruar një ndikim, ka ndikuar në vendimin rreth rëndësisë së tij.

##### *Mbledhja e të dhënave*

Do të ketë gjithmonë pasiguri në të dhënat që duhen për të bërë parashikimet. Këto mund të jenë të dhëna rreth vetë aktivitetit; për shembull, sa mbetje do të depozitohen në një vendndodhje të propozuar? Cila është përbërja e tij kimike? Mund të lidhet edhe me mjedisin bazë që ndikohet: sa është popullata lokale e specieve të ndikuara. Cilin proporcion të popullatës kombëtare rajonale përfshin? Çfarë kanalesh bëjnë të mundur shpërhapjen e ndotësve? Cilat janë kushtet lokale të shpërhapjes në ajër, tokë dhe ujë? Sa njerëz jetojnë



në vendndodhjen e projektit?

Të dhënat janë subjekt i dy lloj pasigurish:

- Pasaktësia në matje dhe zgjedhjen e mostrave – saktësia e instrumenteve, teknika dhe përdoruesi si dhe frekuenca e matjeve shkalla e modelit të zgjedhur;

- Ndryshueshmëria natyrale dhe e pashmangshme në mjedis, p.sh., kushtet mesatare të motit do të ndryshojnë gjatë një viti dhe ndër vite; nivelet e prurjes së lumit lagështia e tokës ndryshojnë në kohë, po ashtu popullimet dhe riprodhimi i specieve; përbërja e ndryshme gjenetike e individëve në një popullim mikroorganizmash do të rezultojë në një ndryshueshmëri të reagimit të tyre ndaj ndotjes së tokës.

#### *Selektimi dhe aplikimi i metodës së parashikimit*

Të gjitha metodat parashikuese, kur përdorin modele shkencore ose gjykime ekspertësh, përfshijnë disa modele të mjedisit: matematike, fizike, eksperimentale ose konceptuale (verbale/mendore). Pasiguritë ndodhin sepse asnjë nga këto modele nuk mund të parashikojë se çfarë do të ndodhë në mjedisin e vërtetë. Modeli është vetëm një përafërsi e botës reale dhe përfundimet nuk mund të japin një përshkrim të saktë dhe preciz të asaj që mund të ndodhë.

Qasjet për menaxhimin e pasigurisë në parashikim

Menaxhimi i pasigurisë në parashikim ka dy përbërës: vlerësimin dhe specifikimin e saktë i nivelit të pasigurisë, dhe reduktimin e pasigurisë në një nivel të tillë që është i pranueshëm për vendim-marrje.

#### *Vendosja e nivelit të pasigurisë*

Ku është e mundur, supozimet në bazë të parashikimit të ndikimeve, dhe besueshmëria në parashikim duhet të specifikohet qartë. Aty ku është një nivel i konsiderueshëm i pasigurisë, parashikimet duhet të shprehen gjithmonë si shkallë ose cilësore (p.sh., nga më i ulëti të më i larti dhe vlerat më të mundshme) ose statistikisht (p.sh., 95% limitit/nivelit të besueshmërisë). Për shembull, analizat statistike mund të tregojnë që 95% e intervalit të besueshmërisë për zhurmat lidhur me një projekt industrial të jenë 65-70dBA. Kjo do të thotë se ka një probabilitet rreth 95% që zhurmat aktuale të jenë brenda këtyre normave. Ka disa metoda të ndryshme statistike që mund të përcaktojnë nivelin e pasigurisë në parashikime dhe

është e përshtatshme të përdoren këto atje ku ka pasiguri të konsiderueshme.

Analiza e Monte Karlos është një teknikë simuluese kompjuterike që mund të aplikohet në çdo sistem që përdor variable të pasigurt. Simulimi heton pasojat e këtyre pasigurive në produktin final duke përdorur analizën e probabiliteteve duke ndryshuar çdo variabël në pajtim me shpërndarjen e kufijtë e pasigurisë së tyre (p.sh., prurja mesatare e rrjedhjes mund të shpërndahet normalisht rreth 1.6 m<sup>3</sup>/orë por nuk mund të jetë më ulët se 1.2 m<sup>3</sup>/orë dhe jo më lartë se 2 m<sup>3</sup>/orë). Realizohet përsëritja e shumë e llogaritjeve duke përdorur variable inputi të zgjedhura rastësisht në shpërndarjen e tyre dhe rezultatet përfundimtare regjistrohen. Ky proces mund të përsëritet qindra ose mijëra herë me qëllim përgatitjen e një historigramë të rezultateve. Historigrama tregon shpërndarjen totale e rezultateve të mundshme dhe një tregues të për mundësinë e përfuturit të rezultateve më të mira, më të dobëta dhe më të shpeshta.

#### *Reduktimi i nivelit të pasigurisë*

Pasiguria mund të reduktohet duke përmirësuar cilësinë e të dhënave të futura, duke rritur numrin e kampioneve të studiuar, duke përdorur metoda matëse më të përshtatshme, ose duke përdorur metoda parashikimi si një model më të sofistikuar. Është e rëndësishme, sidoqoftë, të mos mbliidhen më shumë të dhëna ose të përdoren metoda që janë më efektive se ç'është për të bërë një parashikim adekuat. Parashikimi "Adekuat" është i tillë që lejon që vlerësimi gjykues të bëhet në lidhje me rëndësinë që ka dhe i jep vendim-marrësit dhe aktorëve të tjerë informacion të mjaftueshëm për të bërë gjykimet e tyre. Një sasi e madhe kohe dhe parash shpesh shpërdorohet në VNM, për të mbledhur sasi të mëdha të të dhënave dhe duke përdorur mjete shumë të sofistikuar, kur një metoda më e thjeshtë dhe një përshkrim përsëri i thjeshtë i ndikimeve mund të jetë shumë më i përshtatshëm. Për disa vlerësime qasjet cilësore janë të përshtatshme, për shembull duke i kërkuar një ekspert ose duke u bazuar në përvojën e dikujt tjetër, dhe në këto raste pasiguria mund të menaxhohet duke u kontrolluar me një ekspert tjetër ose duke përdorur më shumë se një krahasim. Reduktimi i pasigurisë në këto raste është më shumë një rast i "sensit të përbashkët" sesa një metodologji komplekse:



Kur përvoja e mëparshme është përdorur për të parashikuar efektet e mundshme të një zhvillimi të propozuar, vlerësuesi duhet të sigurojë që vendndodhja tjetër ose aktiviteti është i arsyeshëm, krahasuar me propozimin aktual në aspektin e hartimit të projektit dhe mjedisit. Nëse ekzistojnë dallime, ato duhet të merren në konsideratë gjatë interpretimit të ndikimit të parashikuar.

Nëse përdoret gjykimi i ekspertit, eksperti i zgjedhur duhet të jetë sa më i paanshëm që të jetë e mundur. Nëse paragjykimi ose polemika është e pashmangshme, duhen nxjerrë vëzhgime nga ekspertët e tjerë dhe çdo ndryshim në opinionin e të shprehet qartë për vendim-marrësit.

#### *Analiza e ndjeshmërisë*

Aty ku ka pasiguri, analiza e ndjeshmërisë mund të jetë një mjet i dobishëm. Analiza formale e ndjeshmërisë është një metodë analitike e përdorur për të vlerësuar qëndrueshmërinë e marrëdhënieve mes variablave: në terma të thjeshtë, sa do të rritet X nëse rritet Y? Një faktor i quajtur derivat i pjesshëm që llogaritet për çdo të dhënë është i njohur si koeficient i ndjeshmërisë. Të dhënat me koeficientin më të lartë të ndjeshmërisë kanë ndikimin më të madh mbi pasigurinë në rezultate.

Në formën më të thjeshtë të analizës së ndjeshmërisë bëhet pyetja “Nëse” Çfarë do të ndodhë me ndikimin e cilësisë së ajrit nëse kushtet e motit bëhen progresivisht më të ngrohta me kalimin e kohës?”, “Çfarë do të ndodhë me peshkimin në qoftë se zhvillime të ndryshme në rrjedhën e sipërme kanë shkaktuar që niveli i lumit

të bjerë?”, “Çfarë do të ndodhë me gjenerimin e mbetjeve në fabrikë nëse rritet prodhimi?”. Kjo lloj analize mund të përdoret për të provuar se si mund të ndryshojnë rezultati sipas skenarëve të ndryshëm të ardhshëm dhe sa i ndjeshëm është ndikimi në pasigurinë e të ardhmes. Nëse rezultati është shumë i ndjeshëm, atëherë mund të jetë e nevojshme që të punohet shumë më tej për të reduktuar pasigurinë ose të imponohen kufizime në projekt për të parandaluar ndikimin që të bëhet shumë i lartë, p.sh., duke imponuar kushte të lejueshme për kufizimin e niveleve të prodhimit. Teknika lejon burimet të fokusohen në variablat kryesorë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në pasigurinë, në mënyrë që pasiguria e përgjithshme e rezultatit përfundimtar të zvogëlohet. Metoda gjithashtu promovon një kuptim më të mirë të punimeve të sistemit dhe rëndësinë e variablave që nxjerrin rezultatin.

#### SHTOJCA 6

#### FLETË SHOQËRUESE PËR APLIKIMET PËR DEKLARATË MJEDISORE

#### 1. KËRKESA SPECIFIKE NË RAST TË VNM SË THELLUAR

##### 1.1 Çështje që duhet të adresohen në VNM-në e thelluar

Ju lutemi konfirmoni në tabelën e mëposhtme çështjet respektive që adresohen në VNM e thelluar dhe tregoni vendndodhjen në raportin e thelluar të VNM (kapitull, faqe, shtojcë).

| ÇËSHTJET RESPEKTIVE QË DUHEN ADRESUAR                                                                                                                                                                                                                                                                   | PO | JO |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|----|
| Kërkesat e saj, të institucioneve, publikut dhe OJF të cilat duhet të merren parasysh dhe trajtohen në raportin e thelluar të VNM                                                                                                                                                                       |    |    |
| Një sqarim të përmblodhur për kërkesat e procedurës së thelluar të VNM, deri në paraqitjen e aplikimit dhe dhënien e deklaratës mjedisore                                                                                                                                                               |    |    |
| Detyrimin për informimin, konsultimin dhe dëgjuesën me publikun dhe OJF të raportit të thelluar të VNM dhe konsiderimin e mendimeve të dhëna në raportin                                                                                                                                                |    |    |
| Analizimin e alternativave të mundshme për zbatimin e projektit                                                                                                                                                                                                                                         |    |    |
| Udhëzime për studimet dhe metodat për sigurimin e informacionit mjedisor dhe parashikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM                                                                                                                                           |    |    |
| Udhëzime për masat për mbrojtjen e mjedisit që duhet të merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM                                                                                                                                                                             |    |    |
| Strukturën dhe renditjen e informacionit në raportin e thelluar të VNM, në përputhje me VKM në fuqi “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore” |    |    |
| Faktin që projekti është subjekt i procedurës ndërkufitare të VNM-së duke dhënë edhe udhëzimet përkatëse për këtë rast                                                                                                                                                                                  |    |    |



1.2 Dokumentet që duhet të paraqiten së bashku me kërkesën për t'u pajisur me deklaratë mjedisore (në rast të VNM të thelluar)

|                                                                                                                                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ekstrakti i QKR                                                                                                                   |
| Raporti i thelluar i VNM, i cili duhet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi                                           |
| Përmbledhje joteknike e raportit të VNM                                                                                           |
| Projekti Teknik                                                                                                                   |
| Informacion për informimin dhe konsultimin me publikun dhe palët e tjera, realizuar gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM |
| Një kopje e faturës së pagesës së tarifës së shërbimit sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës                              |

Firma e zhvilluesit.....

### URDHËR

Nr. 577, datë 4.11.2015

### PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PRANIMIN NË DETYRË TË NËPUNËSIT TË ZYRËS SË GJENDJES CIVILE NË BASHKI

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të germës “b” dhe “P”, të nenit 65 dhe të pikës 2, të nenit 68, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

#### URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Për pranimin në detyrë të nëpunësit të zyrës së gjendjes civile në bashki”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Emërimi i nëpunësve të zyrave të gjendjes civile në bashki, bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Kjo rregullore do të zbatohet për të gjithë nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki, që do të pranohen pas miratimit të saj, si dhe për ata që janë komanduar dhe nuk kanë kryer procedurat e testimit sipas rregullores së miratuar me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 1366, datë 19.08.2006, “Për miratimin e rregullores për pranimin në detyrë të punonjësit të zyrës së gjendjes civile”.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të kryejë evidentimin e rasteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij urdhri, dhe në bashkëpunim me kryetarët e bashkive, të fillojë procedurën e emërimit sipas kësaj rregulloreje.

5. Urdhri i ministrit të Brendshëm nr. 1366, datë 19.08.2006, “Për miratimin e rregullores për pranimin në detyrë të punonjësit të zyrës së gjendjes civile”, revokohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, prefektët e qarqeve dhe kryetarët e bashkive.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletore Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME  
Saimir Tahiri

### RREGULLORE

### PËR PRANIMIN NË DETYRË TË NËPUNËSIT TË ZYRËS SË GJENDJES CIVILE NË BASHKI

#### KREU I

#### PROCEDURA PËR HAPJEN E KONKURRIMIT

1. Pranimi në detyrën e nëpunësit të zyrës së gjendjes civile në bashki, bëhet vetëm nëpërmjet procedurës së konkurrimit të kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, në bashkëpunim me kryetarët e bashkive.

2. Në rastet e krijimit të vendit të lirë të punës në zyrën e gjendjes civile, kryetari i bashkisë komandon në këtë detyrë përkohësisht një nëpunës, kriteret profesionale të të cilit nuk janë në kundërshtim me këtë rregullore.

3. Kryetari i bashkisë paraqet në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile menjëherë njoftimin për krijimin e vendit të lirë dhe kërkesën me shkrim për plotësimin e tij, duke komanduar njëkohësisht një nëpunës të përkohshëm, pas miratimit, sipas pikës 4. Njoftimi dhe kërkesa duhet të shoqërohet me shpjegimin e shkaqeve të krijimit të vendit të lirë dhe me dokumentacionin përkatës për kandidatin e komanduar.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pasi merr në shqyrtim kërkesën e bërë nga kryetari i bashkisë, konfirmon me shkrim kërkuesit, nëse njoftimi dhe kërkesa janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore.



5. Drejtori i Përgjithshëm, bashkë me konfirmimin sipas pikës 4, përcakton vendin, datën dhe orën e testimi, e cila nuk duhet të jetë më vonë se 3 (tre) muaj nga data e daljes së konfirmimit.

6. Pas marrjes së konfirmimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, kryetari i bashkisë bën shpallje publike për pozicionin e lirë të vendit të punës, në vende me hyrje të lirë për publikun, në faqen e internetit të bashkisë dhe në mediat lokale. Ky njoftim duhet të zgjasë deri në 7 ditë para datës së zhvillimit të testimi.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile vendos për zhvillimin e testimi, në rast se plotësohet minimumi i mundshëm, prej 3 (tre) konkurrentësh për një vend pune.

8. Në rast të mosplotësimit të një prej pikave të procedurës së hapjes së konkurimit, do të caktohet një datë e re testi.

9. Në rast të moszhvillimit të testimi pas dy shpalljeve, procedura rifillon nga e para.

## KREU II

### KRITERET E PRANIMIT NË DETYRË PËR NËPUNËSIN E ZYRËS SË GJENDJES CIVILE NË BASHKI

Për pranimin në detyrën e nëpunësit të zyrës së gjendjes civile në bashki, kandidati duhet të plotësojë këto kriterë:

1. të jetë shtetas shqiptar;
2. të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të ketë arsimin e lartë;
4. të ketë njohuri të mira të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8951, datë 10.10.2002, “Për numrin e identitetit të shtetasve”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për dokumentin e identitetit të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9062, datë 8.5.2003, “Kodi i Familjes”; të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”; të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; të ligjit “Për prefektin”, si dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të ligjeve të sipërcituara;
5. të mos ketë qenë i dënuar me vendim gjykatë të formës së prerë;
6. të ketë njohuritë bazë të punës në kompjuter;
7. të mos ketë lidhje gjaku deri në radhë të dytë me kryetarin e bashkisë;
8. të ketë aftësi të mira komunikuese.

## KREU III

### PARAQITJA E DOKUMENTEVE TË KONKURRENTËVE

1. Dokumentet do të dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile nga bashkia, ku i interesuari ka bërë kërkesën ose nga vetë i interesuari, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë, para datës së zhvillimit të testimi. Dokumentet që nuk dorëzohen brenda këtij afati, nuk pranohen.

2. Dokumentet që do të paraqiten janë:

- a) kërkesë personale për pozicionin e vendit të punës;
- b) CV (Curriculum Vitae);
- c) diplomë e shkollës së lartë (fotokopje e notuar);
- d) dëshmi penaliteti e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë, e cila duhet nxjerrë jo më parë se tre muaj nga data e zhvillimit të testimi;
- e) certifikatë e njohurive bazë për përdorimin e kompjuterit;
- f) fotokopje e letërnjoftimit;
- g) fotokopje e Librezës së Punës, nëse ka qenë më parë në marrëdhënie pune.

3. Mungesa e njërit prej dokumenteve të mësipërme apo pavlefshmëria e dokumenteve, sjell skualifikimin e konkurrentit.

## KREU IV

### TESTIMI

1. Hartimi i tezave

a) Komisioni i hartimit të tezave është i përbërë nga dy anëtarë, të cilët gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm.

b) Komisioni harton tri teza testi të sekretuara. Secila tezë në total ka 100 pikë.

c) Teza ka në përbërje pyetje nga baza ligjore e shërbimit të gjendjes civile. Pas hartimit të tezës, secila prej tyre mbyllet në zarf dhe i jepet Drejtorit të Përgjithshëm, i cili ia kalon komisionit të vlerësimit.

d) Në çdo rast, specialisti që harton tezën e testimi nuk mund të jetë anëtar i komisionit të vlerësimit.

2. Zhvillimi i testimi

a) Komisioni i vlerësimit është i përbërë nga 3 anëtarë, të cilët përcaktohen me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm, pas kërkesës /propozimit të bërë nga Drejtori i Përgjithshëm.





b) Secili nga konkurrentët merr nga komisioni i vlerësimit fletë të nevojshme për zhvillimin e tezës. Në fletën e parë, e cila me fillimin e testimi sekretohet, vendoset emri dhe mbiemri i konkurrentit, njësia e qeverisjes vendore dhe data e zhvillimit të testimi. Vendosja e shenjave të veçanta në tezë, çon në skualifikimin e konkurrentit.

c) Me mbarimin e testimi të të gjithë konkurrentëve, bëhet korrigjimi i testit nga komisioni i vlerësimit.

d) Korrigjimi duhet të kryhet brenda tri ditëve nga dita e zhvillimit të testimi. Pas përfundimit të korrigjimit, hartohet menjëherë procesverbal i vlerësimit të tezave, për çdo vend pune të veçantë.

e) Pas përfundimit të të gjithë procedurës, procesverbal i hartohet në tri kopje, nga të cilat një kopje, së bashku me shkresën përcjellëse i dërgohet nga Drejtori i Përgjithshëm, kryetarit të bashkisë që ka bërë kërkesën, një kopje dërgohet në protokollin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe kopja e tretë mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila i bashkëlidhet praktikës së konkurrentit fitues.

#### KREU V ANKIMIMI

1. Çdo konkurrent mund të bëjë ankim me shkrim, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Gjendjes Civile, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes së rezultateve, në faqen elektronike të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të bashkisë.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile pasi shqyrton ankimin, kthen përgjigje brenda 10 ditëve, nga data e marrjes së ankimit.

3. Në rast se konstatohet shkelje në zbatimin e procedurave, Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, propozon përsëritjen e procedurave të testimi.

4. Përgjigja e Drejtorit të Përgjithshëm ankimohet brenda 3 ditëve nga marrja e saj, te Sekretari i Përgjithshëm, i cili kthen përgjigje brenda 10 ditëve. Kjo përgjigje është përfundimtare administrativisht.

#### KREU VI PROCEDURA E EMËRIMIT

1. Kryetari i bashkisë, pas njoftimit të marrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Gjendjes Civile, zgjedh ndërmjet dy konkurrentëve të cilët radhiten të parët

dhe që janë vlerësuar mbi 50 pikë, në procesverbalin e hartuar nga komisioni i vlerësimit. Me përcaktimin e fituesit, kryetari i bashkisë, në mbështetje të pikës 2, të nenit 68, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, harton aktin e emërimit të nëpunësit të zyrës së gjendjes civile.

2. Një kopje e aktit të emërimit nga kryetari i bashkisë, i dërgohet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, së bashku me specimenet përkatëse të nëpunësit të emëruar, ku përfshihet: nënshkrimi i tij, vula zyrtare dhe formulari tip me një fotografi. Një kopje e aktit i dërgohet edhe prefektit të qarkut.

#### VENDIM

**Nr. 129, datë 31.10.2015**

#### **MBI DISA NDRYSHIME NË RREGULLAT PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR**

Bazuar në neni 38 pika 2, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me ligjin nr. 9051, datë 3.4.2006, vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC, si dhe në përputhje me direktivën 2009/73-EC dhe rregulloren EC nr. 715/2009, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga grupi i punës për disa ndryshime në rregullat e certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të gazit natyror,

#### VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregullat për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Gazit Natyror (bashkëlidhur rregullat me ndryshimet sipas këtij vendimi).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S  
Petrit Ahmeti**



TEKSTI ME NDRYSHIMET NË  
RREGULLAT PËR CERTIFIKIMIN E  
OPERATORIT TË SISTEMIT TË  
TRANSMETIMIT PËR GAZIN NATYROR

Në nenin 1, “Autoriteti”, fjalët: “nenit 9 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008” janë zëvendësuar me fjalët: “nenit 37 të ligjit nr. 102/2015”.

Në nenin 4 “Zbatimi dhe interpretimi i rregullores”, në pikën 2, pas fjalëve “Rregullorja duhet të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me...” janë shtuar fjalët “Ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror””.

Në nenin 5 “Përkufizimet”, fjalët “këtë rregullore” janë zëvendësuar me “nenin 4 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror””.

Në nenin 5, pika 2, pas fjalëve “i cili funksionon në përputhje me ligjin” janë shtuar fjalët “për sektorin”.

Në nenin 5, pika 4, në fund të fjalisë janë shtuar fjalët: “si dhe për garantimin e mundësive afatgjata të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për transportin e gazit...”

Në nenin 6 “Detyrimet për certifikimin” në pikën 1 fjalët “Ligjin për gazin natyror” janë zëvendësuar me fjalët “në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”.

Në nenin 6, pika 2, pas fjalës “Ligjin” janë shtuar fjalët “nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit””.

Në nenin 10 “Procedurat që aplikohen për certifikim”, në pikën 1 fjalët “në procedurat e vendosura në këtë rregullore” janë zëvendësuar me fjalët: “në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe”.

Në nenin 11 “Vendimi për certifikimin” në pikën 1, fjalët “nga data e marrjes së aplikimit dhe paraqitjes siç duhet të të gjitha dokumenteve të dhënave dhe informacionit” janë zëvendësuar me fjalët “nga data e aplikimit dhe dorëzimit të të gjithë dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar nga OST-ja”.

Në nenin 11 pika 2 fjalët “I dhënë bazuar në vendimin e nënkuptuar nga ERE” zëvendësohen me fjalët “jepet i miratuar në heshtje nga ERE”.

Në nenin 11, pika 6, është riformuluar: “Nëse vendimi i ERES-s është i ndryshëm nga rekomandimet e Sekretariatit, ERE duhet të publikojë dhe të arsyetojë shkaqet e mospranimit të tyre, duke informuar Sekretariatin për këtë vendim”.

Në nenin 12 “Certifikimi në lidhje me vendet e treta”, fjalët “Neni 8 i Rregullores, duke marrë në konsideratë kërkesat e veçanta të përcaktuara në këtë rregullore” janë zëvendësuar me fjalët “Neni 40 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror””.

Në nenin 13 “Rihapja e procedurës së certifikimit” në pikën 1 fjalët “të saj” janë zëvendësuar me fjalët “që i njeh ligji 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror””.

**VENDIM**

**Nr. 131, datë 31.10.2015**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË  
ANKANDIT TË ZYRËS SË KOORDINUAR  
TË ANKANDEVE PËR EVROPËN  
JUGLINDORE (SEE CAO), VERSIONI 1.2**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 25 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, si dhe rekomandimet nga Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 24.8.2015 dhe mbledhjes së 11-të të ECRB-së të vitit 2009 ku rekomandohet që rregullatorët kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionarë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO), versioni 1.2 dhe relacionin përkatës,

Konstatoi se:

- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian. Në cilësinë e vendit anëtar të ECRB-s rekomandohet që rregullatorët Kombëtarë anëtarë të saj, ta miratojnë këtë rregullore.

- Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 24.8.2015 dhe mbledhja 11-të e ECRB-së mbajtur më datë 9.7.2009, rekomandon që rregullatorët Kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregullat e ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO, versioni 1.2. (bashkëlidhur në gjuhën



originale angleze).

2. Vendimet nr. 156 datë 1.12.2014 dhe nr. 14, datë 11.2.2015, të bordit të ERE, shfuqizohen.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare në versionin zyrtar në gjuhën angleze dhe në faqen e ERE-s në gjuhën shqipe dhe angleze.

KRYETARI I ERE-S  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 132, datë 31.10.2015**

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR  
SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
RREGULLAVE TË ANKANDIT TË ZYRËS  
SË KOORDINUAR TË ANKANDEVE PËR  
EVROPËN JUGLINDORE (SEE CAO),  
VERSIONI 1.3.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 pika 1 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur dhe të rënë dakord nga (SEE CAO) dhe TSO-të aksionarë të saj, të Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO) dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullave të Ankandit të Zyrës së Koordinuar të Ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO).

konstatoi se:

- Sekretariati i Energjisë (Vjenë, Austri) datë 22.9.2015 dhe mbledhja 11-të e ECBR-së mbajtur më datë 9.7.2009, rekomandon që rregullatorët kombëtarë ta miratojnë këtë rregullore.

- Rregullorja është e hartuar në përputhje me kërkesat e rregullores (KE) 714/2009 të Parlamentit Evropian.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin dhe miratimin e rregullave të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Evropën Juglindore SEE CAO (bashkëlidhur draft “Rregullat e ankandit, versionin 1.3 në gjuhën origjinale angleze).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë personat e interesuar për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Petrit Ahmeti

**VENDIM**  
**Nr. 133, datë 31.10.2015**

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË  
RREGULLIMIT PËR VITIN 2015 PËR TË  
LICENCUARIT NË SEKTORIN E  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 17 pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 31.10.2015, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2015 për të licencuarit në sektorin e energjisë dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit mbështetur mbi të ardhurat vjetore që vijnë nga veprimtaria e licencuar,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesave të rregullimit për vitin 2015 sipas tabelës bashkëngjitur.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë të licencuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S  
Petrit Ahmeti



**TABELA E PAGESAVE TE RREGULLIMIT PER  
VITIN 2015 PER OPERATORET**

| Nr.      | Kompania                         | Pagesa e Rregullimit 2015 (leke) |
|----------|----------------------------------|----------------------------------|
| <b>I</b> | <b>Licensa per prodhim</b>       |                                  |
| 1        | "Albanian Green Energy" shpk     | 358,600.0                        |
| 2        | "Balkan Green Energy" shpk       | 573,200.0                        |
| 3        | "EMIKEL 2003" sh.p.k             | 40,400.0                         |
| 4        | "Amal" sh.p.k                    | 16,700.0                         |
| 5        | "Spahiu Gjanç" sh.p.k.           | 75,900.0                         |
| 6        | "Wonder power" sha               | 71,100.0                         |
| 7        | "Hec i Tervolit" shpk            | 423,600.0                        |
| 8        | "HIDROALBANIA Energji" shpk      | 185,500.0                        |
| 9        | "HEC Bishnica 1,2" shpk          | 133,100.0                        |
| 10       | "Dishnica Energy" shpk           | 6,200.0                          |
| 11       | "Elektro Lubonje" shpk           | 3,000.0                          |
| 12       | "Selca Energji" shpk             | 24,300.0                         |
| 13       | "Projeksion Energji" sh.a.       | 15,000.0                         |
| 14       | "Sarolli" sh.p.k                 | 15,000.0                         |
| 15       | "Juana" sh.p.k                   | 3,500.0                          |
| 16       | "WTS Energji" shpk               | 12,000.0                         |
| 17       | "Marjakaj" shpk                  | 15,000.0                         |
| 18       | "Maksi Elektrik" sh.p.k          | 9,400.0                          |
| 19       | "Favina 1" shpk                  | 115,700.0                        |
| 20       | "EN-KU" sh.p.k                   | 500.0                            |
| 21       | "Hidroinvest 1" shpk             | 264,800.0                        |
| 22       | "PURE ENERGY STEBLEVA" shpk      | 15,000.0                         |
| 23       | "Malido-Energji" shpk            | 40,800.0                         |
| 24       | "Termocentrali Vlore" sha        | 20,000.0                         |
| 25       | KESH sh.a.                       | 21,253,400.0                     |
| 26       | "Teodori 2003" shpk              | 15,000.0                         |
| 27       | "Energji Ashta" shpk             | 2,240,000.0                      |
| 28       | "Power Elektrik Slabinje" shpk   | 412,700.0                        |
| 29       | "C & S Construction Energy" shpk | 426,100.0                        |
| 30       | "Hydro Energy" shpk              | 141,600.0                        |
| 31       | "Wenerg" shpk                    | 187,800.0                        |
| 32       | "Koka & Ergi Energy Peshk" shpk  | 134,200.0                        |
| 33       | "Ansara Koncension" shpk         | 3,100.0                          |
| 34       | "Energy Plus" shpk               | 428,600.0                        |
| 35       | "Hec Vluse" shpk                 | 85,800.0                         |
| 36       | "Energy partners Al" shpk        | 210,100.0                        |
| 37       | "Hec Dunice" shpk                | 15,000.0                         |
| 38       | "Korkis 2009" shpk               | 2,700.0                          |
| 39       | "Ferar Energy" shpk              | 15,000.0                         |
| 40       | "Hec-i Dragoshtunje" shpk        | 15,000.0                         |
| 41       | "HP OSTROVICA" shpk              | 213,900.0                        |
| 42       | "Hidropower Elektrik" shpk       | 15,000.0                         |
| 43       | "DN & NAT Energy" shpk           | 18,000.0                         |
| 44       | "Selishte" shpk                  | 75,500.0                         |
| 45       | "Idro Energia Pulita" shpk       | 29,700.0                         |
| 46       | "Bekim Energjitik" shpk          | 42,600.0                         |
| 47       | "Euron Energy Group" shpk        | 1,530,700.0                      |
| 48       | "Erald Energjitik" shpk          | 18,000.0                         |
| 49       | "ERMA MP" shpk                   | 43,600.0                         |



|     |                                   |                   |
|-----|-----------------------------------|-------------------|
| 50  | "Dosku Energy" shpk               | 33,000.0          |
| 51  | "DITEKO" shpk                     | 15,000.0          |
| 52  | "Hec Lanabregas" sha              | 276,200.0         |
| 53  | "Kurum International" sh.a.       | 2,679,600.0       |
| 54  | "Hydro Salillari Energy" shpk     | 15,000.0          |
| 55  | "Peshku Picar 1" shpk             | 6,300.0           |
| 56  | "Albanian Power" shpk             | 249,400.0         |
| 57  | "Hydro power Plant Of Korca" shpk | 158,900.0         |
| 58  | "Henz Energji" shpk               | 15,000.0          |
| 59  | "Hydroborsh" sh.p.k               | 144,100.0         |
| 60  | "Lu & Co Eco Energy" shpk         | 9,900.0           |
| 61  | "Energo – Sas" shpk               | 353,700.0         |
| 62  | "Snow Energy" shpk                | 69,900.0          |
| 63  | "Stravaj Energji" shpk            | 15,000.0          |
| 64  | "Gjo Spa Power" shpk              | 524,500.0         |
| 65  | "Erdat Lura" shpk                 | 522,300.0         |
| 66  | "E.T.H.H." shpk                   | 7,000.0           |
| 67  | "Rej Energji" shpk                | 15,000.0          |
| 68  | "SA-GLE Kompani" shpk             | 27,800.0          |
| 69  | "Caushi Energji" shpk             | 23,800.0          |
| 70  | "Energji Xhaci" shpk              | 10,300.0          |
| 71  | "DUKA T2" shpk                    | 15,000.0          |
| 72  | "Tucep" shpk                      | 11,600.0          |
| 73  | "TRUEN" shpk                      | 15,000.0          |
| 74  | "Hec-Treske" shpk                 | 15,000.0          |
| 75  | "Hidro Energy Sotire" shpk        | 56,300.0          |
| 76  | "Shutina energji" shpk            | 15,000.0          |
| 77  | "Hec Cangonj" shpk                | 15,000            |
| 78  | "Zall Herr Energji 2011" shpk     | 23,400            |
| 79  | "Hec Qarr & Kaltanj" shpk         | 44,400.0          |
| 80  | "Bardhgjana" shpk                 | 15,000.0          |
| 81  | "Gjoka Konstruktion Energji" shpk | 33,100.0          |
| 82  | "MTC Energy" shpk                 | 32,600.0          |
| 83  | "EN Rel Hydro" shpk               | 15,000.0          |
| 84  | "Gurshpat Energy" shpk            | 5,800.0           |
| 85  | "Bistrica 3 Energy" shpk          | 15,000.0          |
| 86  | "Gjure Rec" shpk                  | 15,000.0          |
| 87  | "SA'GA-MAT" shpk                  | 15,000.0          |
| 88  | "Komp Energji" shpk               | 15,000.0          |
| 89  | "UKKO" sha (Ujsjell.Kanal.Korce)  | 15,000.0          |
| 90  | "Fatlum" shpk                     | 15,000.0          |
| 91  | "Ayen As Energji" sha             | 30,000.0          |
| 92  | "Koxherri Energji" shpk           | 15,000.0          |
| 93  | "Euron Energy" shpk               | 15,000.0          |
| 94  | "Alb-Energy" shpk                 | 15,000.0          |
| 95  | "Energal" shpk                    | 15,000.0          |
| 96  | "Kisi-Bio-Energji" shpk           | 15,000.0          |
| 97  | "Gama Energy" shpk                | 15,000.0          |
| 98  | "Hec Kabash Porocan" shpk         | 15,000.0          |
| 99  | "Lengarica & Energy" shpk         | 15,000.0          |
| 100 | "Mesopotam Energy" shpk           | 15,000.0          |
|     |                                   | <b>35,750,300</b> |



| <b>II</b>  | <b>License per ndertim, instalim dhe prodhim</b>            |                   |
|------------|-------------------------------------------------------------|-------------------|
| 1          | "Muso HEC Qyteze" shpk                                      | 15,000            |
| 2          | "Remi" shpk                                                 | 15,000            |
| 3          | "Ers-08" shpk                                               | 15,000            |
| 4          | "E-Vento srl Albania" shpk                                  | 30,000            |
| 5          | "Albanian Green Energy" shpk                                | 30,000            |
| 6          | "Hera" shpk                                                 | 30,000            |
| 7          | "Union Eolica Albania" shpk                                 | 30,000            |
| 8          | "Alb Wind Energy" shpk                                      | 30,000            |
| 9          | "Biopower Green Energy" shpk                                | 30,000            |
| 10         | "Empower Albania" shpk                                      | 30,000            |
|            | <b>Total II</b>                                             | <b>255,000</b>    |
| <b>III</b> | <b>TRANSMETIMI (Energji elektrike / Gaz natyror)</b>        |                   |
| 1          | OST sh.a                                                    | 9,290,800         |
| 2          | Albpetrol sh.a.                                             | <b>30,000</b>     |
|            | <b>Total III</b>                                            | <b>9,320,800</b>  |
| <b>IV</b>  | <b>License per shperndarje/furnizim (Energji elektrike)</b> |                   |
| 1          | "OSHEE" sha                                                 | 43,471,800        |
| 2          | "Albpetrol" sh.a.                                           | 175,200           |
| 3          | "GSA" shpk                                                  | 1,253,100         |
| 4          | "GEN-I Tirana" shpk                                         | 784,500           |
| 5          | "EFT Albania" shpk                                          | 454,100           |
| 7          | "Energy Supply AL" shpk                                     | 300               |
| 8          | "Rudnap Energy Tirana" shpk                                 | 15,000            |
| 9          | "Albanian Green Energy" shpk                                | 15,000            |
| 10         | "Ballkan Green Energy" shpk                                 | 15,000            |
| 11         | "Hydro Salillari Energji" shpk                              | 15,000            |
| 12         | "Kurum Energy Resources" sh.a.                              | 15,000            |
| 13         | "Kurum international" sh.a 2 licencat                       | 15,000            |
| 14         | "Energji Ashta" shpk                                        | 15,000            |
| 15         | "YLLIAD" shpk                                               | 60,800            |
| 16         | "Seament Albania" shpk                                      | 15,000            |
| 17         | "Favina 1" shpk                                             | 15,000            |
| 18         | "Wonder power" sha                                          | 600               |
| 19         | "Alpiq Energy Albania" shpk                                 | 15,000            |
| 20         | "AXPO Albania" sha                                          | 16,300            |
| 21         | "ERMA MP" sh.p.k                                            | 15,000            |
| 22         | SNOW ENERGY sh.p.k                                          | 15,000            |
| 23         | "AYEN Energy Trading" sh.a.                                 | 8,100             |
| 24         | "Danske Commodities Albania" shpk                           | 15,000            |
| 25         | "Ayen As Energji" sha                                       | 15,000            |
| 26         | "A&A GROUP" shpk                                            | 15,000            |
| 27         | "Noa Energy Trade" shpk                                     | 15,000            |
| 28         | "Power Elektrik Sllabinje" shpk                             | 15,000            |
| 29         | "Hidropower Elektrik" shpk                                  | 15,000            |
| 30         | "Future Energy AL" shpk                                     | 15,000            |
| 31         | "Devoll Hydropower" sha                                     | 15,000            |
| 32         | "Albanian Energy Supplier" shpk                             | 15,000            |
| 33         | "Roberto Oil" sha                                           | 15,000            |
| 34         | "Gaea-Energjia alternative e gjelber" shpk                  | 15,000            |
| 35         | "Electral" shpk                                             | 15,000            |
| 36         | "Lengarica & Energy" shpk                                   | 15,000            |
|            | <b>Total IV</b>                                             | <b>46,599,800</b> |



| V  | License per tregtim (Energji elektrike /Gaz natyror) |        |
|----|------------------------------------------------------|--------|
| 1  | "GSA" shpk                                           | -      |
| 2  | "Gen – I Tirana" shpk                                | -      |
| 3  | "Enpower Albania" sha                                | 15,000 |
| 4  | KESH sh.a.                                           | -      |
| 5  | "Wonder Power" sha                                   | 15,000 |
| 6  | "EFT Albania" shpk                                   | -      |
| 7  | "Axpo Group" sha                                     | -      |
| 9  | "Alpiq Energy Albania" shpk                          | 15,000 |
| 10 | Cable System sh.p.k.                                 | 15,000 |
| 11 | "400 KV" shpk                                        | 15,000 |
| 12 | Hydro Energy sh.p.k                                  | 15,000 |
| 13 | "Energy partners Al" shpk                            | 15,000 |
| 14 | "YLLIAD " SHPK                                       | 15,000 |
| 15 | "ENERGY PLUS" SHPK                                   | 15,000 |
| 16 | "Rudnap Energy Tirana" shpk                          | 15,000 |
| 17 | "Energy Supply" shpk                                 | 15,000 |
| 18 | "Hec Vluse" shpk                                     | 15,000 |
| 19 | "Hec Dragoshtunje" shpk                              | 15,000 |
| 20 | "Hec Dunice" shpk                                    | 15,000 |
| 21 | "Euron Energy Group" shpk                            | 15,000 |
| 22 | "Erma MP" shpk                                       | 15,000 |
| 23 | "Diteko" shpk                                        | 15,000 |
| 24 | "Albanian Green Energy" shpk                         | 15,000 |
| 25 | "Balkan green Energy" shpk                           | 15,000 |
| 26 | "Hec Lanabregas" sha                                 | 15,000 |
| 27 | "Hydro Salillari Energy" shpk                        | 15,000 |
| 28 | "Kurum Energy Resources" sh.a.                       | 15,000 |
| 29 | "Albpetrol" sha                                      | 15,000 |
| 30 | "Malido Energji" shpk                                | 15,000 |
| 31 | "Albanian Power" shpk                                | 15,000 |
| 32 | "SNOW ENERGY" shpk                                   | 15,000 |
| 33 | "Stravaj Energji" sh.p.k.                            | 15,000 |
| 34 | "HP OSTROVICA" shpk                                  | 15,000 |
| 35 | "BINDI" shpk                                         | 15,000 |
| 36 | "Energji Ashta" shpk                                 | 15,000 |
| 37 | "Gjo Spa Power" shpk                                 | 15,000 |
| 38 | "Erdat Lura" shpk                                    | 15,000 |
| 39 | "Danske Commodities Albania" shpk                    | 10,700 |
| 40 | "EVN Trading" shpk                                   | 15,000 |
| 41 | "Rej Energji" shpk                                   | 15,000 |
| 42 | "Seament Albania" shpk                               | 15,000 |
| 43 | "Wenerg" sha                                         | 15,000 |
| 44 | "Henz Energy" shpk                                   | 15,000 |
| 45 | "A&A GROUP" shpk                                     | 15,000 |
| 46 | "Favina 1" shpk                                      | 15,000 |
| 47 | "WONDER" sha                                         | 15,000 |
| 48 | "TRUEN" shpk                                         | 15,000 |
| 49 | "A-91" shpk                                          | 15,000 |
| 50 | "Dans Energy Albania" shpk                           | 400    |
| 51 | "Shutina Energji" shpk                               | 15,000 |



|    |                                               |                   |
|----|-----------------------------------------------|-------------------|
| 52 | "Zall Herr energy 2011" shpk                  | 15,000            |
| 53 | "Gjoka Konstruktion-ENERGY" shpk              | 15,000            |
| 54 | "EN-ERGY" shpk                                | 15,000            |
| 55 | "Spahiu Gjanc" shpk                           | 15,000            |
| 56 | "MTC Energy" shpk                             | 15,000            |
| 57 | "Ayen Energy Trading" sha                     | 15,000            |
| 58 | "EN Rel Hydro" shpk                           | 15,000            |
| 59 | "Power Wind Energy" shpk                      | 15,000            |
| 60 | "Gjurr Rec" shpk                              | 15,000            |
| 61 | "Bistrica 3 Energy" shpk                      | 15,000            |
| 62 | "Ayen As Energji" sha                         | 15,000            |
| 63 | "Power Trade Albania" shpk                    | 15,000            |
| 64 | "Albanian General Electricity" sh.a.          | 15,000            |
| 65 | "Antix" shpk                                  | 15,000            |
| 66 | "Emikel" shpk                                 | 15,000            |
| 67 | "Komp Energji" shpk                           | 15,000            |
| 68 | "SA'GA-MAT" shpk                              | 15,000            |
| 69 | "Le Trading Albania" shpk                     | 15,000            |
| 70 | Kurum International (2 Licensat e Ulez Shkor) | 15,000            |
| 71 | "Noa Energy Trade" shpk                       | 15,000            |
| 72 | "Power Elektrik Sllabinje" shpk               | 15,000            |
| 73 | "Hidropower Elektrik " shpk                   | 15,000            |
| 74 | "Fatlum" shpk                                 | 15,000            |
| 75 | "Future Energy AL" shpk                       | 15,000            |
| 76 | "Devoll Hydropower" sha                       | 15,000            |
| 77 | "Albanian Energy Supplier" shpk               | 15,000            |
| 78 | Roberto Oil sha                               | 15,000            |
| 79 | "Gaea-Energjia alternative e gjelber" shpk    | 15,000            |
| 80 | "Green Energy Trading Albania" shpk           | 15,000            |
| 81 | "Electral" shpk                               | 15,000            |
| 82 | "Koxherri Energji" shpk                       | 15,000            |
| 83 | "Energal" shpk                                | 15,000            |
| 84 | "Euron Energy" shpk                           | 15,000            |
| 85 | "Hec Kabash Porocan" shpk                     | 15,000            |
| 86 | "Gama Energy" shpk                            | 15,000            |
| 87 | "Kisi-Bio-Energji" shpk                       | 15,000            |
| 88 | "Lengarica & Energy" shpk                     | 15,000            |
| 89 | "Mesopotam Energy " shpk                      | 15,000            |
|    | <b>Total V</b>                                | <b>1,226,100</b>  |
|    | <b>TOTALI I PAGESAVE TE RREG</b>              | <b>93,152,000</b> |

### KËRKESË

Shtetasi Ilir Zefi, i biri i Prengës dhe i Mares, i datëlindjes 30.6.1974, lindur dhe banues në fshatin Tale, Lezhë, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Fran Prengë Zefi, i datëlindjes 9.12.1976.

KËRKUESI  
**Ilir Zefi**



|  |                 |
|--|-----------------|
|  | Formati 61x86/8 |
|--|-----------------|

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2015

Adresa  
Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel: 04 2427005, 04 2427006

Çmimi 462 lekë